



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**  
**KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK**

Nr. 113/14 prot.

Datë 12.03.2024

**V E N D I M**

**Nr. 274/2024**

Komisioni i Prokurimit Publik, i përbërë nga:

Jonaid Myzyri	Kryetar
Kreshnik Ternova	Anëtar
Anila Malaj	Anëtar

Në mbledhjen e datës 12.03.2024 shqyrtoi ankesën me:

**Objekt:**

Shfuqizimi i vendimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave për kualifikimin e ofertës së paraqitur nga operatorët ekonomikë “MC Catering” SHPK, “4 S” SHPK dhe “Nelsa” SHPK në procedurën e prokurimit “Procedurë e hapur e thjeshtuar”, me Nr. REF-91784-12-20-2023, me objekt: “Blerje mish për kafshët e Kopshtit Zoologjik për vitin 2024”, me fond limit 9 015 678 lekë (pa TVSh), zhvilluar më datë 03.01.2024 nga autoriteti kontraktor, Agjencia e Parqeve dhe Rekreacionit

Shfuqizimi i vendimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave për kualifikimin e ofertës së paraqitur nga operatori ekonomik “MC Catering” SHPK dhe “4 S” SHPK në procedurën e prokurimit “Procedurë e hapur e thjeshtuar”, me Nr. REF-91784-12-20-2023, me objekt: “Blerje mish për kafshët e Kopshtit Zoologjik për vitin 2024”, me fond limit 9 015 678 lekë (pa TVSh), zhvilluar më datë 03.01.2024 nga autoriteti kontraktor, Agjencia e Parqeve dhe Rekreacionit

**Ankimues:**

Operatori ekonomik Argent Daci P.f me NIPT L01914003T dhe adresë: Tiranë, Kamëz, Godina Nr.21, poshtë kthesës së Valiasit.

Operatori ekonomik “Nelsa” SHPK me NIPT J71601012S dhe adresë: Dajt Tiranë Dajt, Lagjja Qesarakë, Rruga “Tiranë-Dajt”, Zona kadastrale 2460, me Nr. pasurie 199/32, Hyrja 1.

**Autoriteti Kontraktor:**

Agjencia e Parqeve dhe Rekreacionit me adresë: Rruga “Xhezmi Delli”, Godina nr.20, Tiranë.

**Subjekti i Interesuar:**

Operatori ekonomik “MC Catering” SHPK me NIPT K72218022J dhe adresë: Tiranë, Rruga "Pjeter Budi", Nd.29, H3, Ap.14, Njësia Administrative nr.2, 1010.

Operatori ekonomik “4S” SHPK me NIPT L64425401K dhe adresë: Lushnje, Fier, Lagjja “Xhevdet Nepravishta”, Rruga “Qerim Arapi”, Zona Kadastrale 8571, Godina 196, Pasuria nr.23/104-N4.

Operatori ekonomik “Nelsa” SHPK me NIPT J71601012S dhe adresë: Dajt Tiranë Dajt, Lagjja Qesarakë, Rruga “Tiranë – Dajt”, Zona kadastrale 2460, me Nr.pasurie 199/32, Hyrja 1.

**Baza Ligjore:**

Ligji nr. 162/2020 “*Për Prokurimin Publik*”, Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “*Për miratimin e rregullave të prokurimit publik*”, i ndryshuar, Vendimi i Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 766/2021, datë 13.10.2021 “*Për miratimin e rregullave për organizimin dhe funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik*”, Neni 4, i Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 500/2020 datë 5.11.2020 “*Rregullore për Marrjen e Masave Organizative për Ushtrimin e Veprimtarisë së Institucionit të Komisionit të Prokurimit Publik gjatë gjendjes së pandemisë së shkaktuar nga COVID -19*”.

Komisioni i Prokurimit Publik, pasi dëgjoi relatorin e çështjes, shqyrtoi parashtrimet me shkrim e pretendimet e ankimuesve, dhe pasi diskutoi çështjen në tërësi,

**V ë r e n:**

**I**

*Vlerësimi paraprak*

I.1. Vlera limit e përllëguaritur për procedurën e prokurimit objekt-ankimi është nën kufirin e ulët monetar, ndaj shqyrtimi dhe vendimmarrja do të bëhet nga tre anëtarë, në përputhje me

pikën 1, të nenit 30 të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik” dhe Rregullat e Prokurimit Publik.

I.2. Operatorët ekonomikë kanë *prima facie* interes në këtë procedurë prokurimi dhe për këtë arsye legjitimohen për të paraqitur ankesë në lidhje me të. Gjithashtu, KPP konstatoi, se ankesat e operatorëve ekonomikë janë paraqitur për të njëjtën procedurë prokurimi, ndaj edhe ankimet e tyre duhet të bashkohen e të shqyrtohen në një gjykim të vetëm.

I.3. Operatorët ekonomikë ankimues kanë paraqitur ankesë pranë autoritetit kontraktor dhe pranë Komisionit të Prokurimit Publik, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në ligjin nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”.

I.4. Ankimuesit kanë respektuar afatet ligjore të paraqitjes së ankesës pranë autoritetit kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik.

## II

### *Rrethanat e çështjes*

II.1. Në datën 21.12.2024 në Sistemin e Prokurimeve Elektronike është publikuar procedura e prokurimit “Procedurë e hapur e thjeshtuar”, me Nr. REF-91784-12-20-2023, me objekt: “Blerje mish për kafshët e Kopshtit Zoologjik për vitin 2024”, me fond limit 9 015 678 lekë (pa TVSh), zhvilluar më datë 03.01.2024, nga autoriteti kontraktor, Agjencia e Parqeve dhe Rekreacionit.

II.2. Në datën 03.01.2024, autoriteti kontraktor zhvilloi procedurën e prokurimit objekt - ankimi.

II.3. Në datën 08.01.2024, autoriteti kontraktor ka njoftuar operatorët ekonomikë pjesëmarrës me anë të sistemit të prokurimeve elektronike (S.P.E.), mbi rezultatet e vlerësimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave, të cilët kanë paraqitur ofertat ekonomike (pa TVSH), përkatësisht:

1. “M.C Catering” ShPK	7 244 970	lekë	kualifikuar
2. “4 S” ShPK	438 950	lekë	kualifikuar
3. “Nelsa” ShPK	527884 300	lekë	kualifikuar
4. Argent Daci P.F	8 838 900	lekë	kualifikuar

II.4. Nga verifikimet në sistemin e prokurimit elektronik më datë 15.01.2024, rezulton se është publikuar në SPE, Njoftimi i Fituesit Paraparak.

II.5. Në datën 18.01.2024, pranë Komisionit të Prokurimit Publik, është administruar ankesa me numër 113 prot., e operatorit ekonomik Argent Daci P.F. Nga shqyrtimi paraparak i ankesës së sipërcituar, u konstatua, se objekti i ankesës lidhet me vendimmarrjen e Komisionit të Vlerësimit të Ofertave, mbi kualifikimin e ofertës së paraqitur nga operatorët ekonomikë “Nelsa” SHPK “4 S” SHPK dhe “M.C Catering” SHPK. Gjithashtu, nga

informacioni i autoritetit kontraktor rezulton, se ankesa është depozituar pranë këtij të fundit me datë 18.01.2024, me nr.112/3 prot.

II.6. Në përputhje me nenin 112 “Veprimet paraprake” të Ligjit nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik”, Komisioni i Prokurimit Publik me marrjen e ankesës, e publikoi atë në bazën e të dhënave të tij, e cila përmban të dhëna për: a) ankimuesin, adresën dhe NUIS-in; b) të dhëna të plota për procedurën e prokurimit (objekt, numër reference, fond limit, datën e zhvillimit të procedurës), si dhe është publikuar formulari i publikimit Nr. 113/2 prot., datë 19.01.2024.

II.7. Nga shqyrtimi i akteve të ndodhura në fashikullin e shqyrtimit administrativ rezulton, se operatorët ekonomikë të interesuar nuk kanë dorëzuar argumente në përputhje me nenin 113 të LPP-së, në formë shkresore dhe në sistemin e ankesave elektronike.

II.8. Me shkresën nr. 112/8 prot., datë 22.01.2024, protokolluar me tonën me nr. 113/3 prot., datë 22.01.2024 është depozituar nga autoriteti kontraktor në Komisionin e Prokurimit Publik akti mbi trajtimin e ankesës së operatorit ekonomik ankimues Argent Daci P.F, lidhur me procedurën e mësipërme të prokurimit, nga ku rezulton se autoriteti kontraktor ka vendosur mospranimin e ankesës konkretisht duke argumentuar: “[..]1. Në lidhje me pretendimin e ngritur nga operatori ekonomik ankimues se operatori ekonomik “MC Catering” shpk nuk plotëson “Kriteret e veçanta për kualifikim” “Kapaciteti profesional i operatorëve ekonomik” pika 2.1.1 si më poshtë:

*2.1.1 Operatori ekonomik të paraqesë licencën e lëshuar nga Qendra Kombëtare e Biznesit (QKB) me kategoritë e mëposhtme:*

*Kategoria: II.1 Prodhimi dhe/ose tregtimi i ushqimeve.*

*Nënkategoria: II.1.A. “Prodhim, përpunim e shpërndarje me shumicë e ushqimeve”, Licenca duhet të jetë në emër të operatorit ekonomik pjesëmarrës në procedurë, pasi duhet t’i përkasë operatorit të interesuar të ofertojë për procedurën e prokurimit të shpallur nga Autoriteti Kontraktor. Në rastet e bashkimit të operatorëve ekonomikë secili prej anëtarëve të bashkimit të operatorëve duhet të ketë Licencën, Nënkategoria: II.1.A (Nuk lejohet përdorimi i Licencës së një operatori tjetër ekonomik, sipas Rekomandimit të përbashkët të APP-së dhe AKU-së të datës 19.11.2018. Për këtë arsye detyrimisht Operatori ekonomik pjesëmarrës duhet të jetë i licencuar sipas dispozitave përkatëse ligjore dhe nënligjore). ku pretendohet se licenca € operatorit ekonomik “MC Catering” shpk është e miratuar për veprimtari specifike “Prodhim, përpunim e shpërndarje me shumicë të ushqimeve për njerëz catering dhe shërbime cateringu ne si komision i shqyrtimit të ankesës sqarojmë sa më poshtë vijon: Referuar dokumentave standarte te procedurës së prokurimit shtojca 7 pika 2 “Kapaciteti profesional i operatorëve ekonomik” përcaktohet sa më poshtë:*

*2.1.1 Operatori ekonomik te paraqesë licencen Licence leshuar nga Qendra Kombetare e Biznesit (QKB) me kategoritë e mëposhtëme:*

*Kategoria: II.1 Prodhimi dhe/ose tregtimi i ushqimeve.*

*Nënkategoria: II.1.A. “Prodhim, përpunim e shpërndarje me shumicë e ushqimeve”*

*Licenca duhet të jetë në emër të operatorit ekonomik pjesëmarrës në procedurë pasi duhet ti përkasë operatorit të interesuar të ofertojë për procedurën e prokurimit të shpallur nga Autoriteti Kontraktor.*

*Në rastet e bashkimit të operatorëve ekonomikë secili prej anëtarëve të bashkimit të operatorëve duhet të ketë Licencën, Nënkatëoria: II.1.A*

*(Nuk lejohet përdorimi i Licencës së një operatori tjetër ekonomik, sipas Rekomandimit të përbashkët të APP-së dhe AKU-së të datës 19.11.2018. Për këtë arsye detyrimisht Operatori ekonomik pjesëmarrës duhet të jetë i licencuar sipas dispozitave përkatëse ligjore dhe nënligjore).*

*Nga verifikimi i dokumentacionit të paraqitur në sistemin elektronik nga operatori ekonomik "MC Catering" shpk komisioni i shqyrtimit të ankesave konstaton se në përmbushje të këtij kriteri operatori ekonomik ka paraqitur "Licencën" LN-0241-09-2009 ,data e lëshimit 04.09.2009, e vlefshme Kodi II.1.A.(1) të lëshuar nga qendra kombëtare e biznesit ku specifikisht percaktohet: **Kategoria:** "Prodhimi dhe/ose tregtimi i ushqimeve **Nënkatëoria:** Prodhim, përpunim, shpërndarje me shumicë e ushqimeve **Veprimtari Specifike:** Prodhim, përpunim e shpërndarje me shumicë e ushqimeve për njerëz **Emërtimi përshkruar i veprimtarisë:** Prodhim, përpunim e shpërndarje me shumicë e ushqimeve për njerëz. Licenca është lëshuar në emër të shoqërisë "MC Catering" shpk. Pra referuar sa më sipër përcaktuar në dokumentacionin e paraqitur nga ky operator ekonomik, konstatohet se në veprimtarinë specifike nuk është përcaktuar catering dhe shërbime cateringu sikundër pretendohet nga operatori ekonomik ankimues. Gjithashtu, autoriteti kontraktor në kuadër të plotësimit të kapacitetit teknik e profesional të operatorëve ekonomik ka përcaktuar dhe kriterin sipas pikës 2.1.2 sa më poshtë: 2.1.2 Operatori Ekonomik Ofertues duhet të jetë i licencuar nga Qendra Kombëtare e Licencimit, me Kodin II.1.B, lidhur me shitjen me shumicë e produkteve shtazore dhe të nënprodukteve. Për plotësimin e këtij kriteri për kualifikim, të paraqitet në procedurën e prokurimit publik Licenca përkatëse, e cila duhet të përmbajë kodin II.1.B. (Nuk lejohet përdorimi i Licencës së një operatori tjetër ekonomik, sipas Rekomandimit të përbashkët të APP-së dhe AKU-së të datës 19.11.2018. Për këtë arsye detyrimisht Operatori ekonomik pjesëmarrës duhet të jetë i licencuar sipas dispozitave përkatëse ligjore dhe nënligjore). Në vazhdimësi të verifikimit të dokumentave të paraqitura nga operatori ekonomik në sistemin elektronik të prokurimit komisioni i shqyrtimit të ankesës konstaton se operatori ekonomik "MC Catering" shpk ka paraqitur "Licencën" LN-1338-10-2020 ,data e lëshimit 22.10.2020, e vlefshme Kodi II.1.B të lëshuar nga qendra kombëtare e biznesit ku specifikisht percaktohet:*

***Kategoria:** Prodhimi dhe/ose tregtimi i ushqimeve*

***Nënkatëoria:** Shitje me shumicë e ushqimeve me origjinë shtazore (për njerëz) Licenca sa më sipër është lëshuar në emër të shoqërisë "MC Catering" shpk. Në miratimin e kërkesës për pajisjen me këtë kategori licence të lëshuar nga Autoriteti Kombëtar i Ushqimit, ky institucion në mbështetje të Ligjit 10081, datë 23.02.2009 "Për licencat, autorizimet dhe lejet në Republikën e Shqipërisë" , i ndryshuar, Ligjit 9863, datë 28.01.2008 "Për ushqimin", i ndryshuar dhe VKM Nr.538, datë 26.05.2009 "Për licencat dhe lejet që trajtohen nga apo nëpërmjet QKB dhe disa rregullave të tjera nënligjore të përbashkëta" i ndryshuar Fusha II "Ushqimi dhe shëndeti", Kategoria II.1 Prodhimi dhe ose tregtimi i ushqimeve subjektit "MC Catering" shpk me aktivitet "Prodhimi ose tregtimi i ushqimeve" pasi janë kryer inspektimet i është miratuar licenca për veprimtarinë specifike "Import, eksport, shitje me shumicë e produkteve me origjinë shtazore (për njerëz). Në shtojcën e ligjit Nr. 10 081, datë 23.2.2009 "Për Licencat, Autorizimet dhe Lejet në*

Republikën e Shqipërisë”, Fusha II “Ushqimi dhe Shëndeti”, parashikohet shprehimisht: 22 Fusha II. Ushqimi dhe Shëndeti

4.1. Licence Prodhimi dhe/ose tregtimi i ushqimeve

5.2. Licence Shërbime të riprodhimit, krijimit të racave ose veterinarë

6.3 Licence Rritja ose tregtimi i kafshëve

7 4. Licence Prodhimi dhe/ose tregtimi i farërave dhe/ose fidanëve

8 5. Licence Prodhimi dhe/ose tregtimi i Produkteve të Mbrojtjes së Bimëve, plehrave kimike dhe/ose produkteve prej duhaneve.

9 6. Licence Shërbime mjekësore parësore, spitalore ose të stomatologjisë.

10 7. Licence Prodhimi dhe/ose tregtimi i barnave për njerëz ose kafshë.

11 8. Licence Shërbime të tjera shëndetësore dhe/ose higjiëno-sanitare.

III.1.9. Në aneksin 1 të VKM Nr.538, datë 26.5.2009 “Për Licencat dhe Lejet që trajtohen nga apo nëpërmjet qendrës Kombëtare të Licencimit dhe disa rregullime të tjera nënligjore të Përbashkëta”, Fusha II “Ushqimi dhe Shëndeti”, Kategoria II.1 “Prodhim dhe/ose Tregtim i Ushqimeve”, parashikohet shprehimisht: 1. Veprimtaria e “prodhimit dhe/ose tregtimit të ushqimeve” është kategoria III.1 e Shtojcës së Ligjit nr.10 081, datë 23.2.2009 “Për licencat, autorizimet dhe lejet në Republikën e Shqipërisë”.

2. Kjo licencë ndahet në këto nënkategori:

a) “Prodhim, përpunim e shpërndarje me shumicë e ushqimeve”, me kodin II.1.A:

b) “Shitje me shumicë e ushqimeve me origjinë shtazore (për njerëz)”, me kodin II.1.B:

c) “Prodhimi primar me shumicë”, me kodin II.1.C.

3. Veprimtaritë e nënkategorisë me kodin II.1.A dhe II.1.C, nuk përfshijnë veprimtaritë për të cilat parashikohet licencimi i posaçëm sipas kategorisë 1.3 të shtojcës së ligjit nr.10 081, datë 23.2.2009 “Për licencat, autorizimet dhe lejet në Republikën e Shqipërisë”.

4. Licencat për nënkategoritë II.1.A, II.1.B dhe II.1.C janë pa afat.

Gjithashtu referuar përcaktimeve të nenit 40, pika 5Ja “Kontrata e mallrave” të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, ku përcaktohet se:

5. Për të provuar për të kryer veprimtarinë profesionale, kapacitetet teknike dhe profesionale, autoriteti/enti kontraktor kërkon:

a) Licencat profesionale për prodhimin dhe ose furnizimin e mallrave, objektet e kontrates të leshuara nga autoritetet kompetente shtetërore; dhe/ose”

Kriteret për kualifikim vendosen që t'i shërbejnë autoritetit kontraktor për njohjen e gjendjes dhe kapaciteteve të operatorëve ekonomikë, të cilët, nëpërmjet dokumentacionit të paraqitur duhet të vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet ekonomike, financiare dhe organizative, makineritë, pajisjet e asete të tjera fizike, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, gjithçka në funksion të realizimit me sukses të kontratës. Në varësi të kontratës dhe volumit të saj autoriteti kontraktor përcakton dhe kërkesat e veçanta për kualifikim, duke mbajtur në konsideratë kufijtë maksimal të përcaktuar në rregullat e prokurimit publik. Kriteret kualifikuese të përcaktuara nga autoriteti kontraktor janë të detyrueshme për t'u përmbushur nga të gjithë ofertuesit ekonomikë pjesëmarrës në një procedurë prokurimi. Autoriteti kontraktor do të konsiderojë një ofertë të vlefshme, vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentet e tenderit. Për pasojë, Komisioni i shqyrtimit të ankesave gjykon, se operatorët ekonomikë pjesëmarrës në një procedurë prokurimi duhet të plotësojnë vetëm kërkesat e vendosura në

dokumentet e tenderit, e rrjedhimisht, vlerësimi e kualifikimi i tyre duhet të bëhet në përputhje vetëm me këto kërkesa. Referuar sa më lart, Komisioni i shqyrtimit të ankesave vëren, se autoriteti kontraktor në kriterin e veçantë të kualifikimit ka kërkuar nga ana e operatorëve ekonomikë: Operatori ekonomik te paraqesë licencen Licence leshuar nga Qendra Kombëtare e Biznesit (QKB) me kategoritë e mëposhtëme:

Kategoria: II.1 Prodhimi dhe ose tregtimi i ushqimeve.

Nënkategoria: II.1.A. “Prodhim, përpunim e shpërndarje me shumicë e ushqimeve”, Nga shqyrtimi i dokumentacionit të dorëzuar nga operatori ekonomik “MC Catering” shpk në përmbushje të kriterit specifik mbi të cilin operatori ekonomik është ankimuar komisioni i shqyrtimit të ankesës konstaton, se është dorëzuar në përputhje me kërkesat në kriter - Licencë me Kodin II.1.A (1) LN-0241-09-2009 me kategori II.1 Prodhimi dhe ose tregtimi i ushqimeve dhe nënkategori “Prodhim, përpunim e shpërndarje me shumicë e ushqimeve” dhe gjithashtu është lëshuar dhe “Licencë”LN-1338-10-2020, data e lëshimit 22.10.2020, e vlefshme me Kodi II.1.B të lëshuar nga qendra kombëtare e biznesit ku specifikisht përcaktohet:

Kategoria: Prodhimi dhe ose tregtimi i ushqimeve Nënkategoria: Shitje me shumicë e ushqimeve me origjinë shtazore (për njerëz) Emertimi përshkrues i veprimtarisë: Shitje me shumicë e produkteve me origjinë shtazore për njerëz.

Pra sa më sipër argumentuar operatori ekonomik referuar akteve ligjore dhe nënligjore në fuqi ushtron veprimtarinë e furnizimit me produkte me origjinë shtazore vërtetuar kjo me dokumentacionin e paraqitur në funksion të kërkesave për kapacitetin profesional të operatorëve ekonomik pasi ka paraqitur licence që ka të drejten të ushtrojë veprimtarinë sipas Kategorise II.1 Prodhimi dhe/ose tregtimi i ushqimeve., Nënkategoria: II.1.A. “Prodhim, përpunim e shpërndarje me shumicë e ushqimeve” dhe gjithashtu ka paraqitur licence të Kategorise II.1.B për kryerjen e veprimtarisë specifike Shitje me shumicë e produkteve me origjinë shtazore për njerëz. Komisioni i shqyrtimit të ankesave gjykon, se fakti që subjekti ka deklaruar dhe ka paraqitur licencat përkatëse për ushtrimin e kësaj veprimtarie, ka paraqitur ambjent të përshtatshëm për magazinimin e produkteve me origjinë shtazore të pajisur me akt-miratimi higjieno sanitar të lëshuar nga ministria e shëndetësisë, Inspektoriati shtetëror shëndetsor, ka të deklaruar në ekstraktin e rregjistrimit tregtar si dhe ka dorëzura në sistemin e prokurimit publik një sërë kontratash të ngjashme të lidhur me autoritete publike në të cilat ka ushtruar specifikisht këtë veprimtari (furnizim me mish) qartësisht të con në konkluzionin se subjekti “MC Catering” shpk ushtron aktivitetin për tregtimin me shumicë të produkteve me origjinë shtazore, sikundër autoriteti përcakton në dokumentat e procedurës së prokurimit objekt ankimimi konform legjislacionit në fuqi, në fushën e ushqimit.

Në këtë kuptim komisioni i shqyrtimit të ankesës gjykon, se operatori ekonomik “MC Catering” shpk është në kushtet e përmbushjes së kërkesës specifike për kriterin e veçante të kualifikimit të përcaktuar në dokumentet e procedurës së prokurimit objekt-ankimi, sa i takon statusit të tij si operator ekonomik që garanton furnizimin me produkteve me origjinë shtazore dhe gjithashtu në analizim të dokumentacionit të dorëzuar nga operatori ekonomik në sistemin e prokurimit publik rezulton i provuar ky fakt ndërkohë që sipas kriterëve të përcaktuara nuk rezulton asnjë dokument tjetër i përcaktuar nga autoriteti kontraktor dhe që nuk është plotësuar nga operatori ekonomik.

Në rast skualifikimi të këtij operatori ekonomik autoriteti kontraktor do të ishte në kushte të tejkalimit të kërkesës vendosur në kriterin e veçantë të kualifikimit sipas pikës 2.1.1, dhe të

kritereve për kualifikim të vendosura kritere të cilat referuar dokumentacionit të paraqitur janë përmbushur plotësisht nga ana e operatorit ekonomik “MC Catering” shpk. Rrjedhimisht, pretendimi i operatorit ekonomik ankimues nuk qëndron nuk është i argumentuar dhe nuk mbështetet në ligj dhe në fakt.

2. Ne lidhje me pretendimin e ngritur nga operatorit ekonomik ankimues se operatorit ekonomik “4 S” shpk nuk plotëson “Kriteret e veçanta për kualifikim” “Kapaciteti profesional i operatorëve ekonomik” pika 2.1.1 si më poshtë:

2.1.1 Operatori ekonomik te paraqesë licencen Licence leshuar nga Qendra Kombetare e Biznesit (QKB) me kategoritë e mëposhtëme:

Kategoria: II.1 Prodhimi dhesose tregtimi i ushqimeve.

Nënkategoria: II.1.A. “Prodhim, përpunim e shpërndarje me shumicë e ushqimeve”, Licenca duhet të jetë në emër të operatorit ekonomik pjesëmarrës në procedurë pasi duhet ti përkasë operatorit të interesuar të ofertojë për procedurën e prokurimit të shpallur nga Autoriteti Kontraktor. Në rastet e bashkimit të operatorëve ekonomikë secili prej anëtarëve të bashkimit të operatorëve duhet të ketë Licensën, Nënkategoria: II.1.A (Nuk lejohet përdorimi i Licencës së një operatori tjetër ekonomik, sipas Rekomandimit të përbashkët të APP-së dhe AKU-së të datës 19.11.2018. Për këtë arsye detyrimisht Operatori ekonomik pjesëmarrës duhet të jetë i licensuar sipas dispozitave përkatëse ligjore dhe nënligjore). ku pretendohet se operatorit ekonomik ” 4 S” shpk është e miratuar për veprimtari specifike “prodhim, përpunim e shpërndarje me shumicë të ushqimeve për njerëz restorant dhe shërbime katering si dhe furrë buke dhe prodhime pasticerie ne si komision i shqyrtimit te ankeses sqarojmë sa me poshte vijon: Referuar dokumentave standarte te procedurës së prokurimit shtojca 7 pika 2 “Kapaciteti profesional i operatorëve ekonomik” përcaktohet sa më poshtë: 2.1.1 Operatori ekonomik te paraqesë licencen Licence leshuar nga Qendra Kombetare e Biznesit (QKB) me kategoritë e mëposhtëme:

Kategoria: II.1 Prodhimi dhe/ose tregtimi i ushqimeve

Nënkategoria: II.1.A. “Prodhim, përpunim, e shpërndarje me shumicë e ushqimeve”, Licenca duhet të jetë në emër të operatorit ekonomik pjesëmarrës në procedurë pasi duhet ti përkasë operatorit të interesuar të ofertojë për procedurën e prokurimit të shpallur nga Autoriteti Kontraktor. Në rastet e bashkimit të operatorëve ekonomikë secili prej anëtarëve të bashkimit të operatorëve duhet të ketë Licensën, Nënkategoria: II.1.A (Nuk lejohet përdorimi i Licencës së një operatori tjetër ekonomik, sipas Rekomandimit të përbashkët të APP-së dhe AKU-së të datës 19.11.2018. Për këtë arsye detyrimisht Operatori ekonomik pjesëmarrës duhet të jetë i licensuar sipas dispozitave përkatëse ligjore dhe nënligjore). Nga verifikimi i dokumentacionit të paraqitur në sistemin elektronik nga operatorit ekonomik “4 S” shpk komisioni i shqyrtimit të ankesave konstaton se në përmbushje të këtij kriteri operatorit ekonomik ka paraqitur “Licencën” LN-3561-07-2017, data e lëshimit 17.07.2017, e vlefshme Kodi II.1.A. të lëshuar nga qendra kombëtare e biznesit ku specifikisht përcaktohet:

Kategoria: “Prodhimi dhe/ose tregtimi i ushqimeve

Nënkategoria: Prodhim, përpunim, shpërndarje me shumicë e ushqimeve  
Veprimtari Specifike: Prodhim, përpunim e shpërndarje me shumicë e ushqimeve për njerëz  
Emërtimi përshkrues i veprimtarisë: Prodhim, përpunim e shpërndarje me shumicë e ushqimeve për njerëz (Furrë buke dhe prodhime pasticerie).Licenca sa më sipër është lëshuar në emër të shoqërisë “4 S” shpk



*Pra referuar sa më sipër përcaktuar në dokumentacionin e paraqitur nga ky operator ekonomik konstatojmë se në veprimtarinë specifike përcaktohet: Prodhim, përpunim e shpërndarje me shumicë e ushqimeve për njerëz.*

*Gjithashtu autoriteti kontraktor në kuadër të plotësimit të kapacitetit teknik e profesional të operatorëve ekonomik ka përcaktuar dhe kriterin sipas pikës 2.1.2 sa më poshtë:*

*2.1.2 Operatori Ekonomik Ofertues duhet të jetë i licensuar nga Qendra Kombëtare e Licensimit, me Kodin II.1.B, lidhur me shiten me shumicë e rrodukteve shta ore dhe të nënprodukteve.*

*Për plotësimin e këtij kriteri për kualifikim, të paraqitet në procedurën e prokurimit publik Licensa përkatëse, e cila duhet të përmbajë kodin II.1.B.*

*(Nuk lejohet përdorimi i Licencës së një operatori tjetër ekonomik, sipas Rekomandimit të përbashkët të APP-së dhe AKU-së të datës 19.11.2018. Për këtë arsye detyrimisht Operatori ekonomik pjesëmarrës duhet të jetë i licensuar sipas dispozitave përkatëse ligjore dhe nënligjore). Në vazhdimësi të verifikimit të dokumentave të paraqitura nga operatori ekonomik në sistemin elektronik të prokurimit komisioni i shqyrtimit të ankesës konstaton se operatori ekonomik "4 S" shpk ka paraqitur "Licencën" LN-3474-01-2022, data e lëshimit 07.01.2022, e vlefshme Kodi II.1.B të lëshuar nga qendra kombëtare e biznesit ku specifikisht përcaktohet:*

*Kategoria: Prodhimi dhe/ose tregtimi i ushqimeve*

*Nënkategoria: Shitje me shumicë e ushqimeve me origjinë shtazore (për njerëz)  
Emërtimi përshkrues i veprimtarisë: Shitje me shumicë e produkteve me origjinë shtazore për njerëz. Licenca sa më sipër është lëshuar në emër të shoqërisë "4S" shpk. Në miratimin e kërkesës për pajisjen me këtë kategori licence të lëshuar nga Autoriteti Kombëtar i Ushqimit ky institucion në mbështetje të Ligjit 10081, datë 23.02.2009 "Për licencat, autorizimet dhe lejet në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar, Ligjit 9863, datë 28.01.2008 "Për ushqimin", i ndryshuar dhe VKM Nr.538, datë 26.05.2009 "Për licencat dhe lejet që trajtohen nga apo nëpërmjet QKB dhe disa rregullave të tjera nënligjore të përbashkëta" i ndryshuar Fusha II "Ushqimi dhe shëndeti", Kategoria II.1 Prodhimi dhe ose tregtimi i ushqimeve subjektit 4S me aktivitet "Prodhimi ose tregtimi i ushqimeve" pasi janë kryer inspektimet i është miratuar veprimtaria specifike "Shitje me shumicë e produkteve me origjinë shtazore (për njerëz).*

*Në shtojcën e ligjit Nr. 10 081, datë 23.2.2009 "Për Licencat, Autorizimet dhe Lejet në Republikën e Shqipërisë", Fusha II "Ushqimi dhe Shëndeti", parashikohet shprehimisht:*

*22 Fusha II. Ushqimi dhe Shëndeti*

*41. Licence Prodhimi dhe/ose tregtimi i ushqimeve*

*52. Licence Shërbime të riprodhimit, krijimit të racave ose veterinare*

*63 Licence Rritja ose tregtimi i kafshëve*

*74. Licence Prodhimi dhe/ose tregtimi i farërave dhe/ose fidanëve*

*85. Licence Prodhimi dhe/ose tregtimi i Produkteve të Mbrojtjes së Bimëve, plehrave kimike dhe/ose produkteve prej duhaneve.*

*96. Licence Shërbime mjekësore parësore, spitalore ose të stomatologjisë.*

*107. Licence Prodhimi dhe/ose tregtimi i barnave për njerëz ose kafshë.*

*118. Licence Shërbime të tjera shëndetësore dhe/ose higjieno-sanitare.*

*III.1.9. Në aneksin 1 të VKM Nr.538, datë 26.5.2009 "Për Licencat dhe Lejet që trajtohen nga apo nëpërmjet qendrës Kombëtare të Licencimit dhe disa rregullime të tjera nënligjore të Përbashkëta", Fusha II "Ushqimi dhe Shëndeti", Kategoria II.1 "Prodhim dhe/ose Tregtim i*

Ushqimeve”, parashikohet shprehimisht: 1. Veprimtaria e “prodhimit dhe/ose tregtimit të ushqimeve” është kategoria II.1 e Shtojcës së Ligjit nr.10 081, datë 23.2.2009 “Për licencat, autorizimet dhe lejet në Republikën e Shqipërisë”.

2. Kjo licencë ndahet në këto nënkategoritë:

- a) “Prodhim, përpunim e shpërndarje me shumicë e ushqimeve”, me kodin II.1.A:
- b) “Shitje me shumicë e ushqimeve me origjinë shtazore (për njerëz)”, me kodin II.1.B:
- c) “Prodhimi primar me shumicë”, me kodin II.1.C.

Veprimtaritë e nënkategorisë me kodin II.1.A dhe II.1.C, nuk përfshijnë veprimtaritë për të cilat parashikohet licencimi i posaçëm sipas kategorisë II.3 të shtojcës së ligjit nr.10 081, datë 23.2.2009 “Për licencat, autorizimet dhe lejet në Republikën e Shqipërisë”.

4.Licencat për nënkategoritë II.1.A, II.1.B dhe II.1.C janë pa afat.

Gjithashtu referuar përcaktimeve të nenit 40, pika Sa “Kontrata e mallrave” të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, ku përcaktohet se:

“5. Për të provuar përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale, kapacitetet teknike dhe profesionale, autoriteti/ enti kontraktor autoriteti kërkon:

b) licencat profesionale për “Kriteret për kualifikim vendosen që t’i shërbejnë autoritetit kontraktor për njohjen e gjendjes dhe kapaciteteve të operatorëve ekonomikë, të cilët, nëpërmjet dokumentacionit të paraqitur duhet të vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet ekonomike, financiare dhe organizative, makineritë, pajisjet e asete të tjera fizike, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, gjithçka në funksion të realizimit me sukses të kontratës. Në varësi të kontratës dhe volumit të saj autoriteti kontraktor përcakton dhe kërkesat e veçanta për kualifikim, duke mbajtur në konsideratë kufijtë maksimal të përcaktuar në rregullat e prokurimit publik. Kriteret kualifikuese të përcaktuara nga autoriteti kontraktor janë të detyrueshme për t’u përmbushur nga të gjithë ofertuesit ekonomikë pjesëmarrës në një procedurë prokurimi. Autoriteti kontraktor do të konsiderojë një ofertë të vlefshme, vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentet e tenderit. Për pasojë, Komisioni i shqyrtimit të ankesave gjykon, se operatorët ekonomikë pjesëmarrës në një procedurë prokurimi duhet të plotësojnë vetëm kërkesat e vendosura në dokumentet e tenderit, e rrjedhimisht, vlerësimi e kualifikimi i tyre duhet të bëhet në përputhje vetëm me këto kërkesa. Referuar sa më lart, Komisioni i shqyrtimit të ankesave vëren, se autoriteti kontraktor në kriterin e veçantë të kualifikimit ka kërkuar nga ana e operatorëve ekonomikë specifikisht si më poshtë : Operatori ekonomik te paraqesë licencen Licence leshuar nga Qendra Kombetare e Biznesit (QKB) me kategoritë e mëposhtëme:

Kategoria. II.1 Prodhimi dhe/ose tregtimi i ushqimeve.

Nënkategoria: II.1.A. “Prodhim, përpunim e shpërndarje me shumicë e ushqimeve”, Nga shqyrtimi i dokumentacionit të dorëzuar nga operatori ekonomik “4S” shpk në përmbushje të kriterit specifik mbi të cilin operatori ekonomik është ankimuar komisioni i shqyrtimit të ankesës konstaton, se është dorëzuar në përputhje me kërkesat në kriter - “Licencë” LN-3561-07-2017 data e lëshimit 17.07.2017 me kategori II.1 Prodhimi dhe/ose tregtimi i ushqimeve dhe nënkategori II.1.A “Prodhim, përpunim e shpërndarje me shumicë e ushqimeve” sikundër kërkuar në dokumentat e tenderit dhe gjithashtu është dorëzuar dhe “Licencë” LN-3474-01-2022, data e lëshimit 07.01.2022, e vlefshme me Kodi II.1.B të lëshuar nga qendra kombëtare e biznesit ku specifikisht përcaktohet:

*Kategoria: Prodhimi dhe/ose tregtimi i ushqimeve*

*Nënkategoria: Shitje me shumicë e ushqimeve me origjinë shtazore (për njerëz)*

*Emertimi përshkrues i veprimtarisë: Shitje me shumicë e produkteve me origjinë shtazore për njerëz.*

*Pra sa më sipër argumentuar në asnjë moment autoriteti kontraktor nuk ka gjykuar dhe nuk mund të gjykojë a-priori që operatori ekonomik nuk e disponon mundësinë për të kryer veprimtarinë e furnizimit me produkte me origjinë shtazore nderkohe që në dokumentacionin e paraqitur në funksion të kërkesave për kapacitetin profesional të operatorëve ekonomik ka paraqitur licencë që ka të drejten të ushtrojë veprimtarinë sipas*

*Kategoria:II.1 Prodhimi dhe/ose tregtimi i ushqimeve,*

*Nënkategoria: II.1.A. “Prodhim, përpunim e shpërndarje me shumicë e ushqimeve” dhe gjithashtu ka paraqitur licence të Kategorise II.1.B për kryerjen e veprimtarisë specifike: “Shitje me shumicë e produkteve me origjinë shtazore për njerëz”.*

*Komisioni i shqyrtimit të ankesave gjykon, se fakti që subjekti ka deklaruar në ekstraktin e regjistrit tregtar ushtrimin e veprimtarisë së tregtim me shumicë e pakicë të produkteve me origjinë shtazore për njerëz, ka paraqitur licencat përkatëse për ushtrimin e kësaj veprimtarie si dhe ka dorëzuar në sistemin e prokurimit publik një sërë kontratash të ngjashme të lidhur me autoritete publike në të cilat ka ushtruar specifikisht këtë veprimtari (furnizim me mish) qartësisht të con në konkluzionin se subjekti “4 S” shpk ushtron aktivitetin për tregtimin me shumicë të produkteve me origjinë shtazore sikundër autoriteti kontraktor përcakton në dokumentat e procedurës së prokurimit objekt ankimi, sipas legjislacionit në fuqi në fushën e ushqimit.*

*Në këtë kuptim komisioni i shqyrtimit të ankesës gjykon, se operatori ekonomik “4 S” shpk është në kushtet e përmbushjes së kërkesës specifike për kriterin e veçante të kualifikimit të përcaktuar në dokumentet e procedurës së prokurimit objekt-ankimi, sa i takon statusit të tij si operator ekonomik që garanton tregtimin dhe furnizimin me produkte me origjinë shtazore dhe gjithashtu në analizim të dokumentacionit të dorëzuar nga operatori ekonomik në sistemin e prokurimit publik rezulton i provuar ky fakt ndërkohë që sipas kriterëve të përcaktuara nuk rezulton asnjë dokument tjetër i përcaktuar nga autoriteti kontraktor dhe që nuk është plotësuar nga operatori ekonomik.*

*Pra sa më sipër në lidhje me kriterin për kategorinë II.1.A autoriteti kontraktor ka saktësuar në dokumentat e tenderit kërkesën e tij dhe rrjedhimisht komisioni i vlerësimit të ofertave nuk mund të vlerësojë mbi kriteret të cilat nuk janë kërkuar nga ana e autoritetit kontraktor. Në rast skualifikimi të këtij operatori ekonomik autoriteti kontraktor do të ishte në kushte të tejkalimit të kërkesës së vendosur në kriterin e veçantë të kualifikimit sipas pikës 2.1.1, dhe të kriterëve për kualifikim të vendosura kriteret të cilat referuar dokumentacionit të paraqitur janë përmbushur nga ana e operatorit ekonomik “4 S” shpk.*

*Rrjedhimisht, pretendimi i operatorit ekonomik ankimes nuk qëndron nuk është i argumentuar dhe nuk mbështetet në ligj dhe në fakt.*

*3. Në lidhje me pretendimin e ngritur nga operatori ekonomik ankimes se operatori ekonomik “NELSA” shpk nuk plotëson “Kriteret e veçanta për kualifikim” “Kapaciteti profesional i operatorëve ekonomik” pika 2.1.1 si më poshtë:*

*2.1.1 Operatori ekonomik të paraqesë licencën Licencë lëshuar nga Qendra Kombëtare e Biznesit (QKB) me kategoritë e mëposhtëme:*

*Kategoria: II.1 Prodhimi dhe/ose tregtimi i ushqimeve.*

Nënkategoria: II.1.A. “Prodhim, përpunim e shpërndarje me shumicë e ushqimeve”,  
Licenca duhet të jetë në emër të operatorit ekonomik pjesëmarrës në procedurë pasi duhet ti përkasë operatorit të interesuar të ofertojë për procedurën e prokurimit të shpallur nga Autoriteti Kontraktor. Në rastet e bashkimit të operatorëve ekonomikë secili prej anëtarëve të bashkimit të operatorëve duhet të ketë Licensën, Nënkategoria: II.1.A

(Nuk lejohet përdorimi i Licencës së një operatori tjetër ekonomik, sipas Rekomandimit të përbashkët të APP-së dhe AKU-së të datës 19.11.2018. Për këtë arsye detyrimisht Operatori ekonomik pjesëmarrës duhet të jetë i licensuar sipas dispozitave përkatëse ligjore dhe nënligjore). ku pretendohet se operatori ekonomik “MC Catering” shpk është e miratuar për veprimtari specifike “prodhim, përpunim e shpërndarje me shumicë të ushqimeve për njerëz (bar restorant dhe ambalazhim i fruta dhe perimeve ne si komision i shqyrtimit te ankeses sqarojmë sa më poshtë vijon:

Referuar dokumentave standarte te procedurës së prokurimit shtojca 7 pika 2 “Kapaciteti profesional i operatorëve ekonomik” përcaktohet sa më poshtë:

2.1.1 Operatori ekonomik te paraqesë licencen Licence leshuar nga Qendra Kombetare e Biznesit (QKB) me kategoritë e mëposhtëme:

Kategoria:II.1 Prodhimi dhe/ose tregtimi i ushqimeve

Nënkategoria: II.1.A. “Prodhim, përpunim e shpërndarje me shumicë e ushqimeve”,

Licenca duhet të jetë në emër të operatorit ekonomik pjesëmarrës në procedurë pasi duhet ti përkasë operatorit të interesuar të ofertojë për procedurën e prokurimit të shpallur nga Autoriteti Kontraktor.

Në rastet e bashkimit të operatorëve ekonomikë secili prej anëtarëve të bashkimit të operatorëve duhet të ketë Licensën, Nënkategoria: II.1.A

(Nuk lejohet përdorimi i Licencës së një operatori tjetër ekonomik, sipas Rekomandimit të përbashkët të APP-së dhe AKU-së të datës 19.11.2018. Për këtë arsye detyrimisht Operatori ekonomik pjesëmarrës duhet të jetë i licensuar sipas dispozitave përkatëse ligjore dhe nënligjore).

Nga verifikimi i dokumentacionit të paraqitur në sistemin elektronik nga operatori ekonomik “NELSA” shpk komisioni i shqyrtimit të ankesave konstaton se në përmbushje të këtij kriteri operatori ekonomik ka paraqitur “Licencen” LN-0366-03-2020,data e lëshimit 30.03.2020, e vlefshme Kodi II.1.A. të lëshuar nga qendra kombëtare e biznesit ku specifikisht përcaktohet: Kategoria: “Prodhimi dhe/ose tregtimi i ushqimeve

Nënkategoria: Prodhim, përpunim, shpërndarje me shumicë e ushqimeve

Veprimtari Specifike: Prodhim, përpunim e shpërndarje me shumicë e ushqimeve për njerëz. Emërtimi përshkrues i veprimtarisë: Prodhim, përpunim e shpërndarje me shumicë e ushqimeve për njerëz (Ambalazhim i fruta perimeve) Licenca sa më sipër është lëshuar në emër të shoqërisë “NELSA” shpk

Pra referuar sa më sipër përcaktuar në dokumentacionin e paraqitur nga ky operator ekonomik konstatojmë se në veprimtarinë specifike përcaktohet: Prodhim, përpunim e shpërndarje me shumicë e ushqimeve për njerëz. Thënë kjo çka është kërkuar nga autoriteti kontraktor për këtë kategori licence ku përcaktohet specifikisht në kriter vetëm kategoria dhe nënkategoria e licencës është plotësuar nga operatori ekonomik “NELSA” shpk.

Gjithashtu autoriteti kontraktor në kuadër të plotësimit të kapacitetit teknik e profesional të operatorëve ekonomik ka përcaktuar dhe kriterin sipas pikës 2.1.2 sa më poshtë:

2.1.2 Operatori Ekonomik Ofertues duhet të jetë i licensuar nga Qendra Kombëtare e

Licensimit, me Kodin II.1.B, lidhur me shitjen me shumicë e produkteve shtazore dhe të nënprodukteve.

Për plotësimin e këtij kriteri për kualifikim, të paraqitet në procedurën e prokurimit publik Licensa përkatëse, e cila duhet të përmbajë kodin II.1.B.

(Nuk lejohet përdorimi i Licencës së një operatori tjetër ekonomik, sipas Rekomandimit të përbashkët të APP-së dhe AKU-së të datës 19.11.2018. Për këtë arsye detyrimisht Operatori ekonomik pjesëmarrës duhet të jetë i licensuar sipas dispozitave përkatëse ligjore dhe nënligjore). Në vazhdimësi të verifikimit të dokumentave të paraqitura nga operatori ekonomik në sistemin elektronik të prokurimit komisioni i shqyrtimit të ankesës konstaton se operatori ekonomik "NELSA" shpk ka paraqitur "Licencen" 0454-11-2009, data e lëshimit 04.11.2009, e vlefshme Kodi II.1.B të lëshuar nga qendra kombëtare e biznesit ku specifikisht percaktohet:

Kategoria: Prodhimi dhe/ose tregtimi i ushqimeve

Nënkategoria: Shitje me shumicë e ushqimeve me origjinë shtazore (për njerëz)

Emertimi përshkrues i veprimtarisë: Shitje me shumicë e produkteve me origjinë shtazore për njerëz.

Licenca sa më sipër është lëshuar në emër të shoqërisë "NELSA" shpk.

Në miratimin e kërkesës për pajisjen me këtë kategori licence të lëshuar nga Autoriteti Kombëtar i Ushqimit ky institucion në mbështetje të Ligjit 10081, datë 23.02.2009 "Për licencat, autorizimet dhe lejet në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar, Ligjit 9863, datë 28.01.2008 "Për ushqimin", i ndryshuar dhe VKM Nr.538, datë 26.05.2009 "Për licencat dhe lejet që trajtohen nga apo nëpërmjet QKB dhe disa rregullave të tjera nënligjore të përbashkëta" i ndryshuar Fusha II "Ushqimi dhe shëndeti", Kategoria II.1 Prodhimi dhe ose tregtimi i ushqimeve subjektit NELSA me aktivitet "Prodhimi ose tregtimi i ushqimeve" pasi janë kryer inspektimet i është miratuar licenca për veprimtarinë specifike "Import, eksport, shitje me shumicë e produkteve me origjinë shtazore (për njerëz).

Në shtojcën e ligjit Nr. 10081, datë 23.2.2009 "Për Licencat, Autorizimet dhe Lejet në Republikën e Shqipërisë", Fusha II "Ushqimi dhe Shëndeti", parashikohet shprehimisht:

22 Fusha II. Ushqimi dhe Shëndeti

4 1. Licence Prodhimi dhe/ose tregtimi i ushqimeve

5 2. Licence Shërbime të riprodhimit, krijimit të racave ose veterinarë

6 3 Licence Rritja ose tregtimi i kafshëve

7 4. Licence Prodhimi dhe/ose tregtimi i farërave dhe/ose fidanëve

8 5. Licence Prodhimi dhe/ose tregtimi i Produkteve të Mbrojtjes së Bimëve, plehrave kimike dhe/ose produkteve prej duhaneve.

9 6. Licence Shërbime mjekësore parësore, spitalore ose të stomatologjisë.

10 7. Licence Prodhimi dhe/ose tregtimi i barnave për njerëz ose kafshë.

11 8. Licence Shërbime të tjera shëndetësore dhe/ose higjieno-sanitare.

III.1.9. Në aneksin 1 të VKM Nr.538, datë 26.5.2009 "Për Licencat dhe Lejet që trajtohen nga apo nëpërmjet qendrës Kombëtare të Licencimit dhe disa rregullime të tjera nënligjore të Përbashkëta", Fusha II "Ushqimi dhe Shëndeti", Kategoria II.1 "Prodhim dhe/ose Tregtim i Ushqimeve", parashikohet shprehimisht: 1. Veprimtaria e "prodhimit dhe/ose tregtimit të ushqimeve" është kategoria II.1 e Shtojcës së Ligjit nr.10 081, datë 23.2.2009 "Për licencat, autorizimet dhe lejet në Republikën e Shqipërisë".

2. Kjo licencë ndahet në këto nënkategorit:

a) "Prodhim, përpunim e shpërndarje me shumicë e ushqimeve", me kodin II.1.A:

b) "Shitje me shumicë e ushqimeve me origjinë shtazore (për njerëz)", me kodin II.1.B:

c) "Prodhimi primar me shumicë", me kodin II.1.C.

3. Veprimtaritë e nënkategorisë me kodin II.1.A dhe II.1.C, nuk përfshijnë veprimtaritë për të cilat parashikohet licencimi i posaçëm sipas kategorisë II.3 të shtojcës së ligjit nr.10 081, datë 23.2.2009 "Për licencat, autorizimet dhe lejet në Republikën e Shqipërisë".

4. Licencat për nënkategoritë II.1.A, II.1.B dhe II.1.C janë pa afat.

Gjithashtu referuar përcaktimeve të nenit 40, pika 5/a "Kontrata e mallrave" të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", i ndryshuar, ku përcaktohet se:

15. Për të provuar përshtatshmërinë për të provuar përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale, kapacitetet teknike dhe profesionale autoriteti/enti kontraktor kërkon:

c) licencat profesionale për prodhimin dhe ose furnizimin e mallrave, objekt i kontratës, të lëshuara nga autoritetet kompetente shtetërore: dhe/ose;"

Kriteret për kualifikim vendosen që t'i shërbejnë autoritetit kontraktor për njohjen e gjendjes dhe kapaciteteve të operatorëve ekonomikë, të cilët, nëpërmjet dokumentacionit të paraqitur duhet të vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet ekonomike, financiare dhe organizative, makineritë, pajisjet e asete të tjera fizike, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, gjithçka në funksion të realizimit me sukses të kontratës. Në varësi të kontratës dhe volumit të saj autoriteti kontraktor përcakton dhe kërkesat e veçanta për kualifikim, duke mbajtur në konsideratë kufijtë maksimal të përcaktuar në rregullat e prokurimit publik. Kriteret kualifikuese të përcaktuara nga autoriteti kontraktor janë të detyrueshme për t'u përmbushur nga të gjithë ofertuesit ekonomikë pjesëmarrës në një procedurë prokurimi. Autoriteti kontraktor do të konsiderojë një ofertë të vlefshme, vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentet e tenderit. Për pasojë, Komisioni i shqyrtimit të ankesave gjykon, se operatorët ekonomikë pjesëmarrës në një procedurë prokurimi duhet të plotësojnë vetëm kërkesat e vendosura në dokumentet e tenderit, e rrjedhimisht, vlerësimi e kualifikimi i tyre duhet të bëhet në përputhje vetëm me këto kërkesa. Referuar sa më sipër argumentuar, Komisioni i shqyrtimit të ankesave vëren, se autoriteti kontraktor në kriterin e veçantë të kualifikimit ka kërkuar nga ana e operatorëve ekonomikë: Operatori ekonomik të paraqesë licencën Licencë lëshuar nga Qendra Kombëtare e Biznesit (QKB) me kategoritë e mëposhtëme:

Kategoria: II.1 Prodhimi dhe ose tregtimi i ushqimeve.

Nënkategoria: II.1.A. "Prodhim, përpunim e shpërndarje me shumicë e ushqimeve",

Nga shqyrtimi i dokumentacionit të dorëzuar nga operatori ekonomik "Nelsa" shpk në përmbushje të kriterit specifik mbi të cilin operatori ekonomik "Argent Daci" PF është ankimuar komisioni i shqyrtimit të ankesës konstaton, se është dorëzuar në përputhje me kërkesat në kriter - "Licencë" — LN-0366-03-2020, data e lëshimit 30.03.2020, e vlefshme me kategori II.1 Prodhimi dhe ose tregtimi i ushqimeve dhe nënkategori "Prodhim, përpunim e shpërndarje me shumicë e ushqimeve" sikundër kërkuar në dokumentat e tenderit dhe gjithashtu është lëshuar dhe "Licencë" LN-045411-2009, data e lëshimit 04.11.2009, e vlefshme me Kodi II.1.B të lëshuar nga qendra kombëtare e biznesit ku specifikisht përcaktohet: Kategoria: Prodhimi dhe ose tregtimi i ushqimeve Nënkategoria: Shitje me shumicë e ushqimeve me origjinë shtazore (për njerëz) Emertimi përshkrues i veprimtarisë: Shitje me shumicë e produkteve me origjinë shtazore për njerëz. Pra sa më sipër

argumentuar në asnjë moment autoriteti kontraktor nuk ka gjykuar dhe nuk mund të gjykojë a-priori që operatori ekonomik nuk e disponon mundësinë për të kryer veprimtarinë e furnizimit me produkte me origjinë shtazore nderkohe që në dokumentacionin e paraqitur ne funksion të kërkesave për kapacitetin profesional të operatorëve ekonomik ka paraqitur licence që ka të drejten të ushtrojë veprimtarinë sipas Kategorisë:II.1 Prodhimi dhe/ose tregtimi i ushqimeve., Nënkatëgoria: II.1.A. “Prodhim, përpunim e shpërndarje me shumicë e ushqimeve” dhe gjithashtu ka paraqitur licence të Kategorisë II.1.B për kryerjen e veprimtarisë specifike: “Shitje me shumicë e produkteve me origjinë shtazore për njerëz”.

Komisioni i shqyrtimit të ankesave gjykon, se fakti që subjekti ka deklaruar dhe ka paraqitur licencat përkatëse për ushtrimin e kësaj veprimtarie, ka paraqitur ambient të përshtatshëm për magazinimin e produkteve me origjinë shtazore të pajisur me akt-miratimi higjeno sanitar të lëshuar nga ministria e shëndetësisë, Inspektoriat i Shtetëror Shëndetsor si dhe ka dorëzuar në sistemin e prokurimit publik një sërë kontratash të ngjashme të lidhur me autoritete publike në të cilat ka ushtruar specifikisht këtë veprimtari (furnizim me mish) qartësisht të con në konkluzionin se subjekti “NELSA” shpk ushtron aktivitetin për tregtimin me shumicë të produkteve me origjinë shtazore sikundër autoriteti përcakton në dokumentat e procedurës së prokurimit objekt ankimit konform legjislacionit në fuqi, në fushën e ushqimit.

Në këtë kuptim komisioni i shqyrtimit të ankesës gjykon, se operatori ekonomik “NELSA” shpk është në kushtet e përmbushjes së kërkesës specifike për kriterin e veçante të kualifikimit të përcaktuar në dokumentet e procedurës së prokurimit objekt-ankimi, sa i takon statusit të tij si operator ekonomik që garanton tregtimin dhe furnizimin me produkte me origjinë shtazore dhe gjithashtu në analizim të dokumentacionit të dorëzuar nga operatori ekonomik në sistemin e prokurimit publik rezulton i provuar ky fakt ndërkohë që sipas kriterëve të përcaktuara nuk rezulton asnjë dokument tjetër i përcaktuar nga autoriteti kontraktor dhe që nuk është plotësuar nga operatori ekonomik.

Pra sa më sipër kriteri për kategorinë II.1.A është saktësuar dhe secifikuar nga autoriteti kontraktor dhe rrjedhimisht një ofertë nuk mund të vlerësohet mbi kritere të cilat nuk janë kërkuar nga ana e tij. Në rast skualifikimi të këtij operatori ekonomik autoriteti kontraktor do të ishte në kushte të tejkalimit të kërkesës vendosur në kriterin e veçantë të kualifikimit sipas pikës 2.1.1, dhe të kriterëve për kualifikim të vendosura prej tij të cilat referuar dokumentacionit të paraqitur janë përmbushur nga ana e operatorit ekonomik “NELSA” shpk.

Rrjedhimisht, pretendimi i operatorit ekonomik ankimit nuk qëndron nuk është i argumentuar dhe nuk mbështetet në ligj dhe në fakt.

Sa më sipër pretendimet e ngritura në ankesën e paraqitur nga operatori ekonomik “Argent Daci” PF për operatorët pjesëmarrës në këtë procedurë të renditur para tij në kualifikim nuk qëndrojnë dhe për rrjedhojë Komisioni i Shqyrtimit të Ankesave vendosi të mos marrë parasysh ankesën e bërë nga operatori ekonomik “Argent Daci” PF, duke lënë në fuqi vendimin e Komisionit të Vlerësimit të ofertave për procedurën e prokurimit me objekt “Blerje mish për kafshët e Kopshtit Zoologjik për vitin 2024.”

II.9. Me shkresën e datës 29.01.2024, protokolluar me tonën me nr. 113/4 prot., datë 01.02.2024 operatori ekonomik Argent Daci P.F pas vendimmarrjes së KSHA-së ka paraqitur argumenta shtesë në lidhje me ankimin.

II.10. Me shkresën nr. 113/5 prot., datë 15.02.2024 KPP ka njoftuar autoritetin kontraktor, operatorët ekonomikë ankimes dhe Agjencinë e Prokurimit Publik se për shkak të nevojës së një hetimi më të thelluar administrativ nuk është e mundur dalja me një vendim përfundimtar brenda afatit të përcaktuar në ligjin e prokurimit publik.

II.11. Me shkresën nr. 113/6 prot., datë 19.02.2024, KPP iu drejtua me kërkesën për informacion Autoritetit Kombëtar të Ushqimit si më poshtë: “[...] Cila është licenca e aplikueshme në përputhje me legjislacionin sektorial në fuqi për subjektet që tregtojnë mishin për kafshët si dhe cili është përshkrimi i veprimtarisë specifike në këtë rast? [...]”

II.12. Me shkresën e protokolluar me tonën, me datë 21.02.2024, me nr. 113/7 prot., me objekt “Lidhur me tuajën nr.113/5 prot. datë 15.02.2024 ‘Vënie në dijeni’”, ka dërguar në KPP informacion shtesë në mbështetje të ankesës së tij.

II.13. Në përgjigje të shkresës së KPP me nr. 113/5 prot., datë 15.02.2024, AKU me shkresën nr. 973/1 prot., datë 23.02.2024 ka informuar KPP si më poshtë:

“- Në përgjigje të shkresës suaj nr. nr. 113/6 prot., datë 19.2.2024, me lëndë “Kërkesë për informacion”, citojmë: “Cila është licenca e aplikueshme në përputhje me legjislacionin sektorial në fuqi për subjektet që tregtojnë mishin për kafshët, si dhe cili është përshkrimi i veprimtarisë specifike në këtë rast”, ju informojmë si më poshtë vijon.

- Çdo subjekt që kryen veprimtari me natyrë ekonomike jovetjake në fushën e ushqimit “prodhim dhejose tregtim të ushqimeve”, duhet të regjistrohet dhe licencohet sipas legjislacionit në fuqi pranë QKB (Qendra Kombëtare e Biznesit).

- Proçedura e regjistrimit dhe licencimit kryhet në përputhje me: Ligjin Nr.9863, datë 28.1.2008 “Për Ushqimin” i ndryshuar (neni 19), Ligjit Nr 13172015 “Për Qendrën Kombëtare të Biznesit”, Ligjit nr.10081, datë 23.2.2009 “Për Licencat, Autorizimet dhe Lejet në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar, Vendimit me Nr.538, datë 26.5.2009 “Për licencat dhe lejet që trajtohen nga apo nëpërmjet QKB dhe disa rregullave të tjera nënligjore të përbashkëta” e ndryshuar si dhe akte të tjera ligjore nënligjore në fuqi.

- Veprimtaria në kompetencë të AKU-së : “Prodhimi dhe/tose Tregtimi i ushqimeve”, është kategoria II.1 e Shtojcës së Ligjit Nr.10081, datë 23.2.2009 “Për licencat, autorizimet dhe lejet në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, ku përkatësisht për rastin Tuaj është nënkategoria II.1.B: Shitje me shumicë e ushqimeve me origjinë shtazore për njerëz, e cila përdoret edhe në rastet e aktiviteti import të produkteve me origjinë shtazore.

-Aplikimet për licencim bëhen në portalin e-Albania dhe dokumentacioni i nevojshëm gjendet në faqen zyrtare të AKU [www.aku.gov.al](http://www.aku.gov.al) si dhe të QKB-së [www.qkb.gov.al](http://www.qkb.gov.al).”

II.14. Me shkresën nr. 113/9 prot., datë 27.02.2024 KPP i është drejtuar sërish AKU me kërkesën për informacion si më poshtë:

[..]A duhet të pajisen me licencën e kategorisë II.1 dhe nënkategori me kodin II.1.A subjektet që ushtojnë veprimtarinë e tregtimit të mishit për kafshët?

Nëse po, bazuar në Vendimin e Këshillit të Ministrave Nr.538, datë 26.05.2009 “Për licencat dhe lejet që trajtohen nga apo nëpërmjet Qendrës Kombëtare të Licencimit (QKL) dhe disa rregullime të tjera nënligjore të përbashkëta” fusha II “Ushqimi dhe shëndeti”, “Kategoria II.1 “Prodhimi dhe/ose tregtimi i ushqimeve” kreu II “Licencimi i veprimtarive të



*nënkategorisë II.1.A” pika 6, cila prej veprimtarive me kodin II.1.A.1, II.1.A.2 apo II.1.A.3 të nënkategorisë II.1.A aplikohet/aplikohen në këtë rast?[...]”*

II.15. Në përgjigje të kërkesës më sipër të KPP, me shkresën nr. 1139/1 prot., datë 01.03.2024, protokolluar me tonën me nr.113/10 prot., datë 04.03.2023 AKU ka njoftuar KPP si më poshtë:

- Në përgjigje të shkresës suaj nr. nr. 11349 prot., datë 27.2.2024, me lëndë “Kërkesë për informacion”, citojmë: “A duhet të pajisen me licencën e kategorisë II.1 dhe nënkategori me kodin II.1.A subjektet që ushtrojnë ushtrojnë veprimtarinë e tregtimit të mishit për kafshë”, ju informojmë si më poshtë vijon.

- Referuar përshkrimin të veprimtarisë që i përket veprimtarisë me Kod II.I.B: “Shitje me shumicë e ushqimeve me origjinë shtazore (për njerëz)”, subjekti ka detyrim ligjor licencimin, pra nëse kryen vetëm aktivitet importuesitregtues për produktet ushqimore me origjinë shtazore.

- Nëse subjekti kryen aktivitet prodhuesi përpunues të mishit dhe produkteve me bazë mishi”, duhet të pajiset me licencë me kod veprimtarie II.I.A 1 me aktivitet “Prodhim, përpunim e shpërndarje me shumicë e ushqimeve”, veprimtari specifike: “Prodhim, përpunim, ambalazhim, etiketim e shpërndarje me shumicë e ushqimeve për njerëz (mish dhe produkte me bazë mishi)”, gjithashtu, sqarojmë se në këtë licencë i ka të përfshirë importet dhe lëndët e para për prodhimin e ushqimeve, përfshirë ruajtjen, transportin, shitjen ose furnizimin e konsumatorit përfundimtar.

II.16. Në datën 22.01.2024, pranë Komisionit të Prokurimit Publik, është administruar ankesa me numër 143 prot., e operatorit ekonomik “Nelsa” SHPK. Nga shqyrtimi paraprak i ankesës së sipërcituar, u konstatua se objekti i ankesës lidhet me vendimmarrjen e Komisionit të Vlerësimit të Ofertave mbi kualifikimin e ofertës së paraqitur nga operatorët ekonomikë “4 S” SHPK dhe “M.C Catering” SHPK. Gjithashtu, nga informacioni i autoritetit kontraktor rezulton, se ankesa është dorëzuar pranë këtij të fundit me datë 22.01.2024 me nr. 112/6 prot.

II.17. Në përputhje me nenin 112 “Veprimet paraprake” të Ligjit nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik”, Komisioni i Prokurimit Publik me marrjen e ankesës, e publikoi atë në bazën e të dhënave të tij, e cila përmban të dhëna për: a) ankimuesin, adresën dhe NUIS-in; b) të dhëna të plota për procedurën e prokurimit (objekt, numër reference, fond limit, datën e zhvillimit të procedurës), si dhe është publikuar formulari i publikimit Nr. 143/2 prot., datë 23.01.2024.

II.7. Nga shqyrtimi i akteve të ndodhura në fashikullin e shqyrtimit administrativ rezulton, se operatorët ekonomikë të interesuar nuk kanë dorëzuar argumente në përputhje me nenin 113 të LPP-së, në formë shkresore dhe në sistemin e ankesave elektronike.

II.8. Me shkresën nr. 112/10 prot., datë 23.01.2024, protokolluar me tonën me nr. 143/3 prot., datë 29.01.2024, është depozituar nga autoriteti kontraktor në Komisionin e Prokurimit Publik, akti mbi trajtimin e ankesës së operatorit ekonomik ankimues “Nelsa” SHPK, lidhur me procedurën e mësipërme të prokurimit, nga ku rezulton se autoriteti kontraktor ka vendosur mospranimin e ankesës konkretisht duke argumentuar: “[...]”

II.9. Me shkresën e datës 29.01.2024, protokolluar me tonën me nr. 113/4 prot., datë 01.02.2024, operatori ekonomik Argent Daci P.F pas vendimmarrjes së KSHA-së ka paraqitur argumenta shtesë në lidhje me ankimin.

II.10. Me shkresën nr. 113/5 prot., datë 15.02.2024, KPP ka njoftuar autoritetin kontraktor, operatorët ekonomikë ankimues dhe Agjencinë e Prokurimit Publik, se për shkak të nevojës së një hetimi më të thelluar administrativ, nuk është e mundur dalja me një vendim përfundimtar brenda afatit të përcaktuar në ligjin e prokurimit publik.

II.11. Me shkresën nr. 113/6 prot., datë 19.02.2024, KPP iu drejtua me kërkesën për informacion Autoritetit Kombëtar të Ushqimit si më poshtë: “[...] Cila është licenca e aplikueshme në përputhje me legjislacionin sektorial në fuqi për subjektet që tregtojnë mishin për kafshët si dhe cili është përshkrimi i veprimtarisë specifike në këtë rast? [...]”

1.1 Në lidhje me pretendimin e ngritur nga operatori ekonomik ankimues se operatori ekonomik “MC Catering” shpk nuk plotëson “Kriteret e veçanta për kualifikim” pika 1, germa (a) si më poshtë: Operatori ekonomik “NELSA” shpk duke marrë në konsideratë gabimet që bëhen nga operatorët ekonomikë në plotësimin e Formularit Përmbledhës të Vetdeklarimit ngre dyshime që operatori ekonomik “MC Catering” shpk nuk ka përcaktuar numrin e punonjësve të disponueshëm stafin që do të angazhohet për realizimin e kontratës dhe nuk ka përcaktuar të dhënat për mjetin në komisioni i shqyrtimit të ankesës sqarojmë sa më poshtë vijon: Referuar dokumentave standarte të procedurës së prokurimit shtojca 7 “Kriteret e veçanta për kualifikim” ,pika 1, germa (a) përcaktohet sa më poshtë: Ofertuesi duhet të paraqesë: a. Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës 8 Gjithashtu në Kriteret e veçanta për kualifikim, Kapaciteti teknik është kërkuar që pikat 2.3.3, 2.3.4, 2.3.5 dhe 2.3.7 të plotësohen nëpërmjet plotësimit të formularit përmbledhës të vetdeklarimit sa më poshtë: 2.3.3 Numri mesatar i punonjësve të siguruar duhet të jetë jo më pak se 5 (pesë) punonjës për periudhën 3 muaj Shtator 2023—Dhjetor 2023. Për të vërtetuar këtë operatori ekonomik duhet të paraqesë: a) Vërtetim nga Sigurimet Shoqërore/ose Administrata Tatimore për periudhën Shtator 2023—Dhjetor 2023. b) Listëpagesat sipas formës që kërkohet nga legjislacioni në fuqi për periudhën Shtator 2023—Dhjetor 2023. Ky kriter do të përmbushet nga OE me anë të Formularit Përmbledhës së Vetëdeklarimit sipas Shtojcës 8. Operatori ekonomik i kualifikuar i pari në klasifikim duhet të dorëzojë pranë AK, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve ankimit, të gjithë dokumentacionin provues për vetëdeklarimet në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit. 2.3.4.Operatori ekonomik duhet të dëshmojë se ka të punësuar ose ka të kontraktuar si ekspert të jashtëm 1 (një) punonjës të diplomuar si zooteknik ose veteriner Për punonjësit sa më sipër, ofertuesi duhet të paraqesë :

- Kontratën individuale të punës:
- Diplomen

Kriteri sipas pikës 2.3.5 do të përmbushet nga OE me anë të Formularit Përmbledhës së Vetëdeklarimit sipas shtojcës 8. Operatori ekonomik i kualifikuar i pari në klasifikim duhet të dorëzojë pranë AK, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve ankimit, të gjithë dokumentacionin provues për vetëdeklarimet në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit. 2.3.5 Operatori ekonomik ofertues duhet të ketë të punësuar minimalisht 2 (dy) punonjës shoferë. Për këto punonjës duhet të paraqitet kontrata e punës e vlefshme, dëshmitë e drejtimit (të vlefshme).

Kriteri sipas pikës 2.3.5 do të përmbushet nga OE me anë të Formularit Përmbledhës së Vetëdeklarimit sipas shtojces 8. Operatori ekonomik i kualifikuar i pari në klasifikim duhet të dorëzojë pranë AK, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve ankimit, të gjithë dokumentacionin provues për vetëdeklarimet në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit. 2.3.7 Operatori Ekonomik ofertues duhet të disponojë të paktën një mjet transporti ATV (Frigoriferik) , në pronësi/qira përdorim sipas kontratës noteriale, për të cilin duhet të paraqitet në tender dhe të vërtetohet:

- Dokumentacionin që vërteton pronësinë e mjetit marrjen me qira/përdorimin me huapërdorje.
- Leje qarkullimi e mjetit.
- Çertifikatë e kontrollit teknik të mjetit.
- Policë për sigurimin e detyrueshëm të mjetit.
- Aktmiratimi higjienosanitar të mjetit.
- Operatori ekonomik duhet të paraqesë foto për mjetin e deklaruar, ku të jetë e dukshme dhe targa e mjetit.

Ky kriter do të përmbushet nga OE me anë të Formularit Përmbledhës së Vetëdeklarimit. Dokumentacioni provues, i cili vërteton pagimin e taksave dhe tarifave vendore do të dorëzohet vetëm nga operatori ekonomik i shpallur fitues përpara lidhjes së kontratës.

Nga verifikimi dhe shqyrtimi i dokumentacionit të paraqitur në sistemin elektronik nga operatori ekonomik "MC Catering" shpk komisioni i shqyrtimit të ankesave konstaton se në përmbushje të këtij kriteri operatori ekonomik ka paraqitur Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit sipas Shtojcës 8 të dokumentave të tenderit.

Në nenin 26 "Formulari përmbledhës i vetëdeklarimit", pikat 1, 2, 3, 6 dhe 7 të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik" i ndryshuar, parashikohet shprehimisht se: "Bashkë me dorëzimin e kërkesave për pjesëmarrje ose të ofertave, autoriteti/enti kontraktor pranon si provë paraprake në vend të disa vërtetimeve të lëshuara nga autoritetet publike ose palë të treta formularin rërmbledhës të vetëdeklarimit sipas përcaktimit në nenin 82 të LPP-së dhe në këto rregulla.

2. Formulari përmbledhës i vetëdeklarimit përmban informacion dhe deklarimin, si më poshtë vijon:

a) operatori ekonomik është i regjistruar në regjistrin tregtar sipas legjislacionit të vendit ku ushtron aktivitetin ose sipas legjislacionit të posaçëm, në rastin e një organizate jofitimprurëse, ka në fushën e veprimtarisë objektin e prokurimit, dhe ka statusin aktiv:

b) operatori ekonomik nuk është dënuar për asnjë nga veprat penale, të parashikuara në pikën 1, të nenit 76, të LPP-së:

c) personi/at në cilësinë e anëtarit të organit administrativ, drejtuesit ose mbikëqyrësit, aksionerit ose ortakut, ose që ka kompetenca përfaqësuese, vendimmarrjeje ose kontrolluese brenda operatorit ekonomik, nuk është ose ka qenë i dënuar me vendim gjyqësor të formës së prerë për asnjë nga veprat penale, të përcaktuara në pikën 1, të nenit 76, të LPP-së,

ç) operatori ekonomik nuk është dënuar me vendim të gjykatës së formës së prerë, për vepra që lidhen me veprimtarinë profesionale:

d) operatori ekonomik nuk është në proces falimentimi:

dh) operatori ekonomik ka paguar të gjitha detyrimet për pagimin e taksave dhe tatimeve i të kontributeve të sigurimeve shoqërore, sipas parashikimeve të pikës 2, të nenit 76, të LPP-së:

e) operatori ekonomik ka shlyer të gjitha detyrimet e maturuara të energjisë elektrike, dhe përmbush kërkesat që rrjedhin nga legjislacioni i fushës në fuqi. Ky informacion kërkohet për

operatorët ekonomikë, të cilët ushtrojnë veprimtarinë në territorin e Republikës së Shqipërisë:

ë) operatori ekonomik nuk ndodhet në kushtet e konfliktit të interesit, sipas legjislacionit në fuqi:

f) operatori ekonomik ushtron aktivitetin në zbatim të kërkesave ligjore të legjislacionit mjedisor, social dhe të punës:

g) operatori ekonomik ka paraqitur ofertë të pavarur, sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, gj) operatori ekonomik përmbush specifikimet teknike, sipas kërkesave të përcaktuara nga autoriteti/enti kontraktor,

h) operatori ekonomik disponon fuqinë punëtore, të nevojshme për ekzekutimin e kontratës, sipas kërkesave të autoritetit/entit kontraktor (kur është rasti):

i) operatori ekonomik disponon mjetet dhe makineritë e nevojshme për ekzekutimin e kontratës, sipas kërkesave të autoritetit/entit kontraktor, kur është rasti:

j) informacion mbi subjektet, mbi kapacitetet e të cilave, operatori ekonomik do të mbështetet, nëse është rasti dhe nënkontraktorët e mundshëm, nëse është rasti:

k) operatori ekonomik ushtron aktivitetin konform kërkesave të legjislacionit në fuqi.

3. Informacioni i pasqyruar në formularin e vetëdeklarimit, i cili gjendet në një bazë të dhënash, ku autoriteti/enti kontraktor mund të aksesojë direkt këtë informacion dhe Jose dokumentin, duhet të shoqërohet me adresën përkatëse për këtë bazë të dhënash.

4. Për përmbushjen e detyrimit sipas këtij neni, operatorët ekonomikë mund të përdorin një formular vetëdeklarimi që është përdorur gjatë një procedure prokurimi të mëparshme, nëse informacioni që ajo përmban vazhdon të jetë i saktë dhe i vlefshëm.

5. Operatorëve ekonomikë nuk u kërkohet të dorëzojnë dokumente mbështetëse, kur autoriteti ose enti kontraktor që ka dhënë kontratën ose ka lidhur marrëveshjen kuadër, i ka këto dokumente. 6. Përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, autoriteti/enti kontraktor i kërkon ofertuesit të kualifikuar, i pari dorëzimin e dokumenteve provuese të parashikuara në shkronjat “a”, “b”, “d”, “dh”, “e”, “Sh”, “I”, “J” të pikës 2 të këtij neni, si dhe dokumentet e tjera shoqëruese të ofertës, të dorëzuara në rrugë elektronike. Këto dokumente duhet të paraqiten në origjinal ose në kopje të njësuar me origjinalin.

Nga verifikimi i formularit përmbledhës të vetdeklarimit të paraqitur nga operatori ekonomik “MC Catering” shpk konstatohet se operatori ekonomik në Pjesa III: Kriteret e përzgjedhjes) kualifikimit të Formularit Përmbledhës të vetdeklarimit germa (B) ka deklaruar sikundër kërkuar në këtë formular dhe në kriteret e vendosura në dokumentat e tenderit, kriteret e veçanta për kualifikim, kapaciteti teknik pika 2.3.3 numrin mesatar të punonjësve II (njëmbëdhjetë) punonjës për periudhën shtator-dhjetor 2023 .

Operatori ekonomik ka deklaruar se ka kontraktuar një ekspert të jashtëm punonjës të diplomuar veteriner punonjës I.M sikundër përcaktuar në kriteret e veçanta për kualifikim, kapaciteti teknik pika 2.3.4

Ka deklaruar se disponon punonjës në profilin shofer punonjës B.I dhe IS sikundër përcaktuar në kriteret e veçanta për kualifikim, kapaciteti teknik pika 2.3.5 Dhe ka deklaruar referuar kriterit përcaktuar në pikën 2.3.7 mjetin ATV të deklaruar me qera me targa AA 394 RE për të cilin ka deklaruar markën, nr e shasisë dhe vitin e prodhimit. Pra sa më sipër nga shqyrtimi i dokumentacionit të dorëzuar në SPE, Komisioni i shqyrtimit të ankesës konstaton, se operatori ekonomik ankimues në dorëzimin e Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit, ka plotësuar të gjitha të dhënat e mundshme, për rastet kur të

dhënat janë të aksesueshme në mënyrë elektronike nga autoriteti kontraktor, ka plotësuar në mënyrë korrekte të gjitha fushat e kërkuara në Pjesa III Kriteret e përzgjedhjes/kualifikimit si dhe është plotësuar pjesa e fundit e formularit ku kërkohet data e dorëzimit, emri, mbiemri, firma si edhe vula e shoqërisë.

Në përfundim të analizës së fakteve përkatëse, Komisioni i shqyrtimit të ankesave arrin në konkluzionin se Formulari Përmbledhës i Vetdeklarimit i paraqitur nga operatori ekonomik MC Catering shpk në procedurën e prokurimit, është plotësuar me korrektësi duke plotësuar kërkesat e autoritetit kontraktor dhe konsiderohet i vlefshëm. Sa më sipër, pretendimi i operatorit ekonomik ankimues nuk qëndron nuk është i argumentuar dhe nuk mbështetet në ligj dhe në fakt.

1.2 Në lidhje me pretendimin e ngritur nga operatori ekonomik ankimues se operatori ekonomik “MC Catering” shpk nuk plotëson “Kriteret e veçanta për kualifikim”, “Kapaciteti profesional i operatorëve ekonomik” pika 2.1.3, si më poshtë: Në lidhje me pretendimin e operatorit ekonomik “NELSA” shpk i cili parashtron se ka dyshime të arsyeshme se operatori ekonomik “MC Catering” shpk nuk është certifikuar sipas standarteve ISO 9001:2015 ose ekuivalent, ISO 22000:2018 ose ekuivalent dhe UNI 10854:99 H.A.C.C.P për aktivitetin “Për prodhimin dhe tregtimin e produkteve ushqimore me origjinë shtazore dhe jo shtazore” duke mos vërtetuar që kryejnë aktivitetin sipas standarteve kombëtare dhe ndërkombëtare të kërkuara si dhe ngre dyshime se këto certifikata janë jashtë afatit të vlefshmërisë në komisioni i shqyrtimit të ankesës sqarojmë sa më poshtë vijon: Referuar dokumentave standarte të procedurës së prokurimit shtojca 7 pika 2 “Kapaciteti profesional i operatorëve ekonomik” pika 2.1.3 përcaktohet sa më poshtë: 2.1.3 Operatori Ekonomik Ofertues, duhet të jetë i pajisur dhe të paraqesë në procedurën e prokurimit publik certifikatat përkatëse të vlefshme të ISO-ve, si më poshtë, ose ekuivalente, të lëshuara nga organizma ndërkombëtare ose shoqëri të akredituara në Republikën e Shqipërisë, të cilat duhet të jenë të vlefshme datën e hapjes së procedurës së prokurimit publik:

ISO 9001:2015) certifikatën e menaxhimit të cilësisë, Për prodhimin dhe tregtimin e produkteve ushqimore me origjinë shtazore dhe jo shtazore: ose ekuivalente. ISO 22000:2018 për sistemin e menaxhimit të sigurisë ushqimore: Për prodhimin dhe tregtimin e produkteve ushqimore me origjinë shtazore dhe jo shtazore: ose ekuivalente. UNI 10854:99 H.A.C.C.P. për sistemin e menaxhimit të autokontrollit në parimet H.A.C.C.P (për Higjenën);, Për prodhimin dhe tregtimin e produkteve ushqimore me origjinë shtazore dhe jo shtazore, ose ekuivalente. Certifikatat e mësipërme duhet të jenë të lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtare akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë. Në rastet e Bashkimit të Operatorëve ekonomik, çdo anëtar i grupit duhet të paraqesë Certifikatën ISO sipas zërave që do të marrë përsipër të realizojë referuar akt-marrëveshjes. Ky kriter duhet të plotësohet për secilin lot.

Nga verifikimi i dokumentacionit të paraqitur në sistemin e prokurimit elektronik konstatojmë sa më poshtë vijon:

Operatori ekonomik “MC Catering” shpk në plotësim të këtij kriteri ka paraqitur

1. Certifikatë EN-ISO 9001:2015 me Nr. AQS/Q/34972018 lëshuar nga AQScert me afat vlefshmërie 01.09.2024 ku në fushën e aktivitetit përcaktohet specifikisht: “Tregtimi me shumicë dhe pakicë i produkteve ushqimore me origjinë shtazore dhe joshtazore”

2. *Çertifikatë EN-ISO 22000:2018 me Nr.AQS/SA/92682022 lëshuar nga AQScert me afat vlefshmërie 13.10.2025 ku në fushën e aktivitetit përcaktohet specifikisht: “Tregtimi me shumicë dhe pakicë i produkteve ushqimore me origjinë shtazore dhe joshtazore”*

*Çertifikatë UNI 10854:99 H.A.C.C.P me Nr.AQS/H/65272021 lëshuar nga AQScert me afat vlefshmërie 18.02.2024 ku në fushën e aktivitetit përcaktohet specifikisht:*

*“Tregtimi me shumicë dhe pakicë i produkteve ushqimore me origjinë shtazore dhe joshtazore Pra sa më sipër lehtësisht verifikuar në sistemin elektronik të prokurimit konstatohet se operatori ekonomik ka paraqitur dokumentacion të plotë dhe të rregullt sikundër përcaktuar në pikën 2.1.3 të Kriterëve të Veçanta për kualifikim, Kapaciteti profesional i operatorëve ekonomik, dhe asnjë nga pretendimet e operatorit ekonomik ankimues nuk qëndron dhe nuk është i bazuar në fakt. 1.3 Në lidhje me pretendimin e ngritur nga operatori ekonomik ankimues se operatori ekonomik “MC Catering” shpk nuk ka plotësuar deklaratën referuar “Kriterëve të veçanta të kualifikimit”, “Kapaciteti Teknik” paragrafi i fundit i dokumentave standarte te tenderit parashikohet se: Në çdo rast AK ka të drejtë të kryejë verifikimet e nevojshme mbi vërtetësinë e informacionit të deklaruar nga operatori ekonomik ose ti kërkojë operatorit ekonomik ofertues sqarime dhe dokumente mbështetëse për këto sqarime. Operatori ekonomik itues duhet të dorëzojë pranë AK, përpara lidhjes së kontratës, të gjithë dokumentacionin provues për vetëdeklarimin në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit. Deklaratë me shkrim nga administratori i shoqërisë ofertuese, ku të specifikohet që jemi dakort me këtë deklaratë me si komision i shqyrtimit të ankesës sqarojmë sa më poshtë vijon: Në lidhje me deklaratën e specifikuar që Autoriteti Kontraktor ka të drejtë të kryejë verifikimet e nevojshme mbi vërtetësinë e informacionit të deklaruar nga operatori ekonomik ose ti kërkojë operatorit ekonomik ofertues sqarime dhe dokumenta mbështetëse për këto sqarime bëjmë me dije se operatori ekonomik në formularin përmbledhës të vetdeklarimit pjesa e fundit ka deklaruar sa më sipër kërkuar cka është nënshkruar dhe vulosur nga operatori ekonomik.*

*Sa më sipër pretendimi Juaj nuk qëndron nuk është i bazuar në fakt dhe nuk merret parasysh nga komisioni i shqyrtimit të ankesave. IL.1 Në lidhje me pretendimin e ngritur nga operatori ekonomik ankimues se operatori ekonomik “4 S” shpk nuk plotëson “Kriteret e veçanta për kualifikim” pika 1, germa (a) si më poshtë: Në lidhje me pretendimin e operatorit ekonomik “NELSA” shpk i cili duke marrë në konsideratë gabimet që bëhen nga operatorët ekonomikë në plotësimin e Formularit përmbledhës të vetdeklarimit ngre dyshime që operatori ekonomik “4 S” shpk nuk ka përcaktuar numrin mesatar te punonjësve, stafin që do të angazhohet për realizimin e kontratës dhe nuk ka përcaktuar të dhënat e mjetit ne si komision i shqyrtimit të ankesës sqarojmë sa më poshtë vijon:*

*Referuar dokumentave standarte te procedurës së prokurimit shtojca 7 “Kriteret e veçanta për kualifikim” pika 1, germa (a) përcaktohet sa më poshtë: Ofertuesi duhet të paraqesë:*

*a. Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës 8*

*Gjithashtu në Kriteret e vecanta për kualifikim, Kapaciteti teknik është kërkuar që pikat 2.3.3, 2.3.4, 2.3.5 dhe 2.3.7 të plotësohen nëpërmjet plotësimit të formularit përmbledhës të vetdeklarimit sa më poshtë:*

*2.3.3 Numri mesatar i punonjësve të siguruar duhet të jetë jo më pak se 5 (pesë) punonjës për periudhën 3 muaj Shtator 2023—Dhjetor 2023. Për të vërtetuar këtë operatori ekonomik duhet të paraqesë:*

c) Vërtetim nga Sigurimet Shoqërore/ose Administrata Tatimore për periudhën Shtator2023—Dhjetor 2023.

d) Listëpagesat sipas formës që kërkohet nga legjislacioni në fuqi për periudhën Shtator2023—Dhjetor 2023. Ky kriter do të përmbushet nga OE me anë të Formularit Përmbledhës së Vetëdeklarimit sipas Shtojcës 8. Operatori ekonomik i kualifikuar i pari në klasifikim duhet të dorëzojë pranë AK, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve ankimit, të gjithë dokumentacionin provues për vetëdeklarimet në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit. 2.3.4. Operatori ekonomik duhet të dëshmojë se ka të punësuar ose ka të kontraktuar si ekspert të jashtëm 1 (një) punonjës të diplomuar si zooteknik ose veteriner Për punonjësit sa më sipër, ofertuesi duhet të paraqesë :

- Kontratën individuale të punës:

- Diplomen

Kriteri sipas pikës 2.3.5 do të përmbushet nga OE me anë të Formularit Përmbledhës së Vetëdeklarimit sipas shtojcës 8. Operatori ekonomik i kualifikuar i pari në klasifikim duhet të dorëzojë pranë AK, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve ankimit, të gjithë dokumentacionin provues për vetëdeklarimet në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit.

2.3.5 Operatori ekonomik ofertues duhet të ketë të punësuar minimalisht 2 (dy) punonjës shoferë. Për këto punonjës duhet të paraqitet kontrata e punës e vlefshme, dëshmitë e drejtimit (të vlefshme).

Kriteri sipas pikës 2.3.5 do të përmbushet nga OE me anë të Formularit Përmbledhës së Vetëdeklarimit sipas Shtojcës 8. Operatori ekonomik i kualifikuar i pari në klasifikim duhet të dorëzojë pranë AK, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve ankimit, të gjithë dokumentacionin provues për vetëdeklarimet në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit. 2.3.7 Operatori Ekonomik ofertues duhet të disponojë të paktën një mjet transporti ATV (Frigoriferik), në pronësilqiralpërdorim sipas kontratës noteriale, për të cilin duhet të paraqitet në tender dhe të vërtetohet: e Dokumentacionin që vërteton pronësinë e mjetit marrjen me qiralpërdorimin me huapërdorje. Leje qarkullimi e mjetit. Çertifikatë e kontrollit teknik të mjetit. Policë për sigurimin e detyrueshëm të mjetit. Akt miratimi higjienosanitar të mjetit.

Operatori ekonomik duhet të paraqesë foto për mjetin e deklaruar, ku të jetë e dukshme dhe targa e mjetit. Ky kriter do të përmbushet nga OE me anë të Formularit Përmbledhës së Vetëdeklarimit.

Dokumentacioni provues, i cili vërteton pagimin e taksave dhe tarrave vendore do të dorëzohet vetëm nga operatori ekonomik i shpallur itues përpara lidhjes së kontratës.

Nga verifikimi dhe shqyrtimi i dokumentacionit të paraqitur në sistemin elektronik nga operatori ekonomik “4 S” shpk komisioni i shqyrtimit të ankesave konstaton se në përmbushje të këtij kriteri operatori ekonomik ka paraqitur Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit sipas Shtojcës 8 të dokumentave të tenderit. Në nenin 26 “Formulari përmbledhës i vetëdeklarimit”, pikat 1, 2, 3, 6 dhe 7 të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, parashikohet shprehimisht se: “Bashkë me dorëzimin e kërkesave për pjesëmarrje ose të ofertave, autoriteti/enti kontraktor pranon si provë paraprake, në vend të disa vërtetimeve të lëshuara nga autoritetet publike ose palë të treta formularin përmbledhës të vetëdeklarimit sipas përcaktimit në nenin 82 të LPP-së dhe në këto rregulla.

2. Formulari përmbledhës i vetëdeklarimit përmban informacion dhe deklarimin, si më poshtë vijon:

a) operatori ekonomik është i regjistruar në regjistrin tregtar sipas legjislacionit të vendit ku ushtron aktivitetin ose sipas legjislacionit të posaçëm, në rastin e një organizate jofitimprurëse, ka në fushën e veprimtarisë objektin e prokurimit, dhe ka statusin aktiv:

b) operatori ekonomik nuk është dënuar për asnjë nga veprat penale, të parashikuara në pikën 1, të nenit 76, të LPP-së,

c) personi/at në cilësinë e anëtarit të organit administrativ, drejtuesit ose mbikëqyrësit, aksionerit ose ortakut, ose që ka kompetenca përfaqësuese, vendimmarrjeje ose kontrolluese brenda operatorit ekonomik, nuk është ose ka qenë i dënuar me vendim gjyqësor të formës së prerë për asnjë nga veprat penale, të përcaktuara në pikën 1, të nenit 76, të LPP-së,

ç) operatori ekonomik nuk është dënuar me vendim të gjykatës së formës së prerë, për vepra që lidhen me veprimtarinë profesionale:

d) operatori ekonomik nuk është në proces falimentimi,

dh) operatori ekonomik ka paguar të gjitha detyrimet për pagimin e taksave dhe tatimeve 1 të kontributeve të sigurimeve shoqërore, sipas parashikimeve të pikës 2, të nenit 76, të LPP-së,

e) operatori ekonomik ka shlyer të gjitha detyrimet e maturuara të energjisë elektrike, dhe përmbush kërkesat që rrjedhin nga legjislacioni i fushës në fuqi. Ky informacion kërkohet për operatorët ekonomikë, të cilët ushtrojnë veprimtarinë në territorin e Republikës së Shqipërisë:

ë) operatori ekonomik nuk ndodhet në kushtet e konfliktit të interesit, sipas legjislacionit në fuqi:

f) operatori ekonomik ushtron aktivitetin në zbatim të kërkesave ligjore të legjislacionit mjedisor, social dhe të punës:

g) operatori ekonomik ka paraqitur ofertë të pavarur, sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi,

gj) operatori ekonomik përmbush specifikimet teknike, sipas kërkesave të përcaktuara nga autoriteti/enti kontraktor,

h) operatori ekonomik disponon fuqinë punëtore, të nevojshme për ekzekutimin e kontratës, sipas kërkesave të autoriteti/entit kontraktor (kur është rasti):

1) operatori ekonomik disponon mjetet dhe makineritë e nevojshme për ekzekutimin e kontratës, sipas kërkesave të autoritetit kontraktor, kur është rasti:

j) informacion mbi subjektet, mbi kapacitetet e të cilave, operatori ekonomik do të mbështetet, nëse është rasti dhe nënkontraktorët e mundshëm, nëse është rasti:

k) operatori ekonomik ushtron aktivitetin konform kërkesave të legjislacionit në fuqi.

3. Informacioni i pasqyruar në formularin e vetëdeklarimit, i cili gjendet në një bazë të dhënash, ku autoriteti/enti kontraktor mund të aksesojë direkt këtë informacion dhe Jose dokumentin, duhet të shoqërohet me adresën përkatëse për këtë bazë të dhënash.

4. Për përmbushjen e detyrimit sipas këtij neni, operatorët ekonomikë mund të përdorin një formular vetëdeklarimi që është përdorur gjatë një procedure prokurimi të mëparshme, nëse informacioni që ajo përmban vazhdon të jetë i saktë dhe i vlefshëm.

5. Operatorëve ekonomikë nuk u kërkohet të dorëzojnë dokumente mbështetëse, kur autoriteti ose enti kontraktor që ka dhënë kontratën ose ka lidhur marrëveshjen kuadër, ji ka këto dokumente. 6. Përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, autoriteti kontraktor i kërkon ofertuesit të kualifikuar, i pari dorëzimin e dokumenteve provuese të parashikuara në shkronjat “a”, “b”, “Ad”, “dh”, “e”, “h”, 7, “J” të pikës 2 të



këtij neni, si dhe dokumentet e tjera shoqëruese të ofertës, të dorëzuara në rrugë elektronike. Këto dokumente duhet të paraqiten në origjinal ose në kopje të njësuara me origjinalin.

Nga verifikimi i formularit përmbledhës të vetdeklarimit të paraqitur nga operatori ekonomik "4 S" shpk konstatohet se operatori ekonomik në Pjesa III: Kriteret e përzgjedhjeskualifikimit të Formularit Përmbledhës të vetdeklarimit germa (B) ka deklaruar sikundër kërkuar në këtë formular dhe në kriteret e vendosura në dokumentat e tenderit, kriteret e veçanta për kualifikim, kapaciteti teknik pika 2.3.3 numrin mesatar të punonjësve 24 (njëzet e katër) punonjës për periudhën shtator-dhjetor 2023 .

Operatori ekonomik ka deklaruar në Formularin përmbledhës të vetdeklarimit se ka pjesë të stafit punonjës të diplomuar veteriner dhe ka paraqitur të gjithë dokumentacionin mbështetës për punonjësën J.P (Kontratë pune dhe diplomë) sikundër përcaktuar në kriteret e veçanta për kualifikim, kapaciteti teknik pika 2.3.4 Operatori ekonomik ka deklaruar në Formularin përmbledhës të vetdeklarimit se ka pjesë të stafit punonjës në profilin shofer dhe ka paraqitur të gjithë dokumentacionin për punonjësën A.RR dhe L.S (kontratë pune dhe leje drejtimi) sikundër përcaktuar në kriteret e veçanta për kualifikim, kapaciteti teknik pika 2.3.5 Operatori ekonomik ka deklaruar në Formularin përmbledhës të vetdeklarimit referuar kriterit përcaktuar në pikën 2.3.7 në dispozicion të realizimit të kontratës mjetet me targa AA 288 RV, AA 951 SA, AA 475 IR, AB 492 EU, AA 253 RC, AA 839 OB si dhe ka paraqitur me dokumentacion plotësues mjetin ATV me targa AB 492 EU.

Pra sa më sipër nga shqyrtimi i dokumentacionit të dorëzuar në SPE, Komisioni i shqyrtimit të ankesës konstaton, se operatori ekonomik ankimues në dorëzimin e Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit, ka plotësuar të gjitha të dhënat e mundshme, për rastet kur të dhënat janë të aksesueshme në mënyrë elektronike nga autoriteti kontraktor, ka plotësuar në mënyrë korrekte të gjitha fushat e kërkuara në Pjesa III Kriteret e përzgjedhjeskualifikimit mbi disponimin e punonjësve, stafit dhe makinerive, ka plotësuar pjesën e fundit të formularit ku kërkohet data e dorëzimit, emri, mbiemri, firma si edhe vula e shoqërisë si dhe ka paraqitur në sistemin elektronik të prokurimit dokumentacion të plotë provues sikundër përcaktuar në dokumentat e tenderit për punonjësën shofer dhe veteriner si dhe për mjetin frigoriferik AB 492 EU që do të vihet në dispozicion të autoritetit kontraktor për realizimin e kontratës.

Në përfundim të analizës së fakteve përkatëse, Komisioni i shqyrtimit të ankesave arrin në konkluzionin se Formulari Përmbledhës i vetdeklarimit i paraqitur nga operatori ekonomik 4 S shpk në procedurën e prokurimit shoqëruar gjithashtu me dokumentacion provues në të cilin pasqyrohet vërtetësia dhe saktësia e informacionit të deklaruar në formularin përmbledhës të vetdeklarimit plotëson kërkesat e autoritetit kontraktor dhe konsiderohet i vlefshëm për këtë fazë.

Sa më sipër, pretendimi i operatorit ekonomik ankimues nuk qëndron nuk është i argumentuar dhe nuk mbështetet në ligj dhe në fakt.

II.2 Në lidhje me pretendimin e ngritur nga operatori ekonomik ankimues se operatori ekonomik "4 S" shpk nuk plotëson "Kriteret e veçanta për kualifikim", "Kapaciteti profesional i operatorëve ekonomik" pika 2.1.3, si më poshtë:

Në lidhje me pretendimin e operatorit ekonomik "NELSA" shpk i cili citon në ankesën e bërë se ka dyshime të arsyeshme se operatori ekonomik "4 S" nuk është certifikuar sipas standarteve ISO 9001:2015 ose ekuivalent, ISO 22000:2018 ose ekuivalent dhe UNI 10854:99 H.A.C.C.P për aktivitetin "Për prodhimin dhe tregtimin e produkteve ushqimore

*me origjinë shtazore dhe jo shtazore” duke mos vërtetuar që kryejnë aktivitetin sipas standarteve kombëtare ne si komision sqarojmë sa më poshtë poshtë vijon:*

*Referuar dokumentave standarte te procedurës së prokurimit shtojca 7 pika 2 “Kapaciteti profesionali operatorëve ekonomik” pika 2.1.3 përcaktohet sa më poshtë:*

*2.1.3 Operatori Ekonomik Ofertues, duhet të jetë i pajisur dhe të paraqesë në procedurën e prokurimit publik çertifikatat përkatëse të vlefshme të ISO-ve, si më poshtë, ose ekuivalente, të lëshuara nga organizma ndërkombëtare ose shoqëri të akredituara në Republikën e Shqipërisë, të cilat duhet të jenë të vlefshme datën e hapjes së procedurës së prokurimit publik:*

*ISO 9001:2015/ çertifikatën e menaxhimit të cilësisë: produkteve ushqimore me origjinë shtazore dhe jo shtazore: ose ekuivalente.*

*ISO 22000:2018 për sistemin e menaxhimit të sigurisë ushqimore: Për prodhimin dhe tregtimin e produkteve ushqimore me origjinë shtazore dhe jo shtazore: ose ekuivalente.*

*UNI 10854:99 H.A.C.C.P. për sistemin e menaxhimit të autokontrollit në parimet H.A.C.C.P (për Higjenën): Për prodhimin dhe tregtimin e produkteve ushqimore me origjinë shtazore dhe jo shtazore: ose ekuivalente. Çertifikatat e mësipërme duhet të jenë të lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtare akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë. Në rastet e Bashkimit të Operatorëve ekonomik, çdo anëtar i grupit duhet të paraqesë Çerti ikatën ISO sipas zërave që do të marrë përsipër të realizojë re eruar akt-marrëveshjes.*

*Ky kriter duhet të plotësohet për secilin lot. Nga verifikimi i dokumentacionit të paraqitur në sistemin e prokurimit elektronik konstatojmë sa më poshtë vijon: Operatori ekonomik 4 S shpk në plotësim të këtij kriteri ka paraqitur*

*4. Çertifikatë EN-ISO 9001:2015 me Nr. AQS/Q/ 89722022 lëshuar nga AQScert me afat vlefshmërie deri më 15.07.2025 ku në fushën e aktivitetit përcaktohet specifikisht:*

*“Tregtimi me shumicë dhe pakicë i produkteve ushqimore me origjinë shtazore dhe joshtazore” Çertifikatë EN-ISO 22000:2018 me Nr.AQSISA89752022 lëshuar nga AQScert me 15.07.2025 ku në fushën e aktivitetit përcaktohet specifikisht:*

*5. afat vlefshmërie “Tregtimi me shumicë dhe pakicë i produkteve ushqimore me origjinë shtazore dhe joshtazore”*

*6. Çertifikatë UNI 10854:99 H.A.C.C.P me Nr.AQS HJ89772022 lëshuar nga AQScert me afat vlefshmërie 15.07.2025 ku në fushën e aktivitetit përcaktohet specifikisht:*

*“Tregtimi me shumicë dhe pakicë i produkteve ushqimore me origjinë shtazore dhe joshtazore Pra sa më sipër lehtësisht verifikuar në sistemin elektronik të prokurimit konstatohet se operatori ekonomik ka paraqitur dokumentacion të plotë dhe të rregullt sikundër përcaktuar në pikën 2.1.3 të Kriterëve të Veçanta për kualifikim, Kapaciteti profesional i operatorëve ekonomik, dhe asnjë nga pretendimet e operatorit ekonomik ankimues nuk qëndron dhe nuk është i bazuar në fakt.*

*II.3 Në lidhje me pretendimin e ngritur nga operatori ekonomik ankimues se operatori ekonomik “4 S” shpk nuk ka plotësuar deklaratën referuar “Kritereve të veçanta të Kualifikimit”, “Kapaciteti Teknik” paragrafi i fundit i dokumentave standarte te tenderit parashikohet se: Në çdo rast AK ka të drejtë të kryejë verifikimet e nevojshme mbi vërtetësinë e informacionit të deklaruar nga operatori ekonomik ose ti kërkojë operatorit ekonomik ofertues sqarime dhe dokumente mbështetëse për këto sqarime.*

*Operatori ekonomik itues duhet të dorëzojë pranë AK, përpara lidhjes së kontratës, të gjithë dokumentacionin provues për vetëdeklarimin në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit. Deklaratë me shkrim nga administratori i shoqërisë ofertuese, ku të speci ikohet që jemi dakort me këtë deklaratë ne si komision i shqyrtimit të ankesës sqarojmë sa më poshtë vijon: Në lidhje me deklaratën që Autoriteti Kontraktor ka të drejtë të kryejë verifikimet e nevojshme mbi vërtetësinë e informacionit të deklaruar nga operatori ekonomik ose ti kërkojë operatorit ekonomik ofertues sqarime dhe dokumenta mbështetëse për këto sqarime bëjmë me dije se operatori ekonomik ka paraqitur deklaratë specifike për këtë kriter e cila vërtetohet lehtësisht në dokumentat e paraqitura nga operatori ekonomik në sistemin elektronik të prokurimit. Sa më sipër pretendimi Juaj nuk qëndron nuk është i bazuar në fakt dhe nuk merret parasysh nga komisioni i shqyrtimit të ankesave.*

*Sa më sipër pretendimet e ngritura në ankesën e paraqitur nga operatori ekonomik “NELSA” SHPK për operatorët pjesëmarrës në këtë procedurë të renditur para tij në kualifikim nuk qëndrojnë dhe për rrjedhojë Komisioni i Shqyrtimit të Ankesave vendosi të mos marrë parasysh ankesën e bërë nga operatori ekonomik “NELSA” PF, duke lënë në fuqi vendimin e Komisionit të Vlerësimit të ofertave për procedurën e prokurimit me objekt “Blerje mish për kafshët e Kopshtit Zoologjik për vitin 2024”.*

II.12. Me shkresën nr. 143/4 prot., datë 14.02.2024 KPP, iu drejtua autoriteti kontraktor për të vënë në dispozicion të KPP dokumentacionin e dorëzuar nga operatori ekonomik “M.C Catering” SHPK, pranë autoritetit kontraktor.

II.13. Më shkresën nr. 112/13 prot.,, datë 19.02.2024, protokolluar me tonën me nr. 143/5 prot., datë 20.02.2024, autoriteti kontraktor ka vënë në dispozicion të KPP dokumentacionin e kërkuar më sipër.

II.14. Më datë 07.03.2024, KPP mori vendimin nr.247/2024 ku vendosi:

- 1. Të urdhërojë paraqitjen e dokumentacionit origjinal ose kopje e noterizuar e tyre, nga ana e subjektit “4 S” SHPK, në përmbushje të kërkesave autoritetit kontraktor, të parashikuara në pikat 2.3.3, 2.3.4, 2.3.5 dhe 2.3.7 të kapacitetit teknik, të kriterëve të vecanta të kualifikimit të dokumentave të procedurës së prokurimit “Procedurë e hapur e thjeshtuar”, me Nr. REF-91784-12-20-2023, me objekt: “Blerje mish për kafshët e Kopshtit Zoologjik për vitin 2024”, me fond limit 9 015 678 lekë (pa tvsh), zhvilluar me datë 03.01.2024 nga autoriteti kontraktor, Agjencia e Parqeve dhe Rekreacionit.*
- 2. Ky dokumentacion të paraqitet pranë Komisionit të Prokurimit Publik brenda datës 11.03.2024.*

*Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.*

II.15. Referuar materialeve të fashikullit të shqyrtimit administrativ rezulton se nuk janë paraqitur argumente nga subjekte të interesuara në kuptim të nenit 113 të LPP-së në fromë shkresore dhe as në sistemin e ankesave elektronike.

### III

#### Komisioni i Prokurimit Publik

pas shqyrtimit të ankesave, dokumentacionit bashkëngjitur tyre, si dhe informacionit të autoritetit kontraktor,

#### Arsyeton

III.1. Lidhur me pretendimin e operatorit ekonomik ankimues “Argent Daci” PF mbi kundërshtimin e kualifikimit të operatorëve ekonomikë “Nelsa” SHPK, “4S” SHPK dhe “MC Catering” SHPK, me argumentin se nuk plotësojnë kriterin e përcaktuar në shtojcën 7, kriteret e veçanta të kualifikimit, Kapaciteti profesional i operatorëve ekonomikë” pika 2.1.1, pasi sipas tij licenca e nënkategorisë II.1 A e zotëruar prej tyre, është e përcaktuar për veprimtari specifike, “Prodhim, përpunim e shpërndarje me shumicë e ushqimeve për njerëz (katering dhe shërbim katering), (restorant dhe furrë buke), (bar restorant dhe ambalazhim i fruta dhe perimeve)” Komisioni i Prokurimit Publik vëren se,

III.1.1. Në shtojcën 7 “Kriteret e veçanta të kualifikimit”, pika 2.1.1 “Kapaciteti profesional i operatorëve ekonomikë”, përcaktohet kriteri si më poshtë:

*2.1.1 Operatori ekonomik te paraqesë licencën Licence leshuar nga Qendra Kombetare e Biznesit (QKB) me kategoritë e mëposhtëme:*

*Kategoria: II.1 Prodhimi dhe/ose tregtimi i ushqimeve.*

*Nënkategoria: II.1.A. “Prodhim, përpunim e shpërndarje me shumicë e ushqimeve”,*

*Licenca duhet të jetë në emër të operatorit ekonomik pjesëmarrës në procedurë pasi duhet ti përkasë operatorit të interesuar të ofertojë për procedurën e prokurimit të shpallur nga Autoriteti Kontraktor.*

*Në rastet e bashkimit të operatorëve ekonomikë secili prej anëtarëve të bashkimit të operatorëve duhet të ketë Licensën, Nënkategoria: II.1.A*

*(Nuk lejohet përdorimi i Licencës së një operatori tjetër ekonomik, sipas Rekomandimit të përbashkët të APP-së dhe AKU-së të datës 19.11.2018. Për këtë arsye detyrimisht Operatori ekonomik pjesëmarrës duhet të jetë i licensuar sipas dispozitave përkatëse ligjore dhe nënligjore).*

III.1.2. Nga verifikimet në sistemin e prokurimeve elektronike rezulton, se operatori ekonomik “Nelsa” SHPK, në përmbushje të kriterit sa më sipër ka dorëzuar dokumentacionin si më poshtë:

- *Licencë me Kodin II.1.A LN-0366-03-2020 dhe me miratim kërkesë me Nr. 599/2 prot, datë 27.03.2020 me emërtim përshkrues të veprimtarisë Prodhim, përpunim, shpërndarje me shumicë e ushqimeve për njerëz (ambalazhim i frutave dhe perimeve).*

*Operatori ekonomik “4S” SHPK në përmbushje të kriterit sa më sipër ka dorëzuar dokumentacionin si më poshtë:*

- *Licencë me Kodin II.1.A LN-3561-07-2017 me emërtim përshkrues të veprimtarisë Prodhim, përpunim e shpërndarje me shumicë e ushqimeve për njerëz, (Furrë buke dhe prodhime pasticerie).*

*Operatori ekonomik “MC Catering” SHPK në përmbushje të kriterit sa më sipër ka dorëzuar dokumentacionin si më poshtë:*

- *Licencë me Kodin II.1.A.1 LN-0241-09-2009 dhe me miratim kërkesë me Nr. 4454/2 prot, datë 29.10.2020, me emërtim përshkrues të veprimtarisë Prodhim, përpunim e shpërndarje me shumicë e ushqimeve për njerëz*

III.1.3. Në nenin 21 të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, parashikohet shprehimisht se: *“1. Autoriteti ose enti kontraktor është përgjegjës për prokurimin në përputhje me dispozitat e këtij ligji dhe të akteve nënligjore të nxjerra në zbatim të tij, duke garantuar respektimin e parimeve të trajtimit të barabartë, transparencës, konkurrencës dhe mosdiskriminimit, të parashikuara në këtë ligj. Në kuptim të kësaj pike, autoriteti ose enti kontraktor ka detyrimin të mirëplanifikojë në cilësi dhe në kohë fondet publike e nevojat e tij dhe të prokurojë e të zbatojë kontratën në përputhje me legjislacionin në fuqi.”*

III.1.4. Në nenin 77, të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, parashikohet shprehimisht se: *1. Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë kërkesat për kualifikim për operatorët ekonomikë bazuar në:*

- a) përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale;*
- b) gjendjen ekonomike dhe financiare;*
- c) aftësinë teknike dhe profesionale.*

*Kërkesat kufizohen vetëm në ato që janë të përshtatshme për të garantuar që një kandidat ose ofertues të ketë kapacitetet juridike, financiare dhe aftësitë teknike e profesionale për të zbatuar kontratën që do të jepet. Të gjitha kërkesat duhet të kenë lidhje dhe të jenë proporcionale me objektin e kontratës.*

*2. Për sa i përket përshtatshmërisë për të kryer një veprimtari profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të regjistrohen në një nga regjistrat profesionalë ose tregtarë.*

*Në procedurat e prokurimit për shërbime, ku është e nevojshme që operatorët ekonomikë të kenë një autorizim të veçantë ose të jenë anëtarë të një organizate të veçantë për të kryer shërbimin në fjalë në shtetin e tyre të origjinës, autoriteti ose enti kontraktor mund t'u kërkojë atyre të vërtetojnë se e kanë këtë autorizim ose anëtarësim.*

*3. Në lidhje me situatën ekonomike dhe financiare, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë kanë kapacitetin e nevojshëm ekonomik dhe financiar për të zbatuar kontratën.*

*Për këtë qëllim autoritetet ose entet kontraktore mund të kërkojnë në veçanti që operatorët ekonomikë të kenë një xhiro vjetore minimale të caktuar. Gjithashtu, autoritetet ose entet kontraktore mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të japin informacione në bilancet e tyre vjetore që të tregojnë raportet ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit.*

*Xhiroja vjetore minimale që kërkohet nga operatorët ekonomikë nuk mund të tejkalojë dyfishin e vlerës së parashikuar të kontratës.*

*Kur një kontratë ndahet në lote, ky nen zbatohet për çdo lot individual. Megjithatë, autoriteti ose enti kontraktor mund të përcaktojë xhiron vjetore minimale që u kërkohet operatorëve, duke iu referuar grupeve të loteve, në rast se ofertuesi i suksesshëm merr disa lote që duhet të zbatohen në të njëjtën kohë.*

*Në rastin e kontratave që bazohen në një marrëveshje kuadër, kërkesa për xhiron minimale llogaritet mbi bazën e përmasave maksimale të kontratave specifike që do të zbatohen në të njëjtën kohë ose, kur përmasat nuk dihen, mbi bazën e vlerës së parashikuar të marrëveshjes kuadër.*

*4. Në lidhje me aftësitë teknike dhe profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë zotërojnë burimet e nevojshme njerëzore e teknike, si dhe përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën sipas një standardi të përshtatshëm cilësie.*

*Autoritetet ose entet kontraktore, në veçanti, mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të kenë një nivel të mjaftueshëm përvojë që vërtetohet nga referenca të përshtatshme nga kontratat e zbatuara në të shkuarën.*

*Aftësia profesionale e operatorëve ekonomikë për të ofruar shërbimin, punën, mallin vlerësohet në lidhje me aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm për të zbatuar kontratën, siç është përshkruar nga autoriteti ose enti kontraktor në njoftimin e objektit të kontratës.*

*5. Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë në njoftimin e kontratës ose në ftesën për shprehje interesi kriteret e përzgjedhjes, si dhe dokumentet konkrete që duhet të paraqesin operatorët ekonomikë për përmbushjen e këtyre kriterëve.”*

III.1.5. Në nenin 41 pika 4 të VKM Nr.285 datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, parashikohet shprehimisht se:

*Për të provuar përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale, kapacitetet teknike dhe profesionale, autoriteti/enti kontraktor kërkon:*

*a) licenca profesionale për realizimin e shërbimeve, objekt i kontratës, të lëshuara nga autoritetet kompetente shtetërore; dhe /ose*

*b) një listë të personelit kryesor, të nevojshëm për të zbatuar objektin e prokurimit dhe/ose komponentët e saj. Lista e personelit kryesor duhet të përfshijë CV-të e tyre dhe licencat profesionale, kur kanë të tilla sipas legjislacionit përkatës; dhe/ose*

*c) fuqinë punëtore të operatorit ekonomik të nevojshëm për ekzekutimin e objektit të prokurimit; dhe/ose*

*ç) mjetet dhe pajisjet teknike që ka në dispozicion apo që mund t'i vihen në dispozicion operatorit ekonomik për të përmbushur kontratën.*

*d) Në rastin e procedurës së prokurimit “Shërbim konsulence”, stafi i angazhuar të paraqesë deklaratë disponueshmërie për kryerjen e shërbimeve që ka marrë përsipër të realizojë. për këto sqarime, kur kjo është e nevojshme për të garantuar zbatimin korrekt të procedurës.*

III.1.6. Në nenin 5 të ligjit nr. 10081/2009 “Për licencat, autorizimet dhe lejet në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, parashikohet se: “Ushtrimi i veprimtarive dhe kryerja e veprimeve në territorin e Republikës së Shqipërisë janë, si rregull, të lira dhe nuk i nënshtrohen licencimit apo autorizimit, përveçse kur parashikohet ndryshe me ligj”

Gjithashtu, në Aneksin 3 “Përmbajtja orientuese e titullit të licencës dhe kërkesës” në pikën 8 Emertimi i veprimtarisë(ve) specifike të licencuara sqarohet se: a) *Ketu vendoset emertimi i veprimtarisë specifike kur kjo është e kodifikuar.* b) *Kur subjekti ka kërkuar të ushtroje me shume se një veprimtari specifike, ketu vendoset emertimet e të gjitha atyre veprimtarive specifike që ka kërkuar të licencohen.* c) *Nese keto shenime kërkojnë me shume se 250 karaktere atehere vihet shenimi: Per llojet e specifikimeve shih dokumentin bashkëlidhur Nr.....”*

III.1.7. Në nenin 3, pika 16, të ligjit nr. 9863, datë 28.01.2008 “Për ushqimin”, parashikohet shprehimisht se: *“Faza të prodhimit, përpunimit dhe shpërndarjes” është çdo fazë, përfshirë importet dhe lëndët e para për prodhimin e ushqimeve, përfshirë ruajtjen, transportin, shitjen ose furnizimin e konsumatorit përfundimtar dhe, në mënyrë të ngjashme, importimin, prodhimin, ruajtjen, transportin, shpërndarjen, shitjen dhe furnizimin e ushqimeve për kafshë”.*

III.1.8. Në nenin 19, pika 1, të ligjit nr. 9863, datë 28.01.2008 “Për ushqimin”, parashikohet shprehimisht se: *“Veprimtaritë e prodhimit primar, të përpunimit, magazinimit, ruajtjes, transportit, tregtimit me shumicë apo pakicë, përfshirë edhe në hapësira të lëvizshme dhe/ose të përkohshme, të përcaktuara në këtë ligj, përfshihen në kategorinë II.1 të shtojcës së ligjit për licencat. Licencimi i këtyre veprimtarive, për çdo operator e për çdo stabiliment, bëhet sipas ligjit për licencat.*

III.1.9. Në shtojcën e ligjit Nr. 10 081, datë 23.2.2009 “Për Licencat, Autorizimet dhe Lejet në Republikën e Shqipërisë”, Fusha II “Ushqimi dhe Shëndeti”, parashikohet shprehimisht:

*Fusha II. Ushqimi dhe Shëndeti*

*4 1. Licence Prodhimi dhe/ose tregtimi i ushqimeve*

*5 2. Licence Shërbime të riprodhimit, krijimit të racave ose veterinarë*

*6 3 Licence Rritja ose tregtimi i kafshëve*

*7 4. Licence Prodhimi dhe/ose tregtimi i farërave dhe/ose fidanëve*

*8 5. Licence Prodhimi dhe/ose tregtimi i Produkteve të Mbrojtjes së Bimëve, plehrave kimike dhe/ose produkteve prej duhaneve.*

*9 6. Licence Shërbime mjekësore parësore, spitalore ose të stomatologjisë.*

*10 7. Licence Prodhimi dhe/ose tregtimi i barnave për njerëz ose kafshë.*

*11 8. Licence Shërbime të tjera shëndetësore dhe/ose higjieno-sanitare.*

III.1.10. Në aneksin 1 të VKM Nr.538, datë 26.5.2009 “Për Licencat dhe Lejet që trajtohen nga apo nëpërmjet qendrës Kombëtare të Licencimit dhe disa rregullime të tjera nënligjore të Përbashkëta”, Fusha II “Ushqimi dhe Shëndeti”, Kategoria II.1 “Prodhim dhe/ose Tregtim i Ushqimeve”, parashikohet shprehimisht:

*1. Veprimtaria e “prodhimit dhe/ose tregtimit të ushqimeve” është kategoria II.1 e Shtojcës së Ligjit nr. 10 081, datë 23.2.2009 “Për licencat, autorizimet dhe lejet në Republikën e Shqipërisë”.*

*2. Kjo licencë ndahet në këto nënkategori:*

*a) “Prodhim, përpunim e shpërndarje me shumicë e ushqimeve”, me kodin II.1.A;*

*b) “Shitje me shumicë e ushqimeve me origjinë shtazore (për njerëz)”, me kodin II.1.B;*

*c) “Prodhimi primar me shumicë”, me kodin II.1.C.*

3. Veprimtaritë e nënkategorisë me kodin II.1.A dhe II.1.C, nuk përfshijnë veprimtaritë për të cilat parashikohet licencimi i posaçëm sipas kategorisë II.3 të shtojcës së ligjit nr.10 081, datë 23.2.2009 “Për licencat, autorizimet dhe lejet në Republikën e Shqipërisë”.

4. Licencat për nënkategoritë II.1.A, II.1.B dhe II.1.C janë pa afat.

III.1.11. Në nenin 17, “Rregulla të përbashkëta për kërkesën për licencë/autorizim/leje për të gjitha grupet” të ligjit nr. 10081, datë 23.02.2009, “Për Licencat, Autorizimet dhe Lejet në Republikën e Shqipërisë”, parashikohet shprehimisht se:

1. Kërkesa për licencë/autorizim/leje apo nënkategori të tyre paraqitet në QKL, sipas procedurave të nenit 34 të këtij ligji.

2. Kërkesa përbëhet nga formulari tip i plotësuar dhe dokumentet shoqëruese përkatëse.

3. Formulari tip përmban, të paktën, këto të dhëna:

a) emërtimin e kategorisë /nënkategorisë;

b) llojin e veprimtarisë, veprimin apo të së mirës publike e të përdorimit të saj;

c) të dhënat për identifikimin e kërkuarit dhe të personit që paraqet kërkesën;

ç) vendin apo vendet e ushtrimit të veprimtarisë, të kryerjes së veprimin apo përdorimit të së mirës;

d) të dhëna të tjera specifike, sipas kategorisë /nënkategorisë;

dh) deklaratën e kërkuarit, që vërteton se i njeh kriteret e licencimit/autorizimit/lejimit dhe i përmbush ato (për kriteret, përmbushja e të cilave vetëdeklarohet);

e) deklaratën për vërtetësinë e dokumenteve shoqëruese dhe/ose që i njeh dhe/ose i pranon detyrimet e licencimit/autorizimit/lejimit dhe do t'i përmbushë ato;

ë) adresën për komunikim;

f) listën e dokumenteve shoqëruese që duhet paraqitur.

4. QKL-ja nuk mund të kërkojë paraqitjen e dokumenteve apo dhënien e informacioneve të tjera, të paparashikuara në formular.

5. Formulari i plotësuar dhe dokumentet shoqëruese, për çdo kërkesë të paraqitur, publikohen nga QKL-ja në regjistër, brenda ditës së nesërme të punës nga data e paraqitjes së kërkesës.

III.1.12. Në nenin 23, “Përmbajtja e titullit të licencës/autorizimit/lejes” të ligjit nr. 10081, datë 23.02.2009, “Për Licencat, Autorizimet dhe Lejet në Republikën e Shqipërisë”, parashikohet shprehimisht se:

1. Licenca/autorizimit/leja lëshohet në bazë të formularëve të miratuar, që përbëjnë titullin e saj.

2. Titulli përmban, të paktën, këto të dhëna:

a) emrin dhe stemën e QKL-së;

b) serinë, numrin dhe datën e miratimit dhe të hyrjes në fuqi;

c) të dhënat për identifikimin e titullarit;

ç) llojin e veprimtarisë, veprimin apo të së mirës publike dhe të përdorimit të saj;

d) vendin ku ushtrohet veprimtaria, kryhet veprimi apo përdoret e mira (nëse është përcaktuar si e dhënë e nevojshme për kategorinë/nënkategorinë);

dh) kufizimet në ushtrimin e veprimtarisë, në kryerjen e veprimin apo në përdorimin e së mirës

publike (nëse ka);

e) afatin e vlefshmërisë;



ë) nënshkrimin e përfaqësuesit të autorizuar të QKL-së dhe vulën përkatëse të institucionit;  
f) të dhëna të tjera specifike, sipas kategorisë/nënkategorisë;  
g) aneksin.

3. Aneksi përmban të gjitha detyrimet specifike apo të përgjithshme, sipas legjislacionit në fuqi, që duhet të respektojë titullari gjatë të gjithë periudhës së vlefshmërisë së saj.

III.1.13. KPP gjykon, se kriteret për kualifikim vendosen që t'i shërbejnë autoritetit kontraktor për të krijuar një panoramë të përgjithshme të kapaciteteve dhe mundësisë së operatorit për përmbushje me sukses të kontratës. Në varësi të kontratës dhe volumit të saj autoriteti kontraktor përcakton kërkesat e veçanta për kualifikim, të cilat janë të detyrueshme për t'u përmbushur nga operatorët ekonomikë pjesëmarrës në procedurat e prokurimit. Operatorët ekonomikë janë të detyruar të përgatisin ofertat, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në dokumentet e tenderit dhe ofertat që nuk përgatiten në përputhje me këto dokumente duhet të refuzohen si të papranueshme. Gjithashtu një ndër parimet kryesore të zhvillimit të procedurës së prokurimit është ai barazisë në trajtimin e kërkesave dhe të detyrimeve, që u ngarkohen ofertuesve ose kandidatëve, parashikuar nga neni 3 i ligjit nr. Nr. 162/2020 "Për prokurimin publik", të ndryshuar. Zbatimi i parimit të transparencës, barazisë dhe mosdiskriminimit, janë garancitë kyçe ndaj ofertuesve që ofron kuadri ligjor në fuqi. Këto parime ndër të tjera nënkuptojnë, se operatorët ekonomikë duhej të jenë në një pozicion barazie, si kur përgatisin ofertat e tyre, ashtu dhe kur të vlerësohen ato. KPP gjykon, se autoriteti kontraktor në përputhje me nenin 2 dhe 3 të ligjit 162/2021 "Për prokurimin publik" ka për detyrë d) të sigurojë një trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për të gjithë operatorët ekonomikë, pjesëmarrës në procedurat e prokurimit publik; dhe të garantojnë trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për operatorët ekonomikë, si dhe të veprojnë me transparencë e në mënyrë proporcionale. Referuar kriterëve të veçanta të kualifikimit, autoriteti kontraktor ka kërkuar se : *2.1.1 Operatori ekonomik te paraqesë licencen leshuar nga Qendra Kombetare e Biznesit (QKB) me kategoritë e mëposhtme: Kategoria: II.1 Prodhimi dhe/ose tregtimi i ushqimeve. Nënkatëgoria: II.1.A. "Prodhim, përpunim e shpërndarje me shumicë e ushqimeve", Licenca duhet të jetë në emër të operatorit ekonomik pjesëmarrës në procedurë pasi duhet ti përkasë operatorit të interesuar të ofertojë për procedurën e prokurimit të shpallur nga Autoriteti Kontraktor. Në rastet e bashkimit të operatorëve ekonomikë secili prej anëtarëve të bashkimit të operatorëve duhet të ketë Licensën, Nënkatëgoria: II.1.A* (Nuk lejohet përdorimi i Licencës së një operatori tjetër ekonomik, sipas Rekomandimit të përbashkët të APP-së dhe AKU-së të datës 19.11.2018. Për këtë arsye detyrimisht Operatori ekonomik pjesëmarrës duhet të jetë i licensuar sipas dispozitave përkatëse ligjore dhe nënligjore). Akoma më tej, KPP vëren, se autoriteti kontraktor ka përcaktuar në dokumentet e procedurës së prokurimit objekt - ankimi, që operatori ekonomik duhet të jetë i pajisur nga qendra Kombetare e Licencimit edhe me licencë të kategorisë II.1.B lidhur me shitjen me shumicë të produkteve shtazore dhe të nënprodukteve. Nga shqyrtimi në tërësi i dokumentacionit të dorëzuar nga operatorët ekonomikë "Nelsa" SHPK, "4 S" SHPK dhe "MC Catering" SHPK në përmbushje të kriterit sa më sipër, kanë dorëzuar dokumentacionin e përmendur në pikën III.1.2. të këtij vendimi konkretisht: Operatori ekonomik "Nelsa" SHPK në përmbushje të kriterit sa më sipër ka dorëzuar: Licencë me Kodin II.1.A LN-0366-03-2020 dhe me miratim kërkese me Nr. 599/2 prot, datë 27.03.2020, me emërtim përshtues të veprimtarisë, Prodhim, përpunim, shpërndarje me shumicë e ushqimeve për njerëz (ambalazhim i frutave dhe perimeve); Operatori ekonomik "4 S" SHPK ka dorëzuar Licencë

me Kodin II.1.A LN-3561-07-2017, me emërtim përshkrues të veprimtarisë, Prodhim, përpunim e shpërndarje me shumicë e ushqimeve për njerëz, (Furrë buke dhe prodhime pasticerie); Operatori ekonomik “MC Catering” SHPK në përmbushje të kriterit sa më sipër ka dorëzuar; Licencë me Kodin II.1.A.1 LN-0241-09-2009 dhe me miratim kërkesë me Nr. 4454/2 prot, datë 29.10.2020, me emërtim përshkrues të veprimtarisë, Prodhim, përpunim e shpërndarje me shumicë e ushqimeve për njerëz. Duke qenë se në dokumentet e tenderit autoriteti kontraktor ka parashikuar dorëzimin nga operatorët ekonomikë të licencës me kodin II.1.A, si dhe atë me kodin II.1.B, KPP në funksion të unifikimit të vendimmarrjes në rastet e procedurave të prokurimit që kanë si objekt blerjen e mishit për kafshë, si dhe me qëllim kryerjen e një hetimi të thelluar administrativ dhe të sqarimit të të gjithë rrethanave e fakteve që lidhen me shqyrtimin e drejtë e objektiv të çështjes, me shkresën nr. 113/6 prot., datë 19.02.2024, iu drejtua me kërkesën për informacion Autoritetit Kombëtar të Ushqimit (në vijim AKU) si vijon “[...] Cila është licenca e aplikueshme në përputhje me legjislacionin sektorial në fuqi për subjektet që tregtojnë mishin për kafshët si dhe cili është përshkrimi i veprimtarisë specifike në këtë rast?” nga ku AKU me shkresën 973/1 prot. datë 23.02.2024, protokolluar me tonën me nr. 113/8 prot., datë 26.02.2024, ka njoftuar KPP se: “Çdo subjekt që kryen veprimtari me natyrë ekonomike jovetjake në fushën e ushqimit “prodhim dhe/ose tregtim të ushqimeve”, duhet të regjistrohet dhe licencohet sipas legjislacionit në fuqi pranë QKB (Qendra Kombëtare e Biznesit).

- Procedura e regjistrimit dhe licencimit kryhet në përputhje me: Ligjin Nr.9863, datë 28.1.2008 “Për Ushqimin” i ndryshuar (neni 19), Ligjit Nr 13172015 “Për Qendrën Kombëtare të Biznesit”, Ligjit nr.10081, date 23.2.2009 “Për Licencat, Autorizimet dhe Lejet në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar, Vendimit me Nr.538, datë 26.5.2009 “Për licencat dhe lejet që trajtohen nga apo nëpërmjet QKB dhe disa rregullave të tjera nënligjore të përbashkëta” e ndryshuar si dhe akte të tjera ligjore nënligjore në fuqi.

- Veprimtaria në kompetence të AKU-së : “Prodhimi dhe/ose Tregtimi i ushqimeve”, është kategoria II.1 e Shtojcës së Ligjit Nr.10081, datë 23.2.2009 “Për licencat, autorizimet dhe lejet në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar , ku përkatësisht për rastin Tuaj është nënkategoria II.1.B: Shitje me shumicë e ushqimeve me origjinë shtazore për njerëz, e cila përdoret edhe në rastet e aktiviteti import të produkteve me origjinë shtazore.

-Aplikimet për licencim bëhen në portalin e-Albania dhe dokumentacioni i nevojshëm gjendet në faqen zyrtare të AKU [www.aku.gov.al](http://www.aku.gov.al) si dhe të QKB-së [www.qkb.gov.al](http://www.qkb.gov.al).” Akoma më tej KPP iu drejtua sërish AKU përmes shkresës me nr.113/9 prot., datë 27.02.2024, duke kërkuar informacionin si vijon [...]A duhet të pajisen me licencën e kategorisë II.1 dhe nënkategori me kodin II.1.A subjektet që ushtojnë veprimtarinë e tregtimit të mishit për kafshët?

Nëse po, bazuar në Vendimin e Këshillit të Ministrave Nr.538, datë 26.05.2009 “Për licencat dhe lejet që trajtohen nga apo nëpërmjet Qendrës Kombëtare të Licencimit (QKL) dhe disa rregullime të tjera nënligjore të përbashkëta” fusha II “Ushqimi dhe shëndeti”, “Kategoria II.1 “Prodhimi dhe/ose tregtimi i ushqimeve” kreu II “Licencimi i veprimtarive të nënkategorisë II.1.A” pika 6, cila prej veprimtarive me kodin II.1.A.1, II.1.A.2 apo II.1.A.3 të nënkategorisë II.1.A aplikohet/aplikohen në këtë rast?[...]” dhe ku në përgjigje të kërkesës më sipër AKU me shkresën nr. 1139/1 prot., datë 01.03.2024 protokolluar me tonën me nr.113/10 prot., datë 04.03.20234, ka njoftuar KPP si më poshtë: - Referuar përshkrimin të veprimtarisë që i përket veprimtarisë me Kod II.1.B: “Shitje me shumicë e ushqimeve me

*origjinë shtazore (për njerëz)”, subjekti ka detyrim ligjor licencimin, pra nëse kryen vetëm aktivitet importuesi tregtues për produktet ushqimore me origjinë shtazore.*

*- Nëse subjekti kryen aktivitet prodhuesi përpunues të mishit dhe produkteve me bazë mishi”, duhet të pajiset me licencë me kod veprimtarie II.I.A 1 me aktivitet “Prodhim, përpunim e shpërndarje me shumicë e ushqimeve”, veprimtari specifike: “Prodhim, përpunim, ambalazhim, etiketim e shpërndarje me shumicë e ushqimeve për njerëz (mish dhe produkte me bazë mishi)”, gjithashtu, sqarohet se në këtë licencë i ka të përfshira importet dhe lëndët e para për prodhimin e ushqimeve, përfshirë ruajtjen, transportin, shitjen ose furnizimin e konsumatorit përfundimtar.” Kështu, në nenin 77 të ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, parashikohet se: “Kërkesat kufizohen vetëm në ato që janë të përshtatshme për të garantuar që një kandidat ose ofertues të ketë kapacitetet juridike, financiare dhe aftësitë teknike e profesionale për të zbatuar kontratën që do të jepet. Të gjitha kërkesat duhet të kenë lidhje dhe të jenë proporcionale me objektin e kontratës”. Vetë ligjvënësi ka parashikuar, se kërkesat e vendosura në dokumentet e procedurës së prokurimit duhet të jenë në proporcion me objektin e kontratës. Në rastin konkret, objekti i kontratës objekt - prokurimi është blerja e mishit për kafshët, referuar licencave të dorëzuara në SPE nga ana e operatorët ekonomikë “Nelsa” SHPK, “4S” SHPK si dhe “MC Catering” SHPK, rezulton, se këta të fundit për përmbushjen e kriterit të përcaktuar në kriteret e veçanta të kualifikimit, pika 2.1.1 “Kapaciteti profesional i operatorëve ekonomikë” për mospërmbushjen e të cilit ngrihen edhe pretendime nga ankimuesi, disponojnë licenca me veprimtari specifike: Prodhim, përpunim, shpërndarje me shumicë e ushqimeve për njerëz (ambalazhim i frutave dhe perimeve); Prodhim, përpunim e shpërndarje me shumicë e ushqimeve për njerëz, (Furrë buke dhe prodhime pasticerie); Prodhim, përpunim e shpërndarje me shumicë e ushqimeve për njerëz, ndërkohë që objekti i prokurimit është i përcaktuar specifikisht në blerjen e mishit, i cili në rastin konkret është mish për kafshët e Kopshtit Zoologjik Tiranë. Gjithashtu kodi CPV i përzgjedhur nga autoriteti kontraktor për procedurën e prokurimit është 15110000-2 - Mish i cili bazuar në Vendimin nr. 457 datë 30.7.2021 të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e fjalorit të përbashkët të prokurimit” nuk përputhet me veprimtaritë specifike më sipër (ambalazhim i frutave dhe perimeve); (Furrë buke dhe prodhime pasticerie) apo me veprimtarinë përgjithshme dhe të paspecifikuar konkretisht siç është Prodhim, përpunim e shpërndarje me shumicë e ushqimeve për njerëz. Gjithashtu, në ligjin nr. 10081/2009 “Për licencat, autorizimet dhe lejet në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, Aneksi 3 “Përmbajtja orinetuese e titullit të licencës dhe kërkesës” pika 8 Emertimi i veprimtarisë(ve) specifike te licencuara sqarohet se: a) Ketu vendoset emertimi i veprimtarisë specike kur kjo eshte e kodifikuar. b) Kur subjekti ka kerkuar te ushtroje me shume se nje veprimtari specifike, ketu vendosen emertimet e te gjitha atyre veprimtarive specifike qe ka kerkuar te licencohen. c) Nese keto shenime kerkojne me shume se 250 karaktere atehere vihet shenimi: Per llojet e specifikimeve shih dokumentin bashkelidhur Nr.....”. Sa më sipër, referuar komunikimit shkresor me AKU si dhe dokumentacionit të ngarkuar në sistem nga operatorët ekonomikë “Nelsa” SHPK, “4 S” SHPK si dhe “MC catering” SHPK, për përmbushjen e pikës 2.1.1 të kriterëve të veçanta të kualifikimit, rezulton se këta operatorë ekonomikë për licencën me kodin II.I.A referuar përshkrimin të veprimtarisë specifike që paraqitet nga këto licenca rezultojnë, se ata janë të licencuar për veprimtari të ndryshme nga ajo e kërkuar nga autoriteti kontraktor. Në këtë kuptim KPP gjykon, se operatorët ekonomikë “Nelsa” SHPK, “4 S” SHPK dhe “MC Catering” SHPK janë në kushtet e mospërmbushjes së kërkesave në kriterin e veçante të*

kualifikimit të përcaktuar në dokumentet e procedurës së prokurimit objekt-ankimi, sa i takon Licencës së kategorisë II.1.A. të lëshuar nga Qendra Kombëtare e Biznesit, pasi nga verifikimi i tyre rezulton, se në Licencat II.1.A. me të cilat janë të pajisur këta operatorë ekonomikë, veprimtarinë specifike të përshkruar në licencë e kanë sipas rastit; të paspecifikuar konkretisht siç është Prodhim, përpunim e shpërndarje me shumicë e ushqimeve për njerëz; të specifikuar për ambalazhimin e frutave dhe perimeve apo Furrë buke dhe prodhime pasticerie, ndërkohë që objekti i prokurimit është mish dhe nënprodukte të tij. KPP gjykon, se autoriteti kontraktor në rastin konkret, vlerësimin e dokumentacionit të ofertuesve dhe përzgjedhjen e tyre nuk e ka bërë në përputhje me vetë kërkesat e përcaktuara në dokumentet standarde të tenderit, duke kualifikuar në këtë mënyrë operatorë ekonomikë të cilët nuk disponojnë dokumentacionin e duhur tekniko-ligjor. Gjykojmë, se është barrë e operatorëve ekonomikë pjesëmarrës në procedurën e prokurimit objekt-shqyrtimi, të vërtetojnë se disponojnë kapacitetet tekniko-ligjore në lidhje me licencat e kërkuara. Gjithashtu, bazuar edhe në nenin 82 pika 1 të ligjit 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative i RSH”, barra e provës për të vërtetuar plotësimin e kriterit të përcaktuar nga autoriteti kontraktor, bie mbi operatorin ekonomik, i cili në rastin konkret ka dështuar ta vërtetojë atë. Nuk mund të lejohet kualifikimi i një operatori ekonomik në rast se ai ka mungesë dokumentacioni dhe nuk plotëson kriteret e përcaktuara nga autoriteti kontraktor. Sqarojmë, se kriteri për licencat, duhet parë dhe vlerësuar në tërësinë e tij, me të gjitha elementet e përcaktuara nga ligjvënësi, si dhe të kërkuara dhe përcaktuara nga autoriteti kontraktor në dokumentet e tenderit, pasi, referuar mangësive të konstatuara në dokumentacion nuk arrihet të vërtetohet disponimi i licencës së kategorisë II.1.A, parë kjo në këndvështrimin e vlerësimit të të gjitha të dhënave, që përmban licenca. Ndërkohë KPP gjykon, se fakti që subjektet kanë dorëzuar licenca të kategorisë II.1.A, jo domosdoshmërisht do të thotë që është përmbushur kriteri, pasi veprimtaria specifike është përcaktuar dhe në nenin 23, “Përmbajtja e titullit të licencës/autorizimit/lejes” të ligjit nr. 10081 datë 23.02.2009 “Për Licencat, Autorizimet dhe Lejet në Republikën e Shqipërisë”, ku parashikohet shprehimisht se: “1. *Licenca/autorizimit/leja lëshohet në bazë të formularëve të miratuar, që përbëjnë titullin e saj.* 2. *Titulli përmban, të paktën, këto të dhëna ndër të tjera ç) llojin e veprimtarisë, veprimin apo të së mirës publike dhe të përdorimit të saj.*” Nga sa më sipër KPP gjykon, se licensimi i subjekteve kryhet për një veprimtari të caktuar të prodhimit, përpunimit, paketimit dhe shpërndarjes së ushqimeve. Në këtë kuptim pretendimi i operatorit ekonomik ankimues për operatorët ekonomikë “Nelsa” SHPK, “4 S” SHPK dhe “MC Catering” SHPK qëndron, pasi këto të fundit nuk arrijnë të provojnë se disponojnë licenca II.1.A me fushë veprimtarie specifike prodhim, përpunim, ambalazhim, etiketim e shpërndarje të ushqimeve për njerëz, (mish dhe produkte me bazë mishi), informacion për të cilin edhe organi kompetent AKU ka sqaruar KPP përmes shkresës me nr. 1139/1 prot., datë 01.03.2024, protokolluar me tonën me nr.113/10 prot., datë 04.03.2024. KPP sjell gjithashtu në vëmendje, se qëndrueshmëria në vendimmarrje është një nga detyrimet mbi bazën e të cilit mbështetet dhe veprimtaria e vetë Komisionit dhe bazuar mbi këtë fakt të njëjtin qëndrim KPP ka mbajtur edhe në vendimin nr.411/2022, datë 29.04.2022.

III.1.14. Gjithashtu, kuadri ligjor, parashikon një sërë elementësh, si garanci për operatorët ekonomikë të cilët kanë paqartësi në lidhje me interpretimin e kërkesave të autoritetit kontraktor dhe/ose mënyrës së plotësimit të kriterëve kualifikuese. Në rast se operatorët ekonomikë ekonomikë kanë paqartësi në lidhje mbi plotësimin e kërkesës së mësipërme,

kanë pasur në dispozicion momentin procedural të paraqitjes së kërkesës për sqarime pranë autoritetit kontraktor, deri në pesë ditë para dorëzimit të ofertave parashikuar nga neni 75 i LPP-së. Në nenin 75, pika 1 të ligjit Nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, parashikohet se “[...] Ofertuesi i mundshëm mund të kërkojë sqarime për dokumentet e tenderit nga autoriteti ose enti kontraktor, i cili duhet t’i përgjigjet çdo kërkesë për sqarim të dokumenteve të tenderit, të bërë nga çdo operator ekonomik, me kusht që kërkesa të jetë marrë jo më vonë se 6 ditë para afatit përfundimtar të dorëzimit të ofertave. Autoriteti kontraktor ose enti duhet të përgjigjet brenda 3 ditëve nga depozitimi i kërkesës, në mënyrë që të bëjë të mundur dorëzimin e ofertës në kohë nga operatori ekonomik dhe pa identifikuar burimin e kërkesës, duhet t’ua komunikojë sqarimin përkatës të gjithë operatorëve ekonomikë, që kanë tërhequr dokumentet e tenderit.

Në çdo rast, sqarimi i dokumenteve të tenderit nuk do të konsiderohet shtim, pakësim ose ndryshim i kërkesave të përcaktuara nga autoriteti ose enti kontraktor në dokumentet e tenderit [...]”. Komisioni gjykon, se është detyrë e operatorëve ekonomikë të përgatisin ofertat e tyre në përputhje me kriteret dhe kushtet e vendosura nga autoriteti kontraktor në dokumentet e tenderit, për sa kohë që i kanë pranuar ato dhe nuk i kanë bërë në asnjë rast objekt-ankimimi.

Për sa më lart, pretendimi i operatorit ekonomik ankimues Argent Daci PF qëndron.

III.2. Lidhur me pretendimet e operatorit ekonomik “Nelsa” SHPK mbi skualifikimin e operatorit ekonomik “4 S” SHPK me arsyetimin se “ *Formulari përmbledhës i vetëdeklarimit nuk është plotësuar në mënyrë të rregullt nga operatori ekonomik “4 S” SHPK pasi nuk është përcaktuar në mënyrë të qartë me emër/mbiemër dhe pozicioni i secilit prej pjestarëve të stafit që do të angazhohet për realizimin e kontratës në procedurën e prokurimit objekt ankimi dhe/ose nuk janë përcaktuar të dhënat e mjetit që do të angazhohet në realizimin e kontratës. Gjykojmë se të dhënat e mësipërme janë të dhëna të nevojshme të cilat operatorët ekonomikë pjesëmarrës duhet t’i specifikojnë në momentin e ofertimit dhe t’i vërtetojnë përpara shpalljes së njoftimit të fituesit, të dhëna të cilat kemi dyshime të arsyeshme se operatori ekonomik “4 S” SHPK nuk i ka deklaruar në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit të dorëzuar në SPE”, Komisioni i Prokurimit Publik vëren se:*

III.2.1. Në shtojcën 7 “Kriteret e veçanta të kualifikimit”, “Kapaciteti Teknik”, pika 2.3.3, 2.3.4, 2.3.5 dhe 2.3.7 të dokumenteve të procedurës së prokurimit objekt-ankimi përcaktohen kriteret si më poshtë:

2.3.3 Numri mesatar i punonjësve të siguruar duhet të jetë jo më pak se 5 (pesë) punonjës për periudhën Shtator 2023– Nëntor 2023. Për të vërtetuar këtë operatori ekonomik duhet të paraqesë:

Vërtetim nga Sigurimet Shoqërore/ose Administrata Tatimore për periudhën Shtator 2023– Nëntor 2023

Listëpagesat sipas formës që kërkohet nga legjislacioni në fuqi për periudhën Shtator 2023– Nëntor 2023

Ky kriter do të përmbushet nga OE me anë të Formularit Përmbledhës së Vetëdeklarimit sipas Shtojcës 8. Operatori ekonomik i kualifikuar i pari në klasifikim duhet të dorëzojë pranë AK, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve ankimit, të gjithë

2.3.4. Operatori ekonomik duhet të dëshmojë se ka të punësuar ose ka të kontraktuar si ekspert të jashtëm 1 (një) punonjës të diplomuar si zooteknik ose veteriner

Për punonjësit sa më sipër, ofertuesi duhet të paraqesë :

- Kontratën individuale të punës;
- Diplomen

Kriteri sipas pikës 2.3.5 do të përmbushet nga OE me anë të Formularit Përmbledhës së Vetëdeklarimit sipas shtojces 8. Operatori ekonomik i kualifikuar i pari në klasifikim duhet të dorëzojë pranë AK, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve ankimit, të gjithë dokumentacionin provues për vetëdeklarimet në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit.

2.3.5 Operatori ekonomik ofertues duhet të ketë të punësuar minimalisht 2 (dy) punonjës shoferë. Për këto punonjës duhet të paraqitet kontrata e punës e vlefshme, dëshmitë e drejtimit (të vlefshme).

Kriteri sipas pikës 2.3.5 do të përmbushet nga OE me anë të Formularit Përmbledhës së Vetëdeklarimit sipas shtojces 8. Operatori ekonomik i kualifikuar i pari në klasifikim duhet të dorëzojë pranë AK, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve ankimit, të gjithë dokumentacionin provues për vetëdeklarimet në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit.

2.3.6 Operatori Ekonomik Ofertues, duhet të ketë në pronësi ose në përdorim ose me kontratë qiraje një ambient të përshtatshëm, për magazinimin e mallrave që janë objekt i këtij prokurimi, e vlefshme kjo për të gjithë periudhën e zbatimit të kontratës.

Për të vërtetuar dhe plotësuar këtë kriter, operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë:

- Aktin e pronësisë ose kontratën e huapërdorjes/qirasë së objektit, shoqëruar me dokumentacionin përkatës të pronësisë së objektit që ka personi në pronësi, i cili e jep me qira. Në çdo rast, kontratat e huapërdorjes dhe ajo e qirasë duhet të jenë noteriale..
- Lejen higjensan të objektit, e cila duhet të jetë e vlefshme, e lëshuar nga organet kompetente të Ministrisë së Shëndetësisë, në rrethet dhe vëndet përkatëse, nga inspektoriati që mbulon fushën e shëndetit.

III.2.2. Në shtojcën 8 të dokumenteve standarde të tenderit autoriteti kontraktor ka parashikuar:

### **Shtojca 8**

(Shtojcë për tu paraqitur nga operatori ekonomik)

## **FORMULARI PËRMBLEDHËS I VETËDEKLARIMIT**

Unë i nënshkruari \_\_\_\_\_ në cilësinë e \_\_\_\_\_ të operatorit ekonomik \_\_\_\_\_ deklaroj nën përgjegjësinë time të plotë që:

### **A. Pjesa I: Informacion në lidhje me Operatorin Ekonomik**

Identifikimi	Përgjigja
Emri i operatorit ekonomik: (Ju lutemi renditni të gjithë operatorët ekonomikë nëse jeni një BOE. Ju lutemi tregoni rolin e operatorit ekonomik në BOE)	-----
Numri NIPT/et:	-----
Adresa postare: Qyteti / qyteti; Kodi postar	-----
Përfaqësuesi (emri):	-----
Telefoni:	-----
E-mail:	----- ----

## B: DEKLARATË

Për nënkontraktorët dhe subjektet në kapacitetet, e të cilave do të mbështetet Operatori Ekonomik (nëse është e zbatueshme)

Në cilësinë e operatorit ekonomik, deklaroj nën përgjegjësinë time të plotë se:

- Informacione për nënkontraktorin

Emri i nënkontraktorit të propozuar	NIPT –i	Përqindja e nënkontraktimit	Mallrat/ shërbimet e lidhura me to për t'u nënkontraktuar

acion mbi subjektet mbi kapacitetin, e të cilëve do të mbështetet operatori ekonomik

Emri (at) e subjekteve	NIPT-i	Lloji i kapacitetit për të cilin do të mbështetet operatori ekonomik	Specifiko konkretisht kapacitetin/et

• I  
n  
f  
o  
r  
m


## Pjesa II: Shkaqet e përjashtimit

### A: DEKLARATA PËR PËRMBUSHJEN E KRITEREVE TË PËRGJITHSHME TË KUALIFIKIMIT

<b>Deklarata</b>
<p>Operatori ekonomik është i regjistruar në regjistrin tregtar sipas legjislacionit të vendit ku ushtron aktivitetin, ose sipas legjislacionit të posaçëm në rastin e një organizate jofitimprurëse, ka në fushën e veprimtarisë objektin e prokurimit, dhe ka statusin aktiv.</p> <p><i>Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme</i> _____</p>
<p>Operatori ekonomik nuk është dënuar për ndonjë nga veprat penale të parashikuara në nenin 76/1 të LPP-së ose ka qenë i dënuar dhe ka kaluar një periudhë 5-vjeçare nga data e ekzekutimit të dënimit, nëse nuk është përcaktuar një periudhë tjetër nga gjykata, sipas parashikimeve të nenit 76 të LPP-së.</p> <p><i>Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme</i> _____</p>
<p>Personi / personat në cilësinë e anëtarit të organit administrativ, drejtorit ose mbikëqyrësit, si aksionar ose si ortak, ka ose kompetenca përfaqësuese, vendimmarrëse ose kontrolluese brenda operatorit ekonomik, si më poshtë:</p> <hr/> <p>etj.</p> <p>nuk janë të dënuar me vendim gjyqësor të formës së prerë për ndonjë nga veprat penale të përcaktuara në nenin 76/1 të LPP-së ose kanë qenë të dënuar dhe ka kaluar një periudhë 5-vjeçare nga data e ekzekutimit të dënimit, nëse nuk është përcaktuar një periudhë tjetër nga gjykata, sipas parashikimeve të nenit 76 të LPP-së, etj.</p> <p><i>Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme</i> _____</p>
<p>Operatori ekonomik nuk është dënuar me vendim gjyqësor të formës së prerë për vepra që lidhen me veprimtarinë profesionale.</p> <p><i>Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme</i> _____</p>
<p>Operatori ekonomik nuk është në proces falimentimi (statusi aktiv).</p> <p><i>Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme</i> _____</p>
<p>Operatori Ekonomik ka paguar të gjitha detyrimet për taksat dhe kontributet e sigurimeve shoqërore, sipas legjislacionit në fuqi, ose ndodhet në një nga rastet e parashikuara në nenin 76/2 të LPP-së.</p> <p><i>Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme</i> _____</p>



Operatori ekonomik ka paguar të gjitha detyrimet e energjisë elektrike, për të gjitha adresat e ushtrimit të aktivitetit, sipas legjislacionit përkatës në fuqi.

Ky informacion kërkohet për operatorët ekonomikë, të cilët operojnë në territorin e Republikës së Shqipërisë.

*Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme* \_\_\_\_\_

Operatori ekonomik ushtron aktivitetin e tij në zbatimin e kërkesave ligjore në fuqi.

*Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme* \_\_\_\_\_

Operatori ekonomik nuk është në listën e operatorëve ekonomikë të ndaluar për të fituar kontrata publike në përputhje me nenin 78 të LPP-së.

Operatori ekonomik nuk ka në cilësinë e anëtarit të organit të administrimit, drejtues ose mbikëqyrës i atij, aksionar ose ortak, ose me kompetenca përfaqësuese, vendimmarrjeje ose kontrolluese brenda tij persona të cilët janë /kanë qenë në këtë cilësi në një operator ekonomik të përjashtuar nga e drejta për të përfituar fonde publike, me vendim të Agjencisë së Prokurimit Publik, gjatë kohës që ky vendim është në fuqi.

*Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme* \_\_\_\_\_

## **B: DEKLARATA**

### **Për Dorëzimin e Ofertave të Pavarura**

Ne cilësinë e përfaqësuesit të operatorit ekonomik, në mbështetje të Ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, si dhe në mbështetje të Ligjit Nr.9121/2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”, bëj këtë deklaram dhe garantoj se deklaratat e mëposhtme janë të vërteta dhe të plota në çdo aspekt:

1. Unë kam lexuar dhe kuptuar përmbajtjen e kësaj Deklarate;
2. Unë kuptoj që oferta e paraqitur do të s’kualifikohet dhe/ose përjashtohet nga fitimi i kontratave publike, nëse kjo Deklaratë vërtetohet se nuk është e plotë dhe / ose e saktë në çdo aspekt;
3. Unë jam i autorizuar nga Ofertuesi të firmos këtë Deklaratë dhe të paraqes ofertë në interes të Ofertuesit;
4. Çdo person, firma e të cilit shfaqet në dokumentacionin e ofertës, është i autorizuar nga Ofertuesi për të përgatitur dhe për të nënshkruar ofertën në interes të Ofertuesit;
5. Për qëllim të kësaj deklarate dhe ofertës së paraqitur, unë kuptoj që fjala “konkurrentë” nënkupton çdo operator tjetër ekonomik, të ndryshëm nga Ofertuesi, të paraqitur ose jo si bashkim operatorësh ekonomik, që:

- a) paraqesin një ofertë në përgjigje të Njoftimit të Kontratës dhe/ose të Ftesës për Ofertë, të bërë nga Autoriteti Kontraktor;
- b) është një ofertues i mundshëm, i cili bazuar në kualifikimin, aftësitë ose përvojat e tij, mundet të dorëzojë një ofertë në përgjigje, të Njoftimit të Kontratës dhe/ose të Ftesës për Ofertë.
6. Ofertuesi deklaron se: (kliko një nga alternativat e mëposhtme):
- a) Ofertuesi ka përgatitur ofertën e tij në mënyrë të pavarur, pa u konsultuar, pa komunikuar dhe pa bërë marrëveshje apo pa rënë dakord me asnjë konkurrent tjetër;
- 
- b) Ofertuesi është konsultuar, ka komunikuar, ka bërë marrëveshje me një ose më shumë konkurrentë në lidhje me këtë procedurë prokurimi. Ofertuesi deklaron se në dokumentet bashkangjitur, në detajet e kësaj oferte, janë përfshirë emrat e konkurrentëve, natyra dhe shkaqet e konsultimit, komunikimit, marrëveshjes apo angazhimit (rasti i bashkimit të operatorëve ekonomikë ose nënkontraktimit).
7. Në veçanti, pa kufizuar paragrafët 6. a) dhe 6. b), të përmendur më lart, nuk ka pasur konsultime, komunikime, kontratë apo marrëveshje me ndonjë konkurrent në lidhje me:
- a) çmimet ;
- b) metodat, faktorët ose formulat e përdorura për llogaritjen e çmimit;
- c) qëllimin apo vendimin për të paraqitur apo jo një ofertë; ose,
- d) paraqitjen e një oferte që nuk i plotëson specifikimet e kërkesës për ofertë.
8. Përveç kësaj, nuk ka pasur konsultime, komunikime, marrëveshje apo kontrata me ndonjë konkurrent në lidhje me cilësinë, sasinë, specifikimet apo dërgesa të veçanta të produkteve apo shërbimeve të cilat lidhen me prokurimin në fjalë, përveç se kur janë deklaruar sipas paragrafit të mësipërm 6. b).
9. Kushtet e ofertës nuk u janë bërë të njohura dhe as nuk do t'u bëhen të njohura me qëllim nga Ofertuesi konkurrentëve të tjerë, në çdo mënyrë qoftë, para datës dhe kohës së hapjes zyrtare të ofertave, shpalljes fitues dhe lidhjes së kontratës, vetëm nëse kërkohet me ligj ose nëse deklarohen në mënyrë specifike sipas paragrafit 6.b).

## **C: DEKLARATA**

### **Mbi Konfliktin e Interesit**

## Deklarata

Në cilësinë e operatorit ekonomik, ne deklarojmë se jemi të vetëdijshëm për sa vijon:

Konflikti i interesit është një situatë e konfliktit midis detyrës publike dhe interesit privat të një zyrtari, në të cilën ai / ajo ka interesa private direkte ose indirekte që ndikojnë, ose që mund të ndikojë ose që duket se ndikojnë në kryerjen e padrejtë të detyrave dhe detyrimeve publike.

Në përputhje me nenin 21, paragrafi 1, Ligji Nr. 9367, datë 07.04.2005, kategoritë e zyrtarëve siç parashikohen në Kapitullin III, Seksioni II, që janë absolutisht të ndaluara të përfitojnë drejtpërdrejt ose indirekt nga nënshkrimi i kontratave midis një pale dhe institucionit publik janë:

- Presidenti i Republikës, Kryeministri, Zëvendës Kryeministri, Ministrat, ose Zëvendësministrat, Deputetët, Gjyqtarët e Gjykatës Kushtetuese, Gjyqtarët e Gjykatës së Lartë, Kreu i Kontrollit të Lartë të Shtetit, Prokurori i Përgjithshëm, Gjyqtarët dhe Prokurorët në nivelin e Gjykatës së Shkallës së Parë dhe Gjykatës së Apelit, Avokati i Popullit, Anëtarët e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, Anëtarët e Këshillit të Lartë të Drejtësisë, Inspektori i Përgjithshëm i Inspektoratit të Lartë të Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesit, Anëtarët e Enteve Rregullatore (Këshilli Mbikëqyrës i Bankës së Shqipërisë, përfshirë Guvernatorin dhe Zëvendësguvernatorin; konkurrenca; telekomunikacioni; energjia elektrike; furnizimi me ujë; sigurimi; bonot; autoritetet e medias), sekretarët e përgjithshëm të institucioneve qendrore si dhe çdo zyrtar publik në çdo institucion publik pozicioni i të cilit është i barabartë me atë të Drejtorit i Përgjithshëm, drejtuesit e organeve të administratës publike që nuk janë pjesë e shërbimit civil.

Për nëpunësit civilë të nivelit të mesëm, sipas nenit 31 dhe zyrtarët sipas nenit 32 të kreut III, seksionit 2 të këtij ligji, ndalimi në paragrafin 1 të këtij neni, për shkak të interesave private të zyrtarit, siç përcaktohet këtu të zbatohet vetëm në rast të lidhjes së kontratave brenda fushës dhe territorit të institucionit dhe juridiksionit të institucionit, ku punon zyrtari. Ky ndalim do të zbatohet edhe kur pala në kontratë është një institucion varësie.

Kur zyrtari është kryetar bashkie ose nënkryetar i një bashkie ose komune, ose kryetar i një këshilli rajonal, anëtar i këshillit përkatës, ose një zyrtar i lartë i menaxhimit të një njësie të qeverisjes vendore, ndalimi për shkak të interesave private të zyrtarit, specifikuar këtu, do të zbatohet vetëm në rastin e lidhjes së kontratave, nëse ka, me bashkinë, komunën ose rajonin ku zyrtari ushtron një detyrë të tillë. Ky ndalim do të zbatohet gjithashtu kur pala në kontratë është një institucion publik në varësi të kësaj njësie (neni 21, paragrafi 2, Ligji Nr. 9367, datë 07.04.2005).

Ndalimet e parashikuara në nenin 21, paragrafët 1, 2 të Ligjit Nr. 9367, datë 07.04.2005, me përjashtimet përkatëse, do të zbatohen në të njëjtën masë edhe për personat e lidhur me zyrtarin, d.m.th. **bashkëshortin, bashkëjetuesin, fëmijët madhorë e prindërit e zyrtarit dhe të bashkëshortit dhe bashkëjetuesit.**

Unë jam në dijeni të kërkesave dhe ndalimeve të parashikuara në Ligjin Nr. 9367, datë 07.04.2005 "Për Parandalimin e Konfliktit të Interesit në Ushtrimin e Funksioneve Publike", të ndryshuar, dhe aktet nënligjore të miratuara në bazë të tij nga Inspektorati i Lartë i Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive, si dhe Ligji Nr. 162/2020, datë 23.12.2020 "Për Prokurimin Publik".

Në përputhje me to, unë deklaroj këtu se asnjë zyrtar publik, siç përcaktohet në Kapitullin III, Seksioni II të Ligjit Nr. 9367, datë 07.04.2005, dhe në këtë deklaratë, nuk ka ndonjë interes privat, direkt ose indirekt,

me personin juridik që unë përfaqësoj këtu.

## D: DEKLARATA

### Për zbatimin e dispozitave ligjore në marrëdhëniet e punës

#### Deklarata

Në cilësinë e operatorit ekonomik, deklaroj nën përgjegjësinë time të plotë se:

- Operatori ekonomik \_\_\_\_\_garanton mbrojtjen e të drejtës së punësimit dhe profesionit nga çdo formë diskriminimi, të parashikuar nga legjislacioni i punës në fuqi.
- Operatori ekonomik\_\_\_\_\_lidh me punëmarrësit kontratat përkatëse të punës dhe garanton masat në drejtim të sigurisë dhe shëndetit në punë për të Gjithë dhe, në mënyrë të veçantë, për grupet e rrezikuara, bazuar në legjislacionin e punës në fuqi.
- Operatori ekonomik \_\_\_\_\_nuk ka masë Ligjore në fuqi, të vendosur nga Inspektoriati Shtetëror i Punës dhe Shërbimeve Shoqërore (ISHPSHSH). Në rastet kur janë konstatuar shkelje ligjore, operatori ekonomik ka marrë masat e nevojshme për adresimin e tyre, brenda afateve të përcaktuara nga ISHPSHSH.

*Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme*

## Pjesa III Kriteret e Përzgjedhjes/Kualifikimit

### A: DEKLARATË

Në përputhje me specifikimet teknike dhe grafikun e realizimit të objektit të kontratës:

Deklarata	Përgjigje
Në cilësinë e operatorit ekonomik, ne deklarojmë se plotësojnë të gjitha specifikimet teknike, siç udhëzohet në dokumentet e tenderit, dhe këtë e provojmë përmes certifikatave dhe dokumenteve të paraqitura me këtë deklaratë (nëse kërkohet nga Autoriteti Kontraktor), dhe marrim përsipër të realizojmë objektin në përputhje me Listën e mallrave dhe grafikun e lëvrimit të përcaktuar nga Autoriteti kontraktor.	Po [ ] Jo [ ]

## B: DEKLARATË

### Për disponimin e punonjësve dhe makinerive të nevojshme (nëse kërkohen)

Deklarata	Përgjigje
<p>Në cilësinë e operatorit ekonomik, deklaroj nën përgjegjësinë time të plotë se:</p> <p>Unë kam punonjësit e nevojshëm si dhe mjetet dhe makineritë për ekzekutimin e kontratës, siç përcaktohet në dokumentet e tenderit, dhe e vërtetoj këtë me dokumentacionin përkatës, të cilin do ta paraqes në kopje origjinale ose të noterizuar nëse fitoj, ose nëse më kërkohen sqarime nga autoriteti kontraktor.</p>	<p><u>Punonjës</u></p> <p>Po [ ] Jo [ ]</p> <p>Nëse, po, numri i punonjësve:</p> <hr/> <p>Profili i punonjësve</p> <hr/> <p><u>Makineri e mjete</u></p> <p>Po [ ] Jo [ ]</p> <p>Nëse po, të listohen me të dhënat konkrete:</p> <hr/>
<p><b>Emri, Mbiemri</b> _____</p> <p><b>Firma</b> _____</p> <p><b>Vula</b> _____</p> <p><b>Data e dorëzimit të deklaratës</b> _____</p>	

### Ju lutemi sigurohuni që:

- Secili pjesëmarrës i renditur në një bashkim operatorësh ekonomikë të paraqesë një Formular të veçantë të Vetëdeklarimit.
- Në rast se, operatori ekonomik ofertues do të mbështetet në kapacitetet e subjekteve të tjera, një Formular i veçantë i Vetëdeklarimit duhet të paraqitet edhe nga subjekti mbështetës.

- Çdo vetdeklarim i pavërtetë/pasaktë nga ana e operatorëve ekonomikë jo vetëm që përbën shkak për skualifikimin nga procedura konkrete, por përbën shkak edhe për përjashtimin e tyre nga e drejta për të fituar kontrata publike deri në 3 vjet, sipas parashikimeve të ligjit për prokurimin publik.
- Operatorët ekonomikë që ofertojnë në procedurat e prokurimit të vetdeklarojnë në çdo rast informacionin e saktë që i korrespondon gjendjes së tyre faktike.

Në çdo rast, autoriteti kontraktor ka të drejtë të kryejë verifikimet e nevojshme për vërtetësinë e informacionit të deklaruar nga operatori ekonomik për sa më sipër.

- Në çdo rast, përpara publikimit të njoftimit të fituesit paraprak dhe nisjes së afateve të ankimit, autoriteti kontraktor duhet t'i kërkojë ofertuesit fitues që të dorëzojë dokumentet provuese për vetëdeklarimet në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, si dhe dokumentet e paraqitura si pjesë e ofertës në rrugë elektronike. Këto dokumente duhet të paraqiten në origjinal ose në kopje të njësuara me origjinalin.
- Informacioni i pasqyruar në formularin e vetëdeklarimit, i cili gjendet në një bazë të dhënash, ku autoriteti kontraktor mund të aksesojë direkt këtë informacion dhe /ose dokumentin, duhet të shoqërohet me adresën përkatëse për këtë bazë të dhënash.

III.2.3. Në përmbushje të kriterëve më sipër operatori ekonomik “4 S” SHPK ka paraqitur në sistemin e prokurimit elektronik dokumentacionin si më poshtë:

- Formularin përmbledhës të vetëdeklarimit të operatorit ekonomik “4 S” SHPK
- Listëpagesa e Kontributeve të Sigurimeve Shoqërore, Shëndetësore dhe Tatimit mbi të ardhurat nga Punësimi” për periudhën shtator 2023-nëntor 2023.
- Vërtetim nga administarta tatimore me Nr. T09663803, datë 30.12.2023 ku për periudhën shtator, tetor dhe nëntor 2023 rezultojnë respektivisht: 21, 22, dhe 24 punonjës.
- Kontratë individuale punës e datës 01.01.2024 lidhur me veterinerin z. Jurgen Puka
- Diplomë e z. Jurgen Puka lëshuar nga Universiteti Bujqësor i Tiranës me nr. 70524 datë 15.302.2013 me titull master në “Mjekesi Veterinare” me afat 5 vjecar.
- Kontratë individuale pune e datës 01.07.2023 lidhur me shoferin Amarildo Rrumbullaku me afat 5 vjecar.
- Leje drejtimi e shoferit Amarildo Rrumbullaku
- Kontratë individuale pune e datës 01.07.2023 lidhur me shoferin Leonard Sina me afat 5 vjecar.
- Leje drejtimi e shoferit Amarildo Rrumbullaku
- Certifikate e pronësisë së mjetit me targë AB 492EU
- Leje qarkullimi e mejtit me targë AB 492EU
- Certifikate e kontrollit teknik te mjetit me targë AB 492EU e vlefshme deri me date 23.10.2025
- Likujdim i taksës vjetore për mjetin me targë AB 492EU
- Police sigurimi për mjetin me targë AB 492EU e vlefshme deri me datë 16.10.2024

III.2.4. Në nenin 77 të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, parashikohet shprehimisht se:

*“1. Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë kërkesat për kualifikim për operatorët ekonomikë bazuar në:*

- a) përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale;*
- b) gjendjen ekonomike dhe financiare;*
- c) aftësinë teknike dhe profesionale.*

*Kërkesat kufizohen vetëm në ato që janë të përshtatshme për të garantuar që një kandidat ose ofertues të ketë kapacitetet juridike, financiare dhe aftësitë teknike e profesionale për të zbatuar kontratën që do të jepet. Të gjitha kërkesat duhet të kenë lidhje dhe të jenë proporcionale me objektin e kontratës.*

*2. Për sa i përket përshtatshmërisë për të kryer një veprimtari profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të regjistrohen në një nga regjistrat profesionale ose tregtarë.*

*Në procedurat e prokurimit për shërbime, ku është e nevojshme që operatorët ekonomikë të kenë një autorizim të veçantë ose të jenë anëtarë të një organizate të veçantë për të kryer shërbimin në fjalë në shtetin e tyre të origjinës, autoriteti ose enti kontraktor mund t'u kërkojë atyre të vërtetojnë se e kanë këtë autorizim ose anëtarësim.*

*3. Në lidhje me situatën ekonomike dhe financiare, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë kanë kapacitetin e nevojshëm ekonomik dhe financiar për të zbatuar kontratën.*

*Për këtë qëllim autoritetet ose entet kontraktore mund të kërkojnë në veçanti që operatorët ekonomikë të kenë një xhiro vjetore minimale të caktuar. Gjithashtu, autoritetet ose entet kontraktore mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të japin informacione në bilancet e tyre vjetore që të tregojnë raportet ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit.*

*Xhiron vjetore minimale që kërkohet nga operatorët ekonomikë nuk mund të tejkalojë dyfishin e vlerës së parashikuar të kontratës.*

*Kur një kontratë ndahet në lote, ky nen zbatohet për çdo lot individual. Megjithatë, autoriteti ose enti kontraktor mund të përcaktojë xhiron vjetore minimale që u kërkohet operatorëve, duke iu referuar grupeve të loteve, në rast se ofertuesi i suksesshëm merr disa lote që duhet të zbatohen në të njëjtën kohë.*

*Në rastin e kontratave që bazohen në një marrëveshje kuadër, kërkesa për xhiron minimale llogaritet mbi bazën e përmasave maksimale të kontratave specifike që do të zbatohen në të njëjtën kohë ose, kur përmasat nuk dihen, mbi bazën e vlerës së parashikuar të marrëveshjes kuadër.*

*4. Në lidhje me aftësitë teknike dhe profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë zotërojnë burimet e nevojshme njerëzore e teknike, si dhe përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën sipas një standardi të përshtatshëm cilësie.*

*Autoritetet ose entet kontraktore, në veçanti, mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të kenë një nivel të mjaftueshëm përvojë që vërtetohet nga referenca të përshtatshme nga kontratat e zbatuara në të shkuarën.*

*Aftësia profesionale e operatorëve ekonomikë për të ofruar shërbimin, punën, mallin vlerësohet në lidhje me aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm për të zbatuar kontratën, siç është përshkruar nga autoriteti ose enti kontraktor në njoftimin e objektit të kontratës.*

5. Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë në njoftimin e kontratës ose në ftesën për shprehje interesi kriteret e përzgjedhjes, si dhe dokumentet konkrete që duhet të paraqesin operatorët ekonomikë për përmbushjen e këtyre kriterëve.”

Në nenin 82 “Formulari përmbledhës i vetëdeklarimit” pika 1 të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, parashikohet shprehimisht : “1. Bashkë me dorëzimin e kërkesave për pjesëmarrje ose të ofertave, autoritetet ose entet kontraktore pranojnë si provë paraprake në vend të disa vërtetimeve të lëshuara nga autoritetet publike ose palë të treta, formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas parashikimeve të këtij ligji. Përmbajtja e këtij formulari përcaktohet në rregullat e prokurimit publik.”

Ndërsa në nenin 92/3 të LPP-së përcaktohet se: “3. Autoriteti ose enti kontraktor, në zbatim të pikës 4 të këtij neni, vlerëson një ofertë të vlefshme vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentet e tenderit, pa rënë ndesh me përcaktimet e nenit 38 të këtij ligji...”

III.2.5. Në nenin 26 “Formulari përmbledhës i vetëdeklarimit” të Vendimit Nr. 285 datë 19.05.2021 të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, parashikohet se: “1. Bashkë me dorëzimin e kërkesave për pjesëmarrje ose të ofertave, autoriteti/enti kontraktor pranon si provë paraprake, në vend të disa vërtetimeve të lëshuara nga autoritetet publike ose palë të treta, formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas përcaktimit në nenin 82, të LPP-së, dhe në këto rregulla.

2. Formulari përmbledhës i vetëdeklarimit përmban informacion dhe deklarin, si më poshtë vijon:

a) operatori ekonomik është i regjistruar në regjistrin tregtar sipas legjislacionit të vendit ku ushtron aktivitetin ose sipas legjislacionit të posaçëm, në rastin e një organizate jofitimprurëse, ka në fushën e veprimtarisë objektin e prokurimit, dhe ka statusin aktiv;

b) operatori ekonomik nuk është dënuar për asnjë nga veprat penale, të parashikuara në pikën 1, të nenit 76, të LPP-së;

c) personi/at në cilësinë e anëtarit të organit administrativ, drejtuesit ose mbikëqyrësit, aksionerit ose ortakut, ose që ka kompetenca përfaqësuese, vendimmarrjeje ose kontrolluese brenda operatorit ekonomik, nuk është ose ka qenë i dënuar me vendim gjyqësor të formës së prerë për asnjë nga veprat penale, të përcaktuara në pikën 1, të nenit 76, të LPP-së;

ç) operatori ekonomik nuk është dënuar me vendim të gjykatës së formës së prerë, për vepra që lidhen me veprimtarinë profesionale;

d) operatori ekonomik nuk është në proces falimentimi;

dh) operatori ekonomik ka paguar të gjitha detyrimet për pagimin e taksave dhe tatimeve<sup>1</sup> të kontributeve të sigurimeve shoqërore, sipas parashikimeve të pikës 2, të nenit 76, të LPP-së;

e) operatori ekonomik ka shlyer të gjitha detyrimet e maturuara të energjisë elektrike, dhe përmbush kërkesat që rrjedhin nga legjislacioni i fushës në fuqi. Ky informacion kërkohet për operatorët ekonomikë, të cilët ushtrorjnë veprimtarinë në territorin e Republikës së Shqipërisë;

ë) operatori ekonomik nuk ndodhet në kushtet e konfliktit të interesit, sipas legjislacionit në fuqi;

f) operatori ekonomik ushtron aktivitetin në zbatim të kërkesave ligjore të legjislacionit mjedisor, social dhe të punës;

<sup>1</sup> Ndryshuar me Vendimin Nr. 710 datë 24.11.2021



g)operatori ekonomik ka paraqitur ofertë të pavarur, sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi;  
gj)operatori ekonomik përmbush specifikimet teknike, sipas kërkesave të përcaktuara nga autoriteti/enti kontraktor;

h)operatori ekonomik disponon fuqinë punëtore, të nevojshme për ekzekutimin e kontratës, sipas kërkesave të autoritetit/entit kontraktor (kur është rasti);

i)operatori ekonomik disponon mjetet dhe makineritë e nevojshme për ekzekutimin e kontratës, sipas kërkesave të autoritetit/entit kontraktor, kur është rasti;

j)informacion mbi subjektet, mbi kapacitetet e të cilave, operatori ekonomik do të mbështetet, nëse është rasti dhe nënkontraktorët e mundshëm, nëse është rasti;

k)operatori ekonomik ushtron aktivitetin konform kërkesave të legjislacionit në fuqi.

3. Informacioni i pasqyruar në formularin e vetëdeklarimit, i cili gjendet në një bazë të dhënash, ku autoriteti/enti kontraktor mund të aksesojë direkt këtë informacion dhe /ose dokumentin, duhet të shoqërohet me adresën përkatëse për këtë bazë të dhënash.

4. Për përmbushjen e detyrimit sipas këtij neni, operatorët ekonomikë mund të përdorin një formular vetëdeklarimi që është përdorur gjatë një procedure prokurimi të mëparshme, nëse informacioni që ajo përmban vazhdon të jetë i saktë dhe i vlefshëm.

5. Operatorëve ekonomikë nuk u kërkohet të dorëzojnë dokumente mbështetëse, kur autoriteti ose enti kontraktor që ka dhënë kontratën ose ka lidhur marrëveshjen kuadër, i ka këto dokumente.

6. Përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, autoriteti/enti kontraktor i kërkon ofertuesit të kualifikuar, i pari dorëzimin e dokumenteve provuese të parashikuara në shkronjat “a”, “b”, “d”, “dh”, “e”, “h”, “i”, “j” të pikës 2 të nenit 26 të V, si dhe dokumentet e tjera shoqëruese të ofertës, të dorëzuara në rrugë elektronike<sup>2</sup>. Këto dokumente duhet të paraqiten në origjinal ose në kopje të njësuara me origjinalin.

Autoriteti/enti kontraktor pranon një dokument të lëshuar nga i njëjti institucion ose palë e tretë dhe që ka të njëjtin informacion me atë të paraqitur në procedurën e zhvilluar në mënyrë elektronike.

Operatorët ekonomikë të huaj duhet të paraqesin dokumentet në formën e kërkuar nga legjislacioni në fuqi për njohjen e dokumentacionit të lëshuar në një shtet të huaj.

Për dokumentet që nuk lëshohen në vendin e origjinës, operatorët ekonomikë duhet të vetëdeklarojnë këtë fakt, përndryshe dokumentacioni do të konsiderohet i paparaqitur.

7.Në çdo rast, autoriteti/enti kontraktor ka të drejtë të kryejë verifikimet e nevojshme mbi vërtetësinë e informacionit të deklaruar nga operatori ekonomik si më sipër, ose t'i kërkojë operatorit sqarime dhe dokumente mbështetëse për këto sqarime.”

III.2.6. Referuar frymës së legjislacionit për prokurimin publik, vendosja e kriterëve të veçanta për kualifikim, ka si synim kryesor që t'i shërbejë autoritetit kontraktor për njohjen e gjendjes dhe kapaciteteve të operatorëve ekonomikë, të cilët, nëpërmjet dokumentacionit të paraqitur duhet të vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet ekonomike, financiare dhe organizative, makineritë, pajisjet e asete të tjera fizike, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, gjithçka në funksion të realizimit me sukses të kontratës. Në varësi të kontratës dhe volumit të saj autoriteti kontraktor përcakton kërkesat e veçanta për kualifikim, të cilat janë të detyrueshme për t'u përmbushur nga operatorët ekonomikë pjesëmarrës në procedurat e prokurimit.

<sup>2</sup> Ndryshuar me Vendimin Nr. 710 datë 24.11.2021

Operatorët Ekonomikë janë të detyruar të përgatisin ofertat, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në dokumentet e tenderit dhe ofertat që nuk përgatiten në përputhje me këto dokumente duhet të refuzohen si të papranueshme. Kriteret kualifikuese të përcaktuara nga autoriteti kontraktor, janë të detyrueshme për t'u përmbushur nga të gjithë ofertuesit ekonomikë pjesëmarrës në një procedurë prokurimi. Operatorët ekonomikë pjesëmarrës duhet të vërtetojnë se zotërojnë reputacionin, besueshmërinë, kapacitetet e konsideruara të nevojshme nga autoriteti kontraktor, për të zbatuar kontratën objekt-prokurimi. KPP sqaron, se në një procedurë prokurimi, subjekti i parë i interesuar është operatori ekonomik, i cili e përgatit ofertën e tij në përputhje me kuadrin ligjor në fuqi, dhe nga ana tjetër, është autoriteti kontraktor, i cili përzgjedh operatorin ekonomik që plotëson të gjitha kriteret e përcaktuara nga autoriteti kontraktor në dokumentet e tenderit, si dhe që ka përgatitur ofertën në përputhje me legjislacionin në fuqi.

III.2.7. Në rastin konkret, lidhur me këto pretendime të operatorit ekonomik “Nelsa” SHPK, KPP me qëllim kryerjen e një hetimi sa më të thelluar administrativ, si dhe kryerjen e veprimeve proceduriale të nevojshme në përmbushje të detyrimeve të tij ligjore, me vendimin e ndërmjetëm nr. 247/2024, datë 07.03.2024, i kërkoi operatorit ekonomik “4 S” SHPK që brenda datës 11.03.2024, të paraqesë në KPP dokumentacionin origjinal ose kopjen e noterizuar e tyre, në përmbushje të kërkesave të autoritetit kontraktor, të parashikuara në pikat 2.3.3, 2.3.4, 2.3.5 dhe 2.3.7 të kapacitetit teknik, të kriterëve të veçanta të kualifikimit të dokumentave të procedurës së prokurimit objekt - ankimi. Dokumentacioni më sipër nuk u paraqit në afatin e caktuar, prandaj KPP do të vijojë me shqyrtimin e pretendimeve më sipër të operatorit ekonomik “Nelsa” SHPK.

Nga verifikimi në SPE vihet re, se në përmbushje të kriterëve më sipër, operatori ekonomik “4 S” SHPK ka dorëzuar në SPE dokumentacionin e përmendur në pikën III.2.3 të këtij vendimi dhe ndër të tjera dhe formularin përmbledhës të vetëdeklarimit të operatorit ekonomik, të cilin në zbatim të parashikimeve ligjore në fuqi autoriteti/enti kontraktor e pranon si provë paraprake, në vend të disa vërtetimeve të lëshuara nga autoritetet publike ose palë të treta, dhe vetëm përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, autoriteti/enti kontraktor i kërkon ofertuesit të kualifikuar, i pari dorëzimin e dokumenteve provuese të parashikuara në shkronjat “a”, “b”, “d”, “dh”, “e”, “h”, “i”, “j” të pikës 2 të nenit 26, të Vendimit Nr. 285, datë 19.05.2021 të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, si dhe dokumentet e tjera shoqëruese të ofertës, të dorëzuara në rrugë elektronike, duke i rezervuar në këtë mënyrë të drejtën autoritetit kontraktor të kryejë verifikime në rast nevojë apo të dërgojë kërkesa për sqarim mbi dokumentacionin e paraqitur nga operatorët ekonomikë. Nga verifikimi i dokumentacionit të dorëzuar në SPE nga operatori ekonomik “4 S” SHPK rezulton, se në përmbushje të kriterëve më sipër, ka dorëzuar përveçse listëpagesat e sigurimeve shoqërore e shëndetësore për periudhën shtator-nëntor 2023, ku rezultojnë respektivisht: 21, 22, dhe 24 punonjës, vërtetim nga administrata tatimore dhe dokumentacionin e përmendur më sipër për automjetin me targë AB 492EU, por dhe formularin përmbledhës të vetëdeklarimit ku në Pjesën III; “Kriteret e përzgjedhjes/kualifikimit” seksioni “B: Deklaratë “Për disponimin e punonjësve dhe makinerive të nevojshme (nëse kërkohen)” operatori ekonomik “4 S” SHPK ka deklaruar burimet njerëzore në total prej 24 punonjësish dhe duke specifikuar: *Profili i punonjësve: Të ndryshëm - Drejtues ligjor, Ekonomist, Shofer, Punëtor, Teknolog, Veteriner,*

*Kuzhinier, Ndhmës kuzhinier, Kamarier etj. Ndërsa për automjetet, po në këtë seksion ka deklaruar: Automjete: AA 288 RV, AA 951 SA, AA 475 IR, AB 492 EU, AA 253 RC, AA 839 OB. Në këtë kuadër KPP gjykon, se operatori ekonomik ankimues ka dhënë indicie, se ka në dispozicion për kohën e realizimit të kontratës, punonjësit e duhur në numër 24 (ndërkohë që autoriteti kontraktor ka kërkuar jo më pak se 5 punonjës) duke përcaktuar edhe pozicionin dhe profilet e tyre si drejtues ligjor, Ekonomist, Shofer, Punëtor, Teknolog, Veteriner, Kuzhinier, Ndhmës kuzhinier, Kamarier. Akoma më tej, operatori ekonomik me listëpagesat e kontributeve të sigurimeve shoqërore, shëndetësore dhe tatimit mbi të ardhurat për periudhën shtator 2023 - nëntor 2023 të paraqitura në SPE, vërteton, se dy punonjësit me pozicionin shofer i disponon në mënyrë të plotë shteruese dhe ligjore përmes listëpagesave të paraqitura si më sipër dhe dhe kontratave të punës të lidhura me datë 01.07.2023 ndërsa punonjësin tjetër me pozicionin mjek veteriner përmes kontratës së punës të datës 01.01.2024, kontratë e cila është lidhur më vonë se deklarimi i kontributeve sipas periudhës më sipër. Gjithashtu, nga një korrespondencë e mëparshme midis Komisionit të Prokurimit Publik dhe Agjencisë së Prokurimit Publik, me shkresën nr. 319/1 prot., datë 19.01.2022 protokolluar me tonën nr. 2472/5 prot., 21.01.2022, Agjencia e Prokurimit Publik njofton Komisionin e Prokurimit Publik ndër të tjera se: [...] Kriteri për kualifikim mbi disponimin e punonjësve, duhet të përmbushet, nëpërmjet paraqitjes së Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit nga operatori ekonomik, sipas shtojcës 8 të DST. Qëllimi i paraqitjes së deklaratës “Mbi disponimin e punonjësve dhe makinerive të nevojshme” në këtë shtojcë, është garantimi i ekzekutimit të kontratës, sipas kërkesave të autoritetit/entit kontraktor, pra që operatori ekonomik ka stafin teknik sipas të dhënave të kërkuara. Referuar sa më sipër, plotësimi i kësaj deklaratë do të jetë në lidhje me numrin e punonjësve, nëse do të jetë kërkuar, dhe profilin e tyre, sipas kërkesave specifike të vendosura nga autoriteti kontraktor në dokumentet e tenderit të një procedure prokurimi [...] . Referuar shkresës më sipër të Agjencisë së Prokurimit Publik plotësimi i kësaj deklaratë do të jetë në lidhje me numrin e punonjësve, nëse do të jetë kërkuar, dhe profilin e tyre, sipas kërkesave specifike të vendosura nga autoriteti kontraktor në dokumentet e tenderit të një procedure prokurimi dhe jo domosdoshmërisht me të dhëna më të detajuara siç operatori ekonomik “Nelsa” SHPK pretendon. Operatori ekonomik “4 S” SHPK me deklaratimet e bëra në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit lidhur me numrin e punonjësve dhe profilet e tyre, i ka përmbushur kërkesat e autoritetit kontraktor në këtë fazë, pasi ka deklaruar numrin total të tyre ashtu dhe profilet në përputhje, kjo edhe me shpjegimet që jep APP përmes shkresës më sipër. Po ashtu edhe në lidhje me mjetet ka deklaruar, se disponon automjete me targa AA 288 RV, AA 951 SA, AA 475 IR, AB 492 EU, AA 253 RC, AA 839 OB duke dhënë indicie se plotëson kërkesat e autoritetit kontraktor lidhur me disponimin e mjeteve të cilat kthehen në element provuese në një moment tjetër procedural pas dorëzimit të dokumentacionit pranë autoriteti kontraktor, duke i rezervuar në këtë mënyrë të drejtën autoritetit kontraktor të kryejë verifikime në rast nevoje apo të dërgojë kërkesa për sqarim mbi dokumentacionin e paraqitur nga operatorët ekonomikë, lidhur me vërtetësinë dhe saktësinë e informacionit që përmbajnë dokumentet e paraqitura nga ata dhe më pas të marrë vendim lidhur me to. Në këtë kuadër për sa është arsyetuar më sipër edhe pretendimi i ankimuesit se: “Gjithashu edhe në rast se operatori ekonomik “4 S” SHPK e ka plotësuar në mënyrë të rregullt “Formularin përmbledhës të vetëdeklarimit” të dorëzuar në SPE kemi dyshime të arsyeshme se këta operatorë ekonomikë nuk i përmbushin kërkesat e mësipërme të parashikuara në Spe dhe rrjedhimisht kërkojmë të verifikohet përmbushja ose jo nga operatori “4 S” SHPK i kërkesave të mësipërme të*

*parashikuara në DST për disponimin e stafit dhe meqë është e nevojshme për realizimin e kontratës.*”, nuk qëndron, sepse dokumentacioni i paraqitur nga operatori ekonomik “4 S” SHPK në procedurën e prokurimit, plotëson kërkesat e autoritetit kontraktor dhe konsiderohet i vlefshëm për këtë fazë. Komisioni i Prokurimit Publik, gjykon, se është me vend të theksojë rolin e posaçëm që ka autoriteti kontraktor, për vetëcilësimin e tij ligjor, si autoriteti me interes dhe përgjegjësi thelbësore për realizimin e suksesshëm të kontratës. KPP sjell në vëmendje, se referuar rregullave të prokurimit publik, është pikërisht autoriteti kontraktor ai që duhet të monitorojë zbatimin e kontratës, për t’u siguruar nëse cilësia e mallrave shërbimeve apo punëve është e njëjtë me cilësinë e premtuar në ofertë dhe të përcaktuar në kontratë.

Në përfundim të analizës së fakteve përkatëse, Komisioni arrin në konkluzionin, se dokumentacioni i paraqitur nga operatori ekonomik “4 S” SHPK për përmbushjen e kriterëve më sipër, lidhur me disponimin e punonjësve dhe mjeteve në procedurën e prokurimit, plotëson kërkesat e autoritetit kontraktor dhe konsiderohet i vlefshëm për këtë fazë.

Për sa më lart, pretendimi i operatorit ekonomik ankimues “Nelsa” SHPK nuk qëndron.

III.3. Lidhur me pretendimin e operatorit ekonomik ankimues, “Nelsa” SHPK për skualifikimin e operatorit ekonomik “4 S” SHPK, për mospërmbushjen e kriterit të veçantë të kualifikimit, “Kapaciteti profesional” pika 2.1.3., duke argumentuar se operatori ekonomik “4 S” SHPK nëpërmjet certifikatave ISO 9001:2015 ose ekuivalent; ISO 22000:2018 ose ekuivalent si dhe UNI 10854:99 H.A.C.C.P, nuk kanë objekt të njëjtë me objektin e procedurës së prokurimit, si dhe të verifikohet vlefshmëria e tyre në momentin ofertimit, Komisioni i Prokurimit Publik vëren se:

III.3.1. Në shtojcën 7 “Kriteret e Veçanta të Kualifikimit”, “Kapaciteti profesional” pika 2.1.3, të dokumenteve të tenderit të procedurës së prokurimit objekt - ankimi përcaktohet si më poshtë:

*2.1.3 Operatori Ekonomik Ofertues, duhet të jetë i pajisur dhe të paraqesë në procedurën e prokurimit publik certifikatat përkatëse të vlefshme të ISO-ve, si më poshtë, ose ekuivalente, të lëshuara nga organizma ndërkombëtare ose shoqëri të akredituara në Republikën e Shqipërisë, të cilat duhet të jenë të vlefshme datën e hapjes së procedurës së prokurimit publik:*

*ISO 9001:2015/ certifikatën e menaxhimit të cilësisë; Për prodhimin dhe tregtimin e produkteve ushqimore me origjinë shtazore dhe jo shtazore; ose ekuivalente.*

*ISO 22000:2018 për sistemin e menaxhimit të sigurisë ushqimore; Për prodhimin dhe tregtimin e produkteve ushqimore me origjinë shtazore dhe jo shtazore; ose ekuivalente.*

*UNI 10854:99 H.A.C.C.P. për sistemin e menaxhimit të autokontrollit në parimet H.A.C.C.P (për Higjenën); Për prodhimin dhe tregtimin e produkteve ushqimore me origjinë shtazore dhe jo shtazore; ose ekuivalente.*

*Certifikatat e mësipërme duhet të jenë të lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtare akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë.*

Në rastet e Bashkimit të Operatorëve ekonomikë, çdo anëtar i grupit duhet të paraqesë Certifikatën ISO sipas zërave që do të marrë përsipër të realizojë referuar akt-marrëveshjes. Ky kriter duhet të plotësohet për secilin lot.

III.3.2. Nga verifikimet e kryera për plotësimin e kriterit të mësipërm, operatori ekonomik “4 S” SHPK ka dorëzuar dokumentacionin si më poshtë:

- *Certifikate me nr. AQS/H/89772022 me Standard UNI 10854:99 H.A.C.C.P dhe objekt “Tregtim i produkteve ushqimore me origjine shtazore dhe joshtazore. Prodhim dhe tregtim i nenprodukteve te brumit (bukë, embelsira...). Furnizim me produkte ushqimore për operatorët ekonomikë publikë dhe privatë (spitale, shkolla, kopshte, cerdhe...etj ) Shërbime katering u për operatorët ekonomikë publike dhe private. Tregtimi me shumice dhe pakice i pajisjeve dhe eneve te kuzhines.*
- *Certifikate me nr. AQS/SA/89752022 me Standard EN-ISO 22000:2018 dhe objekt “Tregtim i produkteve ushqimore me origjine shtazore dhe joshtazore. Prodhim dhe tregtim i nenprodukteve te brumit (bukë, embelsira...). Furnizim me produkte ushqimore për operatorët ekonomik publikë dhe privatë (spitale, shkolla, kopshte, cerdhe...etj ) Shërbime katering u për operatorët ekonomikë publike dhe private. Tregtimi me shumice dhe pakice i pajisjeve dhe eneve te kuzhines.*
- *Certifikate me nr. AQS/Q/89722022 me Standard EN-ISO 9001:2015 dhe objekt “rikonstruksion, ndertim i objekteve private dhe publike, restorante, hotele, resorte, rruge, ura, akalizime, asfaltime, hidroizolime... tregtim i veglave dhe veshjeve te punes, materiale te butaa, tregtim servis dhe mirembajtje e automjeteve dhe makinerive te renda, pajisje per autoservis, automekaniken dhe pajisjeve te kembimit. Tregtim i lendeve djegse, dru zjarri, pelet, gaz i lengshem, solarit, materiale gazermimi, materiale ndertimi, Materiale inerte, pajisje logjistike, elektrike, elektronike, elektroshtepiake, hidraulike, detergjente, materiale pastrimi dhe dezinfektimi. Tregtim i produkteve ushqimore me origjine shtazore dhe joshtazore. Prodhim dhe tregtim i nenprodukteve te brumit (bukë, embelsira...). Furnizim me produkte ushqimore për operatorët ekonomikë publikë dhe privatë (spitale, shkolla, kopshte, cerdhe...etj ) Shërbime katering u për operatorët ekonomikë publike dhe private. Tregtimi me shumice dhe pakice i pajisjeve dhe eneve te kuzhines. Tregtim te kancelarive, shtypshkrime dhe pajisje kompjuterike.*

III.3.3. Në nenin 77, pikat 1 dhe 3 të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, parashikohet shprehimisht se: “1. Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë kërkesat për kualifikim për operatorët ekonomikë bazuar në:

- a) përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale;
- b) gjendjen ekonomike dhe financiare;
- c) aftësinë teknike dhe profesionale.

Kërkesat kufizohen vetëm në ato që janë të përshtatshme për të garantuar që një kandidat ose ofertues të ketë kapacitetet juridike, financiare dhe aftësitë teknike e profesionale për të zbatuar kontratën që do të jepet. Të gjitha kërkesat duhet të kenë lidhje dhe të jenë proporcionale me objektin e kontratës.

3. Në lidhje me situatën ekonomike dhe financiare, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë kanë kapacitetin e nevojshëm ekonomik dhe financiar për të zbatuar kontratën.

*Për këtë qëllim autoritetet ose entet kontraktore mund të kërkojnë në veçanti që operatorët ekonomikë të kenë një xhiro vjetore minimale të caktuar. Gjithashtu, autoritetet ose entet kontraktore mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të japin informacione në bilancet e tyre vjetore që të tregojnë raportet ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit.*

*Xhiroja vjetore minimale që kërkohet nga operatorët ekonomikë nuk mund të tejkalojë dyfishin e vlerës së parashikuar të kontratës.*

*Kur një kontratë ndahet në lote, ky nen zbatohet për çdo lot individual. Megjithatë, autoriteti ose enti kontraktor mund të përcaktojë xhiron vjetore minimale që u kërkohet operatorëve, duke iu referuar grupeve të loteve, në rast se ofertuesi i suksesshëm merr disa lote që duhet të zbatohen në të njëjtën kohë.*

*Në rastin e kontratave që bazohen në një marrëveshje kuadër, kërkesa për xhiron minimale llogaritet mbi bazën e përmasave maksimale të kontratave specifike që do të zbatohen në të njëjtën kohë ose, kur përmasat nuk dihen, mbi bazën e vlerës së parashikuar të marrëveshjes kuadër.”*

*Në nenin 92/3 të LPP-së përcaktohet se: “3. Autoriteti ose enti kontraktor, në zbatim të pikës 4 të këtij neni, vlerëson një ofertë të vlefshme vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentet e tenderit, pa rënë ndesh me përcaktimet e nenit 38 të këtij ligji...”*

*Në nenin 79 pika 1 të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, përcaktohet se: “1. Autoriteti ose enti kontraktor për të vërtetuar se punët, mallrat ose shërbimet, objekt prokurimi, i plotësojnë kërkesat e cilësisë, mund t’u kërkojë ofertuesve të paraqesin certifikata të lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë.*

*Kjo dispozitë zbatohet edhe kur kërkesat teknike u referohen kualifikimeve të kandidatit ose të ofertuesit.”*

*Ndërsa në nenin 40 “Kërkesat e veçanta për kontratat e mallrave”, pika 3 të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, parashikohet shprehimisht se:*

*“3. Kërkesat e veçanta të kualifikimit duhet të përfshijnë të gjitha kriteret specifike, në përputhje me nenin 77, të LPP-së. Kriteret duhet të jenë në përputhje dhe të lidhura ngushtë me aftësinë zbatuese, natyrën dhe vlerën e kontratës. Në çdo rast, autoriteti/enti kontraktor duhet të përcaktojë dokumentet konkrete që duhet të paraqesin operatorët ekonomikë për përmbushjen e këtyre kriterëve.”*

III.3.4. Referuar frymës së legjislacionit për prokurimin publik, vendosja e kriterëve të veçanta për kualifikim ka si synim kryesor që t’i shërbejë autoritetit kontraktor për njohjen e gjendjes dhe kapaciteteve të operatorëve ekonomikë, të cilët, nëpërmjet dokumentacionit të paraqitur duhet të vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet ekonomike, financiare dhe organizative, makineritë, pajisjet e asete të tjera fizike, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, gjithçka në funksion të realizimit me sukses të kontratës. Në varësi të kontratës dhe volumit të saj autoriteti kontraktor përcakton kërkesat e veçanta për kualifikim, të cilat janë të detyrueshme për t’u përmbushur nga operatorët ekonomikë pjesëmarrës në procedurat e prokurimit. Operatorët Ekonomikë janë të detyruar të përgatisin ofertat, në përputhje me kërkesat e

përcaktuara në dokumentet e tenderit dhe ofertat që nuk përgatiten në përputhje me këto dokumente duhet të refuzohen si të papranueshme. Kriteret kualifikuese të përcaktuara nga autoriteti kontraktor, janë të detyrueshme për t'u përmbushur nga të gjithë ofertuesit ekonomikë pjesëmarrës në një procedurë prokurimi. Operatorët ekonomikë pjesëmarrës duhet të vërtetojnë se zotërojnë reputacionin, besueshmërinë, kapacitetet e konsideruara të nevojshme nga autoriteti kontraktor, për të zbatuar kontratën objekt-prokurimi. KPP sqaron, se në një procedurë prokurimi, subjekti i parë i interesuar është operatori ekonomik, i cili e përgatit ofertën e tij në përputhje me kuadrin ligjor në fuqi dhe nga ana tjetër, është autoriteti kontraktor, i cili përzgjedh operatorin ekonomik që plotëson të gjitha kriteret e përcaktuara nga autoriteti kontraktor në dokumentet e tenderit, si dhe që ka përgatitur ofertën në përputhje me legjislacionin në fuqi.

III.3.5. Në rastin konkret, referuar dosjes së tenderit, në seksionin “*Të dhënat kryesore*” autoriteti kontraktor ndër të tjera ka përcaktuar: “15110000-2 - *Mish*”. Në faqen zyrtare të Agjencisë së Prokurimit Publik, në seksionin “*Të tjera*”, në rubrikën “*Kodet CPV*” përcaktohen grupi i kodeve, emërtimi i kodit CPV dhe Identifikimi i kodit CPV për procedurat e prokurimit elektronik. Sa më sipër, në grupin e kodeve “*Produkte ushqimore, pije, duhan dhe të lidhura me to*” bën pjesë emërtimi i kodit 15110000-2 dhe identifikimi i kodit *Mish*, që përputhet me kodin CPV të procedurës së prokurimit dhe me objektin e veprimtarisë për të cilën janë lëshuar certifikatat *UNI 10854:99 H.A.C.C.P, EN-ISO 22000:2018* dhe *EN-ISO 9001:2015* për operatorin ekonomik “4 S” SHPK, pasi objekti i veprimtarisë së certifikatave të sipërcituara ndër të tjera përfshin dhe tregtimin e produkteve ushqimore me origjinë shtazore dhe joshtazore. Gjithashtu edhe për sa i përket pretendimit të operatorit ekonomik ankimues “Nelsa” SHPK, se operatori ekonomik “4 S” SHPK nuk e përmbush kriterin më sipër për shkak se sipas tij certifikatat nuk kanë qënë të vlefshme në momentin e hapjes së procedurës, KPP vëren se secila prej certifikatave më sipër është me afat vlefshmërie deri më datë 15.07.2025, pra të vlefshme në momentin e hapjes së procedurës së prokurimit objekt - ankimi. Në këtë kuadër, Komisioni i Prokurimit Publik gjykon, se dokumentacioni i paraqitur në sistemin e prokurimit publik nga operatori ekonomik “4 S” SHPK për përmbushjen e kriterit më sipër, është në përputhje të plotë me kërkesat e autoritetit kontraktor të përcaktuar në dokumentet e tenderit të procedurës së prokurimit objekt - ankimi.

Sa më sipër pretendimi i operatorit ekonomik ankimues “Nelsa” SHPK nuk qëndron.

III.4. Lidhur me pretendimin e operatorit ekonomik ankimues, “Nelsa” SHPK për skualifikimin e operatorit ekonomik “4 S” SHPK, për mospërmbushjen e kërkesës së autoritetit kontraktor “*Deklaratë me shkrim nga administratori i shoqërisë ofertuese ku të specifikohet se jemi dakort me këtë deklaratë.*” Komisioni i Prokurimit Publik vëren se:

III.4.1. Në shtojcën 7 “Kriteret e Veçanta të Kualifikimit”, paragrafi i fundit, përcaktohet si më poshtë:

*Në çdo rast AK ka të drejtë të kryejë verifikimet e nevojshme mbi vërtetësinë e informacionit të deklaruar nga operatori ekonomik ose ti kërkojë operatorit ekonomik ofertues sqarime dhe dokumente mbështetëse për këto sqarime. Operatori ekonomik fitues duhet të dorëzojë pranë*

AK, përpara lidhjes së kontratës, të gjithë dokumentacionin provues për vetëdeklarimin në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit. Deklaratë me shkrim nga administratori i shoqërisë ofertuese, ku të specifikohet që jemi dakort me këtë deklaratë.

III.4.2. Nga verifikimet e kryera për plotësimin e kriterit të mësipërm, operatori ekonomik “4 S” SHPK ka dorëzuar në SPE dokumentacionin si më poshtë:

- Deklaratë e datës 03.01.2024 me përmbajtje si më poshtë:

#### DEKLARATË

*E operatorit ekonomik pjesëmarrës në procedurën e prokurimit publik që do të zhvillohet më datë 03.01.2024 nga Autoriteti Kontraktor Agjencia e Parqeve dhe Rekreacionit, me objekt, Blerje mish për kafshët e Kopshtit Zoologjik për vitin 2024, me fond limit 9,015,678 lekë.*

*Unë i nënshkruari Xhino Sinani, me cilësinë e Përfaqësuesit të personit juridik “4 S” SHPK deklaroj nën përgjegjësinë time personale se:*

*Nga kontrolli i fundit i ushtruar nga Autoriteti Kombëtar i Ushqimit, ka rezultuar se subjekti ushtron aktivitet konform kërkesave ligjore.*

*Në çdo rast AK ka të drejtë të kryejë verifikimet e nevojshme mbi vërtetësinë e informacionit të deklaruar nga operatori ekonomik ose t'i kërkojë operatorit ekonomik ofertues sqarime dhe dokumente mbështetëse për këto sqarime, Operatori ekonomik fitues duhet të dorëzojë pranë AK, përpara lidhjes së kontratës, të gjithë dokumentacionin provues për vetëdeklarimin në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit.*

*Deklaroj se jemi dakort me këtë deklaratë.*

III.4.3. Në nenin 77, pikat 1 dhe 3 të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, parashikohet shprehimisht se: “1. Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë kërkesat për kualifikim për operatorët ekonomikë bazuar në:

- a) përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale;
- b) gjendjen ekonomike dhe financiare;
- c) aftësinë teknike dhe profesionale.

*Kërkesat kufizohen vetëm në ato që janë të përshtatshme për të garantuar që një kandidat ose ofertues të ketë kapacitetet juridike, financiare dhe aftësitë teknike e profesionale për të zbatuar kontratën që do të jepet. Të gjitha kërkesat duhet të kenë lidhje dhe të jenë proporcionale me objektin e kontratës.*

*3. Në lidhje me situatën ekonomike dhe financiare, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë kanë kapacitetin e nevojshëm ekonomik dhe financiar për të zbatuar kontratën.*

*Për këtë qëllim autoritetet ose entet kontraktore mund të kërkojnë në veçanti që operatorët ekonomikë të kenë një xhiro vjetore minimale të caktuar. Gjithashtu, autoritetet ose entet kontraktore mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të japin informacione në bilancet e tyre vjetore që të tregojnë raportet ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit.*

*Xhiroja vjetore minimale që kërkohet nga operatorët ekonomikë nuk mund të tejkalojë dyfishin e vlerës së parashikuar të kontratës.*



*Kur një kontratë ndahet në lote, ky nen zbatohet për çdo lot individual. Megjithatë, autoriteti ose enti kontraktor mund të përcaktojë xhiron vjetore minimale që u kërkohet operatorëve, duke iu referuar grupeve të loteve, në rast se ofertuesi i suksesshëm merr disa lote që duhet të zbatohen në të njëjtën kohë.*

*Në rastin e kontratave që bazohen në një marrëveshje kuadër, kërkesa për xhiron minimale llogaritet mbi bazën e përmasave maksimale të kontratave specifike që do të zbatohen në të njëjtën kohë ose, kur përmasat nuk dihen, mbi bazën e vlerës së parashikuar të marrëveshjes kuadër.”*

Në nenin 92/3 të LPP-së përcaktohet se: “3. Autoriteti ose enti kontraktor, në zbatim të pikës 4 të këtij neni, vlerëson një ofertë të vlefshme vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentet e tenderit, pa rënë ndesh me përcaktimet e nenit 38 të këtij ligji...”

Ndërsa në nenin 40 “Kërkesat e veçanta për kontratat e mallrave”, pika 3 të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, parashikohet shprehimisht se:

*“3. Kërkesat e veçanta të kualifikimit duhet të përfshijnë të gjitha kriteret specifike, në përputhje me nenin 77, të LPP-së. Kriteret duhet të jenë në përpjesëtim dhe të lidhura ngushtë me aftësinë zbatuese, natyrën dhe vlerën e kontratës. Në çdo rast, autoriteti/enti kontraktor duhet të përcaktojë dokumentet konkrete që duhet të paraqesin operatorët ekonomikë për përmbushjen e këtyre kriterëve.”*

III.4.4. Referuar frymës së legjislacionit për prokurimin publik, vendosja e kriterëve të veçanta për kualifikim ka si synim kryesor që t’i shërbejë autoritetit kontraktor për njohjen e gjendjes dhe kapaciteteve të operatorëve ekonomikë, të cilët, nëpërmjet dokumentacionit të paraqitur duhet të vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet ekonomike, financiare dhe organizative, makineritë, pajisjet e asete të tjera fizike, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, gjithçka në funksion të realizimit me sukses të kontratës. Në varësi të kontratës dhe volumit të saj autoriteti kontraktor përcakton kërkesat e veçanta për kualifikim, të cilat janë të detyrueshme për t’u përmbushur nga operatorët ekonomikë pjesëmarrës në procedurat e prokurimit. Operatorët Ekonomikë janë të detyruar të përgatisin ofertat, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në dokumentet e tenderit dhe ofertat që nuk përgatiten në përputhje me këto dokumente duhet të refuzohen si të papranueshme. Kriteret kualifikuese të përcaktuara nga autoriteti kontraktor, janë të detyrueshme për t’u përmbushur nga të gjithë ofertuesit ekonomikë pjesëmarrës në një procedurë prokurimi. Operatorët ekonomikë pjesëmarrës duhet të vërtetojnë se zotërojnë reputacionin, besueshmërinë, kapacitetet e konsideruara të nevojshme nga autoriteti kontraktor, për të zbatuar kontratën objekt-prokurimi. KPP sqaron, se në një procedurë prokurimi, subjekti i parë i interesuar është operatori ekonomik, i cili e përgatit ofertën e tij në përputhje me kuadrin ligjor në fuqi dhe nga ana tjetër, është autoriteti kontraktor, i cili përzgjedh operatorin ekonomik që plotëson të gjitha kriteret e përcaktuara nga autoriteti kontraktor në dokumentet e tenderit, si dhe që ka përgatitur ofertën në përputhje me legjislacionin në fuqi.

III.4.5. Në rastin konkret, referuar dokumentacionit të ngarkuar në sistemin e prokurimit elektronik nga operatori ekonomik ankimues, me qëllim përmbushjen e kërkesës “*Deklaratë me shkrim nga administratori i shoqërisë ofertuese ku të specifikohet se jemi dakort me këtë deklaratë.*”, Komisioni i Prokurimit Publik konstaton, se ky i fundit ka paraqitur dokumentacionin e përcaktuar në pikën III.4.2 të këtij vendimi.

Nisur nga pretendimet e operatorit ekonomik ankimues “Nelsa” SHPK, se operatori ekonomik “4 S” SHPK nuk ka paraqitur deklaratën më sipër, KPP konstaton, se nga verifikimet në SPE, rezulton që operatori ekonomik “4 S” SHPK, jo vetëm që ka paraqitur deklaratën më sipër, por referuar përmbajtjes së saj ajo është në përputhje edhe me kërkesat e vetë autoritetit kontraktor të përcaktuara në dokumentet e tenderit. KPP gjykon, se kriteret për kualifikim i shërbejnë autoritetit kontraktor për njohjen e gjendjes dhe kapaciteteve të operatorëve ekonomikë, të cilët, nëpërmjet dokumentacionit të paraqitur duhet të vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet organizative, makineritë, pajisjet e asete të tjera fizike, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, gjithçka në funksion të realizimit me sukses të kontratës. KPP sqaron, se mosplotësimi qoftë edhe i një kriteri të vendosur nga ana e autoritetit kontraktor, e bën ofertën e operatorit ekonomik të pavlefshme. Në këtë rast operatori ekonomik “4 S” SHPK ka dorëzonte dokumentacionin e ofertës në sistemin elektronik të prokurimeve në përputhje me kërkesën e përcaktuar më sipër në dokumentet e tenderit nga autoriteti kontraktor.

Sa më sipër, pretendimi i operatorit ekonomik ankimues “Nelsa” SHPK nuk qëndron.

III.5. Lidhur me pretendimet e operatorit ekonomik “Nelsa” SHPK ndaj vendimit të KVO-së për kualifikimin e ofertës të paraqitur nga operatori ekonomik “MC Catering” SHPK, në procedurën e prokurimit objekt - shyrtimi, Komisioni i Prokurimit Publik gjykon, se për sa kohë që pretendimet e mësipërme nuk qëndrojnë, pasi operatori ekonomik “4 S” SHPK përmbush kriteret e kualifikimit dhe gjendja e tij faktike juridike pas arsytimit të KPP-së do të mbetet e kualifikuar, trajtimi i pretendimeve të ankimuesit në lidhje me kualifikimin e operatorit ekonomik “MC Catering” SHPK nuk ka ndikim mbi fatin e çështjes, pasi bazuar në legjislacionin në fuqi për prokurimin publik, interesi i ligjshëm i drejtpërdrejtë i ankimuesit, nuk ka sesi të dëmtohet nga sukcesi apo dështimi i operatorëve të tjerë në këtë procedurë prokurimi, pasi edhe në hipotezën që këto pretendime do të pranoheshin, ai sërish nuk do të mund të shpallej fitues i kontratës objekt - prokurimi, duke qënë se në renditjen përfundimtare, para tij qëndron një tjetër operator ekonomik i kualifikuar.

Në këto kushte, KPP gjykon, që pretendimet e ankimuesit “Nelsa” SHPK për operatorin ekonomik “MC Catering” SHPK, nuk do të merren në shqyrtim.

Për sa më sipër, në mbështetje të neneve 30, dhe 118 të ligjit nr. 162/2020 “*Për Prokurimin Publik*”, Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “*Për miratimin e rregullave të prokurimit publik*”, i ndryshuar, Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 236, datë 20.04.2023, “*Për përcaktimin e rregullave dhe tarifës së pagesës për ankimin në një procedurë prokurimi pranë Komisionit të Prokurimit Publik*”, Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 766/2021, datë 13.10.2021 “*Për miratimin e rregullave “Për*

*Organizimin dhe Funkcionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, nenit 4, të Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 500/2020 datë 5.11.2020 “Rregullore për Marrjen e Masave Organizative për Ushtrimin e Veprimtarisë së Institucionit të Komisionit të Prokurimit Publik gjatë gjendjes së pandemisë së shkaktuar nga COVID -19”, Komisioni i Prokurimit Publik, njëzëri,*

### **Vendos:**

1. Të pranojë ankesën e paraqitur nga operatori ekonomik Argent Daci P.F, për procedurën e prokurimit “Procedurë e hapur e thjeshtuar”, me Nr. REF-91784-12-20-2023, me objekt: “Blerje mish për kafshët e Kopshtit Zoologjik për vitin 2024”, me fond limit 9 015 678 lekë (pa TVSh), zhvilluar më datë 03.01.2024, nga autoriteti kontraktor, Agjencia e Parqeve dhe Rekreacionit.
  2. Të mos pranojë ankesën e e paraqitur nga ankimesi “Nelsa” SHPK për procedurën e sipërcituar të prokurimit.
  3. Autoriteti kontraktor të anulojë vendimin e KVO-së për kualifikimin e operatorëve ekonomikë “Nelsa” SHPK, “4 S” SHPK dhe “MC Catering” SHPK dhe të korrigjojë shkeljet e konstatuara si më sipër, duke i skualifikuar këto operatorë ekonomikë.
  4. Autoriteti kontraktor, brenda 5 ditëve, të vërë në dijeni Komisionin e Prokurimit Publik për zbatimin e këtij vendimi, duke dokumentuar veprimet e kryera.
  5. Ngarkohet zyra e financës, të kryejë veprimet për kthimin e tarifës financiare të paguar nga operatori ekonomik Argent Daci P.F.
  6. Ngarkohet zyra e financës të kryejë veprimet përkatëse për derdhjen në Buxhetin e Shtetit, të tarifës financiare të paguar nga operatori ekonomik “Nelsa” SHPK
  7. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative të Apelit.
  8. Kopje e këtij vendimi i dërgohet për njoftim Agjencisë së Prokurimit Publik.
- Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

## **KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK**

**Anëtar**  
**Kreshnik Ternova**

**Anëtar**  
**Anila Malaj**

**Kryetar**  
**Jonaid Myzyri**

